


STUDIM

HISTORIKO - ARKITEKTUROR
PËR KËSHTJELLËN E PORTO PALERMOS,
HIMARË





**AGJENCIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL
MAJ, 2022**

PROJEKTI

“BLUE coAL-ITion:

**Eco-Sustainable Development for Albanian
coast-sea natural capital”**

MAJ, 2022

ISBN: 978-9928-4760-0-5

Autor: Harilla KOCI

Mbështetur nga AULEDA – Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Lokal

«Ky publikim është realizuar me mbështetjen financiare të Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e autorit dhe nuk përfaqëson këndvështrimin e Agjencisë»

Konsulentë historik:

Prof. Dr. Paskal Milo

Prof. Dr. Pëllumb Xhufi

Prof. Dr. Irakli Koçollari

Copyright: Celim



PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	7
2. Kartela e objektit në DRKK	15
3. KAPITULLI I	
Porto Palermo në antikitet	17
4. KAPITULLI II	
Historia e Himarës nis në thellësitë e shekujve	37
5. KAPITULLI III	
Himara dhe raportet me Venedikun	50
6. KAPITULLI IV	
Himara dhe Venediku, bashkë kundër Portës së Lartë.....	62
7. KAPITULLI V	
Ali Pasha dhe venecianët	77
8. KAPITULLI VI	
Trashëgimia arkitekturore e Ali Pashës.....	92
9. KAPITULLI VII	
Porto Palermo, arkitektura dhe Venediku.....	109
10. KAPITULLI VIII	
Porto Palermo, pas vitit 1822 dhe në vijim.....	145

HYRJE

Ishte fundi i muajit Gusht të vitit 1982, kur në hapësirën detare në gjirin e Porto Palermos, nisi gërmimet dragamina “Rodoni”, që kishte mbërritur këtu ditë më parë.

8 vjet pasi nisën punimet për ndërtimin e Bazës Ushtarake Detare të Porto Palermos, si alternativë e asaj të Pasha Limanit, në gjirin detar të Vlorës, ky proces hyri në një fazë tjetër; atë të thellimit të basenit të jashtëm, çka përfshihej në detyrat e zbatimit të një prej projekteve më të rëndësishme të kohës, atë të ndërtimit të kësaj baze ushtarake detare, ku, veç të tjerash, do të strehoheshin edhe 4 nëndetëset, si pjesë e flotës ushtarake detare të shtetit shqiptar. Ankorimi i mjeteve lundruese ushtarake të përmasave të ndryshme, kërkonte edhe parametra të caktuara dhe standarde të thellësisë së detit dhe, për të realizuar këtë, duhej të gërmohej dhe të thellohej ai që në terminologjinë teknike emërtohej “baseni i jashtëm” i bazës, që përkonte me pjesën përpara hyrjes për në tunelin kryesor të objektit, ose në skajin veriperëndimor të gjirit të Porto Palermos.

“Isha i pasionuar pas arkeologjisë dhe antikitetit dhe porosita stafin teknik të dragës për të punuar me kujdes dhe për të vlerësuar çdo detaj që lidhej me pasurinë nënujore”, thotë ing. Lefter Alushi, një nga specialistët më të njohur në shkencat inxhinierike të kohës dhe njëkohësisht, kryeinxhinier i përgjithshëm i kantierit të ndërtimit të këtij objekti të rëndësishëm ushtarak. Në literaturën që ai kishte shfletuar në vite, kishte eksploruar për këtë gji detar në shekuj, për këtë hapësirë të bregdetit të Himarës, ku ndodhej

edhe kështjella e Porto Palermos dhe që kishte shërbyer qysh në antikitet si një mjedis portual, për shkëmbime tregtare dhe nevoja ushtarake, sipas periudhave historike dhe interesave të fuqive të ndryshme.

Dhe pritshmëritë nuk vonuan të shfaqeshin. Bashkë me materialin e nxjerrë nga nëndeti, në mekanizmin gërmues të dragës u shfaqën edhe objektet e para antike. Ato ishin të shumta dhe dalloheshin qartësisht mes materialit të ngurtë e të lagët, pjesa më e madhe të thyera, të copëtuara, apo të dëmtuara pjesërisht. Mes tyre, amfora të dimensioneve e formave të ndryshme, sende që përdoreshin rëndom në antikitet për nevoja të përditshmërisë. Ishte një realitet që krijoi një ndjesi të thellë kurioziteti dhe përgjegjësie, tek ata që po realizonin procesin e gërmimit. Nëndeti fshihte brenda historinë, e cila shfaqej në dritën e diellit, përmes këtyre objekteve që dëshmonin për jetën e mijëra viteve të shkuara, e ngurtësuar në ato sende prej balte, të prodhuara sipas teknikave të kohës. Ishin momente të veçanta, që përjetoheshin me mjaft seriozitet nga të gjithë specialistët dhe punëtorët. “Duhej të ishte aty për të përjetuar ato momente kur ne nxirrnim nga fundi i detit historinë”, shprehet Alushi. Ai fikson mes objekteve, një sëpatë guri me një birë në mes, e cila ishte ndër më objektet më të veçanta të nxjerra nga thellësia dhe që dëshmonte për hershmërinë e aktivitetit portual në këtë gji, me një histori më shumë se 2500 vjeçare. Një send i vogël balte, që të kujtonte një çajnik të sotëm, u nxor pjesërisht i dëmtuar dhe u rindërtua plotësisht nga vetë drejtuesi i punimeve, ashtu sikundër u veçua prej tij edhe një amforë, në fundin e të cilës ishte ngurtësuar nga shekujt një produkt me shije pothuajse të ëmbël. “Duket paksa absurde, por duke depërtuar tek shtresëzimet e brendshme të materialit që gjeta në fundin e amforës, arrita të evidentoja shijen e ëmbël që ngjasonte ndoshta me mjaltin”, tregon Alushi.

Objektet dhe sendet e gjetura, u vlerësuan dhe u dokumentuan në bashkëpunim me strukturat zyrtare arkeologjike të kohës dhe u përcollën në institucionet përkatëse të fushës, si një dëshmi

konkrete e hershmërisë së ekzistencës së aktivitetit jetësor në këtë mjedis detar, që provohet të ketë një profil portual prej lashtësisë. Si një dëshmi e lidhjes dhe shkëmbimeve tregtare të banorëve të kësaj zone me pjesë të tjera të rajonit dhe më gjerë, por edhe e faktit që, në shekuj, është shfrytëzuar edhe për qëllime ushtarake, falë pozicionit strategjik dhe elementëve të tjerë të dukshëm, ose e konkluzioneve që vijnë si rrjedhojë e analizave.

Kështjella e Ali Pashës, ose e Porto Palermos, që ndodhet në një pikë dominuese në këtë gji detar të mrekullueshëm të kësaj krahine, është studiuar shumë pak. Mungojnë botime të mirëfillta, apo të plota për këtë objekt me një histori mjaft interesante, apo për vetë gjirin detar ku ndodhet ishulli i dikurshëm në të cilin, u ndërtua, ose u rindërtua, kështjella e Porto Palermos. Kjo hapësirë, e lënë pothuajse tërësisht jashtë objektivit të studimeve të mirëfillta historike, vjen deri në ditët e sotme, përmes ndonjë studimi të përciptë, apo kërkimeve nënujore krejtësisht spontane, një prej të cilëve, siç e përmenda më lart, i nisur në kuadrin e punimeve për ndërtimin e bazës ushtarake detare që mban emrin e këtij gjiri.

Por, ky objekt dhe ky gji detar mjaft interesant dhe i hershëm, që duken sikur formalizohen në histori në fillim të shekullit XIX, gjë që përkon me momentin kur përfundoi kështjella në formën që është edhe sot, kanë një “moshë” shumë më të hershme. Por, për shkak të mungesës së studimeve të thelluara për to, informacioni na vjen i përzgjedhur, fragmentar dhe sipërfaqësor. Për të depërtuar në thellësinë e të vërtetës dhe realitetit për këtë pjesë të bregdetit shqiptar dhe objektin e ngritur në një nga pikat zotëruese të tij, vlen të realizohet një interpretim mjaft i thelluar, duke patur si referencë autorë të huaj dhe shqiptarë, të cilët për shkaqe dhe arsye të ndryshme, në periudha të caktuara të historisë, janë gjendur këtu, apo kanë bërë përshkrime të caktuara për to.

Prandaj dhe, në vëllimin e reduktuar të informacionit që vjen deri në ditët tona, ka ende mjaft pikëpyetje për origjinën e kështjellës, për kohën e ndërtimit të saj, për faktin nëse ajo ishte një ndërtim

tërësisht i ri, apo rindërtim mbi një objekt ekzistues, apo strukturave pararendëse. Historia dëshmon se, objekte e fortifikata vijnë përmes një zinxhiri procesesh ku përfshihen ndërtime, shembje e rindërtime, ku periudha e momente të ndryshme me ngarkesa dhe interesa përkatëse, shfaqen dhe reflektohen më së miri në aspektin ndërtimor. Duket se, “Parimi i mohimit të mohimit”, si një parim universal, gjendet i mishëruar katërçipërisht edhe në këtë rrafsh të historisë sonë.

Për të analizuar dhe nxjerrë përfundime rreth një objekti, ai duhet analizuar në zinxhirin e zhvillimeve dhe periudhave të ndryshme historike, pa e shkëputur në asnjë çast vëmendjen dhe vëzhgimin tek karakteristikat përkatëse të këtyre periudhave, tek përkimi dhe zhvillimi i ngjarjeve, tek konteksti gjeografik dhe historik i zonës, apo i një rajoni më të gjerë.

Nëse gjiri detar i Porto Palermos, do të merret dhe do të studiohet i shkëputur nga konteksti gjeografik i zonës, i krahinës dhe bregdetit të Himarës, bregdetit nga Vlora në Sarandë, apo nga historia e Shqipërisë, e vendeve fqinj, etj., atëherë edhe përfundimet do të ishin të cinguara, pa dinamikën dhe integritetin e analizës. Nuk ka sesi dhe nuk mund të veçohet historia e Porto Palermos, nga ajo e Himarës, e gjithë vijës bregdetare nga Vlora në Sarandë, e Shqipërisë dhe tabloja e zhvillimeve në një shtrirje shumë më të gjerë gjeografike. Nuk ka sesi të vlerësohet e shkëputur nga ndikime disa dimensionale të periudhave dhe interesave më shumë se rajonale, të cilat kanë patur si objekt dhe destinacion vendin tonë, këtë pjesë të bregdetit që vlerësohet me rëndësi strategjike, ekonomike e ushtarake. Prandaj dhe, duke përfshirë në rrafshin e studimit faktorë dhe fenomene, periudha dhe momente historike, ne krijojmë sfondin e nevojshëm për të qenë më konkretë dhe më të saktë, për atë që do të themi dhe do të nxjerrim për Panormën e lashtë, për Porto Palermon, që mori këtë emërtim në një moment të caktuar të historisë.

Këtu, nuk është vendi për të shtruar pyetjen se përse, ky kënd i Shqipërisë është nënvlerësuar, është lënë pothuajse jashtë

vëmendjes së studiuesve, historianëve. Aq më tepër kur, këtë fakt e pohojnë edhe emra të shquar të historiografisë, të arkeologjisë e të mendimit shqiptar të fushës, mes të cilëve Gjerak Karaiskaj, në botimin **“5000 vjet fortifikime në Shqipëri”**.

Madje, megjithëse kështjella e Porto Palermos, është ndër objektet më të ruajtura, më të mirëmbajtura në Shqipëri dhe 200 vjet pas ndërtimit vjen pothuajse e padëmtuar, për të nuk ka një analizë të gjerë të profilit arkitekturor, sikundër ka për objekte të njohura të fortifikimit, që mbajnë emrin e Ali Pashës, si ideator dhe financues i rindërtimit apo ringritjes pas shkatërrimeve të mëparshme, mes të cilave, Kalaja e Gjirokastrës, apo ajo e Tepelenës, e Vivarit në Butrint, apo e Shën Triadhës dhe e Libohovës, në Gjirokastër. Për të mos folur, për monumente të tilla të arkitekturës fortifikuese ushtarake, si kalaja e Janinës, që lidhet me emrin dhe periudhën e sundimit të Pashait të famshëm shqiptar.

Qoftë në “Historia e arkitekturës shqiptare”, qoftë në librin **“5000 vjet fortifikime në Shqipëri”**, botim i vitit 1981, me autor, Gjerak Karaiskaj, kështjellës së Porto Palermos, i kushtohet vetëm një hapësirë e kufizuar në pak paragrafë, ku bëhet një përshkrim i përgjithshëm i këtij objekti, por pa dhënë detaje dhe argumente të tjera, pa përcaktime për stilin arkitekturor që është ndjekur, apo detaje që janë përcaktuese për këtë profil. Madje, edhe ndërtuesit dhe projektuesit e saj, janë lënë të pasaktësuar, duke përmendur vetëm njërin prej tyre, Petro Korçarin, arkitektin e famshëm që punoi për disa vite pranë Ali Pashës, madje pa u paguar për kontributin e tij. Ndërkohë, përmenden shkarazi si autorë të tjerë, specialistë italianë, apo francezë (!!!!), por pa saktësuar se cilët ishin këta.

Dëshmi e varfërisë së punës studimore kërkimore për kështjellën e Porto Palermos në dekada, janë edhe një sërë elementësh të tjerë. Kështu, deri vonë, emërtimi Porto Palermo, lidhej me ushtarët e një reparti të trupave italiane të pushtimit gjatë Luftës së Parë Botërore, të cilët, duke dalluar tek peizazhi natyror ngjashmëri me Palermon e tyre, i dhanë këtij vendi një emër të përafërt

me të (!!). Ky përcaktim naiv, ka mbizotëruar në dekada në të gjithë literaturën që ka përfshirë, qoftë edhe shkarazi këtë objekt interesant, pjesë e trashëgimisë sonë historike e arkitekture. Ndërkohë, e vërteta nuk ka asgjë të përbashkët me këtë përcaktim naiv dhe të paargumentuar shkencërisht.

Po ashtu, deri vonë, në librat e historisë, ndërtimi i kështjellës së Porto Palermos, është lidhur me një dëshirë të Pashait të Janinës, për t'i dhuruar bashkëshortes së tij të bukur, Vasiliqisë, një objekt të tillë, ku ajo mund të kalonte ditë të bukura në bregdet dhe bashkë me të, i ndërtoi edhe një kishë të vogël, në hyrje të istmit, që lidh bregun me ishullin, ku ndodhet dhe është ngritur kështjella. Nëse do të prananim, qoftë edhe për pak, një "argument" të tillë, atëherë do të krijojmë kushte për të devijuar nga një interpretim i saktë dhe thelbësor i figurës së Ali Pashës, nga ajo çka ai përfaqëson në histori, i profilit të tij, i kompleksit të ambicieve të tij, që kulmuan me krijimin dhe, më shumë akoma, të një pavarësie pothuajse reale, nga Porta e Lartë.

Prandaj dhe përfundimet nxirren duke analizuar disa fakte. Mjafton edhe ato në rrjedhën kronologjike historike. Sepse, e vërteta është krejtësisht tjetër. Objekti, në formën dhe gjendjen që është sot, përcaktohet të jetë ndërtuar (apo rindërtuar) në vitin 1804 (ndoshta edhe më herët-shën.im), ndërkohë që, martesë e Pashait të Janinës me Vasiliqinë, është realizuar 12 vite më pas. Ceremonia është zhvilluar në vitin 1816, në këtë kështjellë dhe është vënë kurorë, sipas riteve ortodokse, në kishën pranë saj.

Në vargun e papërputhshmërisë së fakteve, apo argumenteve, për këtë objekt, përfshihet edhe një përcaktim tjetër që, nuk qëndron dhe nuk përputhet fare me realitetin; emërtimi i kësaj kështjelle, si veneciane në vitin 1921, i përmendur nga ndonjë studiues. Ky përcaktim i fundit (të vërtetën e të cilit e shtjellojmë më poshtë), në fakt, duhet të ishte thelbësor, por, në mënyrën se si prezantohet, shton edhe më shumë mjegullnajën për profilin, karakteristikat, origjinën dhe të tjera detaje të kështjellës së Porto Palermos. Emërtimi në të vërtetë, duhet të ishte produkt dhe rrjedhojë e dy

momenteve: ndërtuesit dhe stilit arkitekturor, gjë që, në realitet nuk ndodh. Nxjerrja në pah e një "fakti" të tillë, është aq naive dhe e nxituar saqë, nuk kërkohet origjina e këtij emërtimi dhe argumentet bashkëshoqëruese. Kështu, Porto Palermo, na shfaqet si një hallkë e shkëputur në zinxhirin e zhvillimeve, të fenomeneve, të periudhave historike.

Profili i saj, i përzgjedhur, na vjen vetëm përmes studiuesve të huaj, diplomatë e udhëtarë, por edhe historianë e arkitektë, për të cilët, aktualisht, Ali Pasha dhe filozofia e trashëgimia e tij disadimensionale, kanë shfaqur dhe shfaqin në vijimësi interes. Emra të shquar si Pouqueville, William Martin Leake, mbeten pikë reference dhe burim informacioni për këtë objekt, për historinë e tij dhe elementë të tjerë. Por, pavarësisht këtyre dëshmimeve me vlerë, informacioni për kështjellën e Porto Palermos, nuk arrin të hedhë dritë plotësisht në origjinën e saj, tek fakti nëse ajo ishte thjesht një ndërtim i ri, apo ishte rindërtim i një fortëse, apo strukture të ngjashme, që lidhej me periudha paraardhëse, sikundër kishte ndodhur me kalatë e Tepelenës dhe të Gjjirokastrës, të rindërtuara pjesërisht, apo plotësisht nga Ali Pashë Tepelena, si dëshmi dhe argument i synimeve të tij për të sunduar përmes forcës së kundërshtimit dhe kundërvënies ndaj Perandorisë Otomane.

Ajo vlerësohet gjithashtu, si një argument në zinxhirin e synimeve të Ali Pashës, për të zgjeruar dhe konsoliduar zotërimet e tij, në raport me rivalët dhe pashallëqet e tjera në planin lokal, por, po aq edhe në raport me Portën e Lartë dhe më gjerë, synimet e fuqive të mëdha të kohës, Francës e Britanisë, interesat e të cilave në rajon u ridimensionuan pas shembjes së Republikës së Venedikut në vitin 1797, kur edhe prania ruse këtu, u rrit së tepërmi.

Por, jo vetëm kaq. Ky objekt, në përmasa modeste krahasuar me fortësa të tjera të ngjashme në bregdetin e Jugut, apo më gjerë, në territorin e ish Pashallëkut të Janinës dhe më tej, Korfuz, etj, nuk mund të analizohet i shkëputur dhe vetëm në një moment të caktuar të historisë, por në një rrafsh shumë më të gjerë, si produkt i dinamikës dhe zhvillimit historik disaplanësh;

Por edhe më pas, historia e Porto Palermos dhe kështjellës së Pashait të famshëm, përjeton vakuumin. Ndonjë përpjekje e ndonjë studiuesi të huaj, më tepër në aspektin e përshkrimit të historisë, mbetet e pamjaftueshme. Mungojnë dokumentat për të evidentuar se çfarë ndodhi me të, pas vrasjes së Ali Pashë Tepelenës dhe shembjes së pashallëkut që mban emrin e tij.

Lufta e Parë Botërore, periudha e Mbretërisë, Lufta e Dytë Botërore, janë periudha ku, për kështjellën ka shumë pak informacion. Dhe, si për “t’i vënë kapak kësaj”, periudha e pas luftës, ajo e regjimit komunist, është po aq e varfër. Projekti për ta shndërruar këtë gjë dhe gjithë resursin natyror bregdetar të saj, në një nga objektet më të fuqishme ushtarake të kohës, në bazën ushtarake me të njëjtin emër, ishte edhe si një lloj barriere ndaj interesit të studiuesve për të eksploruar. Në fillim të viteve ’70-të të shekullit të kaluar, kjo pjesë e bregdetit shqiptar u shpall zonë ushtarake dhe për të garantuar sekretin, u devijua edhe rruga kombëtare Vlorë-Sarandë, çka bëri që kështjella, që ishte shpallur ndër kohë, Monument Kulture Kategorisë I dhe ky gjë që përfaqësonte një nga perlat e bregdetit dhe të Rivierës Shqiptare, të ngeleshin jashtë syve dhe vëmendjes së qytetarëve.

Prandaj dhe gërmimet e dy dragave ushtarake, për thellimin e basenit të jashtëm të bazës, në hyrje të tunelit të strehimit të nëndetëseve, u vlerësua si një mënyrë për të studiuar një pjesë të zonës nënujore të gjirit detar të Porto Palermos.

Pavarësisht se, nuk u realizua interpretimi i mirëfilltë dhe i thelluar profesional i materialit të gjetur, kjo ngjarje është e spikatur. Kjo, sepse, përmes materialit arkeologjik të nxjerrë nga fundi i mjedisit detar, u krijuan mundësi. Sendet e nxjerra në sipërfaqe, u restauruan në një masë të konsiderueshme dhe u përcollën në Muzeun e Apolonisë, si mënyra më e mirë për të formalizuar tentativën e parë të eksplorimit arkeologjik të kësaj zone, çka do të pasohet në vitet vijuese në pika të tjera të kësaj hapësire dhe gjiri detar, me një histori që shkon thellë në antikitet.

Kartela e objektit në DRTK – DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISE KULTURORE

Kalaja e Porto Palermos

Statusi i Objektit: Kalaja e Porto Palermos mori statusin Monument Kulture i kategorisë së parë me vendim nr. 1886, datë 10.06.1973.

Viti/koha e ndërtimit: Fillimi i shek. XIX.

Vendndodhja: Gjiri i Porto Palermos, Bashkia Himarë.

Përshkrimi: Kalaja e Porto Palermos është ndërtuar mbi një rrip toke në qendër të gjirit të Palermos, gjë i përmendur që në periudhën antike me emrin “Panormus”, liman i madh në mesin e maleve Keraune (Malet e Vetëtimës). Në fundin e shek. XVIII dhe fillimin e shek. XIX, Ali Pasha mbasi nënshtroi gjithë bregdetin Jon, nga Butrinti deri në Vlorë, për kontrollin dhe fortifikimin e pikave strategjike të vijës bregdetare u kujdes të ndërtonte disa kështjella, një prej të cilave ishte dhe kështjella në Porto-Palermo. Udhëtarët e fillimit të shekullit të XIX, konsulli francez François Pouqueville dhe koloneli anglez William Martin Leake, dëshmojnë se në këtë kështjellë ishte vendosur një garnizon ushtarak. Përshkrimet më të detajuara rreth saj dhe gjirit në fjalë i gjejmë pikërisht tek konsulli francez, i cili shkruan se: Gjiri ose porti i Palermos ka një dalje rreth çerek milje midis pikave shkëmbore, ku deti përplasat furishëm. Kështjella ndodhet në pikën jugore të hyrjes dhe lidhet me kontinentin me një rrip të ulët dhe të ngushtë. Ajo përbëhet nga një shesh me disa pozicione të fortifikuara, me ca topa, në afërsi ka ca magazina, një shtëpi që shërben si doganë dhe një kishë. Kisha e Shën Kollit, që përmendet nga Pouqueville, ruhet ende dhe ashtu si kështjella është shpallur monument kulture. Mbi hyrjen e kështjellës ka patur një pllakat, ku në stilin e një poeme epike dëshmohej se ajo u ndërtua prej Ali Pashës.

Kështjella ka formën e një trekëndëshi me tre bastione të mprehta në qoshe dhe një oborr që hapet nga ana perëndimore. Ajo është krejtësisht e mbuluar dhe mbi parapetin që rrethon tarracën, janë hapur shumë frëngji për topa. Në brendësi ka salla, depo dhe kthina të shumta. Një palë shkallë guri, të ndërtuara në pjesën qendrore, të ngjisin në tarracë. Të gjitha kthinat mbulohen me qemerë guri. Një kujdes i veçantë është treguar për mbrojtjen e hyrjes, që ndodhet në mesin e njërit ballë, midis dy bastionesh. Nga brenda, ajo kontrollohet prej murit me frëngji pushke të një kthine anësore, gjithashtu një mur me frëngji është ndërtuar në anën e brendshme, përballë hyrjes. Në bastione dhe në këndet e oborrit, në krahun perëndimor gjenden rreth 5 vende vrojtimi për rojet. Për sa i përket trajtimit të jashtëm, kalaja shquhet për veshjen me gurë të latuar, për trajtimin monumental të hyrjeve, si dhe për kornizat horizontale prej guri të thjeshtë. Ajo ka forma të rregullta gjeometrike të planimetrive, me lartësi të barabartë të bastioneve poligonal.

Bibliografia: F.H.C.L. Pouqueville., “Voyage de la Grece”, Volume 1, Paris, 1826, fq. 99. W. M. Leake., Travels in Northern Greece, London, 1835, f. 79-80. Gj., Karaiskaj., Pesë mijë vjet fortifikime në Shqipëri. ShB “8 Nëntori”. 1981. f, 270-272. A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, Gj. Karaiskaj, P. Thomo., Historia e Arkitekturës Shqiptare. Tiranë, 1979, f. 332.

Funksioni: Kështjellë, sot është Monument Kulture.

KAPITULLI I

1.1. Porto Palermo, një qytet port në antikitet

Po e nisim nga një fakt i shkruar. Në shkrimin e tij, në “Harta arkeologjike e bregdetit Jon dhe e pellgut të Delvinës”, botuar në 1971, Dhimosten Budina përfshin edhe Porto Palermon, duke u bazuar në një raport të vitit 1963. Shoqëruar kjo edhe me një foto të kohës, realizuar në këtë vit, ndërkohë që kjo hapësirë, ishte e shpallur prej kohësh, “zonë ushtarake”. Nisur nga kjo, janë të kuptueshme, cilësia dhe pikëvështrimi i realizimit të fotos shoqëruese, ilustruese. Ja si e përshkruan Budina Porto Palermon:



Fig. 1 – Pamje e Porto Palermos në vitin 1963

“Në krahun e djathtë të rrugës automobilistike Vlorë-Sarandë, 8 km në jug të Himarës, ndodhet gjiri i Porto Palermos. Në këtë gjiri të bukur, mbi një kodër të vogël, të rrethuar nga të tri anët me ujë, ndodhet një kala mesjetare, ndërtuar në kohën e Ali Pashë Tepelenës. Në sipërfaqen e kodrës, tek-tuk, takohen fragmente qeramike të kohës antike. Sipas burimeve të autorëve antikë, vendi mbi të cilin ngrihet kalaja lokalizohet me limanin e lashtë Panormi. (1) **(Straboni VII, 58, Prolemeu III 13,2)**”, **Dhimosten Budina Raport i vitit 1963 A.S.A. Harta arkeologjike e bregdetit Jon dhe e pellgut të Delvinës fq 282, Iliria, 1971, 1, pp.275-342.** Në këtë përshkrim evidentohen dy momente. Së pari, ky përcaktim për Porto Palermon (Panormën), është ndoshta i pari në këtë formë në periudhën 1945-1990 dhe së dyti, autori, ndër emrat më të shquar të arkeologjisë shqiptare, i është referuar në këtë përcaktim, dy autorëve të njohur të antikitetit; Straboni dhe Ptoleme.

Në fakt, këtyre dy emrave duket se u referohen në rastin e Porto Palermos (Panormës së lashtë) edhe autorë të tjerë, udhëtarë të shquar, që kanë shkruar për Porto Palermon. Mjafton të hedhim vështrimin pas, për të lexuar përshkrimin e udhëtimeve përkatëse të François Pouqueville, Konsull i Francës në Janinë dhe William Martin Leake, i dërguar i Britanisë së Madhe pranë Ali Pashës, ku të dy këta emra të njohur të diplomacisë, citojnë Strabonin dhe Ptolemeun, në përshkrimin për Porto Palermon. Leake dhe Pouquevillë, ishin mysafirë në Porto Palermo, respektivisht i pari në dhjetor të 1804 dhe vjeshtë të 1805, si dhe i dyti në muajin shkurt të vitit 1806.

Përshkrimet dhe raportimet e tyre, të arkivuara në arkivat e dy vendeve, janë vlerësuar gjithashtu, ndër burimet më të sakta për zhvillimet në Pashallëkun e Janinës dhe raportet dhe marrëdhëniet e Ali Pashës me Portën e Lartë dhe fuqitë e mëdha të kohës. Prandaj dhe, këta dy përfaqësues të njohur të diplomacisë të dy prej shteteve më të fuqishme të kohës, citohen në vijimësi nga autorë të mëvonshëm. Është kjo arsyeja gjithashtu që, edhe në këtë studim, Pouqueville dhe Leak, citohen herë pas here.

Dëshmi të shumta dhe dokumente të shkruara provojnë se, Porto Palermo, ose Panorma e lashtë, përmendet qysh në antikitet si

port me rëndësi për këtë zonë dhe për të gjithë rajonin. Njerëz të shquar si Ptoleme, Straboni, Plutarku etj, e përshkruajnë portin dhe gjirin detar ku është vendosur ai, në dimensionin e mjaftueshëm, që përcjell rëndësinë që ka patur gjatë historisë mijëra vjeçare. Le të sjellim në vëmendjen disa nga këto dëshmi, së pari me ato që evidenton në shënimet e tij, François Pouqueville.

1.2 Përshkrimi i Portit Panorma, i quajtur tani Porto-Palermo

Në rendin e përshkrimeve të tij, Ptoleme vendos portin PANORME në skajin jugor të Acroceraune. Straboni, duke i dhënë më shumë shtrirje maleve të Ceraunies, tregon vendndodhjen e tij në mes të zinxhirit të tyre; dhe këta dy gjeografë, megjithëse ndryshojnë në dimensionin e kufijve, mund të kenë të drejtë sipas parimeve të tyre të veçanta.

Acroceraune, i cili fillon në Cepin Linguetta, duket i prerë nga hyrja e portit të Palermos në brendësi, dhe përfundon enklavën e Chimere, e cila duket se ka formuar që nga kohëra të lashta një nga kantonet e Chaonie, në të cilën përfshihej.

Ndaj ka mundësi që Ptolemeu, nga njohja e një demarkacioni topografik, ta ketë vendosur portin në fjalë në fund të Acroceraune në bregun e Korkyrës, sikur të kishte thënë se ishte errësirë në jug, territori i Chimariotëve.

Ja, më duket se si mund të realizohet mendimi i këtij gjeografi. Por kur kemi parë vendet, kur dimë se shtrirja e vijës bregdetare të Acroceraune përfundon afër Buthrotum-it dhe në grykën e Simoisit të rremë, bindemi se Straboni thotë më saktë: Se ky port i madh ndodhet në mes të maleve Ceraunies”. [2] **Pouqueville. “Voyage de La Grece”**

Përshkrimi që bën Puqueville, duke cituar gjeografët e shquar të lashtësisë, na sjell në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të saktë në këtë pikë gjeografike të bregdetit të Jugut, ku ndodhet një nga portet më të njohura në historinë shumëshekullore, si edhe kështjella që mban të njëjtin emër, që, në formën që është sot, daton të jetë ndërtuar (apo rindërtuar), në fillim të shekullit XIX.

Duke bërë analizën e këtij përshkrimi dhe duke e bashkangjitur atë me dëshmi të tjera të shkruara në periudha të ndryshme, veçanërisht në antikitet, ne evidentojmë në dinamikë procesin e

përshtatjes dhe ndryshimit të këtij gjiri, porti, qendre të fortifikuar. Mund të bëjmë, qoftë edhe në mënyrë të përafërt grafinë e asaj që ka përfaqësuar Porto Palermo (Panorma), në antikitet, në periudhën otomane e atë moderne, pas shekullit XIX e në vijim, kur ajo pushoi së ekzistuari, një port i rëndësishëm në rajonin e bregdetit të Jugut.

Kështu, arrijmë në përfundime të rëndësishme gjithashtu, lidhur me hershmërinë e kështjellës së Porto Palermos, pavarësisht momentit kur ajo është realizuar në projektin që e ka ruajtur atë të padëmtuar në formën dhe gjendjen që është sot, si pjesë e programit të madh e të njohur të Ali Pashë Tepelenës, për ndërtimin e rrjetit të fortifikimeve, veçanërisht në zonën bregdetare të Pashallëkut të tij.

Më sipër u njohëm me përshkrimet e gjeografëve të antikitetit, Ptoleme, Straboni etj, të cilët përmendin hershmërinë e gjirit të Panormës (Porto Palermos) dhe portit me të njëjtin emër. Por, në një analizë më të detajuar të përshkrimeve të Ptolemeut, Panorma merr një vlerësim tjetër, si një port dhe njëkohësisht si një qendër e banuar. “Vija bregdetare në këtë zonë është e pabanuar; ne shohim në veri disa fusha të kultivuara dhe përroin e gjerë që shtrihet përmes Nigerit, të cilin Castaldus e cilëson gabimisht si lumë, pranë të cilit vendos një qytet të quajtur Toponzo, emri i të cilit është po aq i panjohur për çimariotët sa kujtimi i ekzistencës së tij, megjithëse Ptoleme e kualifikon Panormën e titujve të qytetit dhe portit”. [3] *Pouqueville. “Voyage de La Grece”*

Mjafton të ndalemi tek përcaktimi i Ptolemeut për Panormën e titujve të qytetit dhe portit, për të nxjerrë një përfundim të rëndësishëm, sipas të cilit, Panorma (Porto Palermo), ka qenë një qendër e rëndësishme qysh në lashtësi, një qytet port, ashtu siç kanë qenë dhe janë qytetet port më të njohura edhe në ditët e sotme.

Ky fakt përforcohet edhe nga përcaktimi që bën Straboni, i cituar më sipër: “Se ky port i madh ndodhet në mes të maleve Ceraunies”. Një port i madh dhe një qytet port, do të thotë se, në mjediset përreth tij, zhvillohet një jetë e plotë urbane, sociale e ekonomike. Do të thotë që, në të janë dhe funksionojnë të gjitha strukturat e nevojshme, që garantojnë dimensione jetësore të tilla. Më tej, do

të thotë se, koncepti i referuar për Porto Palermon (Panormën), si një port me aktivitet thjesht portual, nuk është i saktë, ashtu siç duket se nuk është i saktë edhe koncepti i portit natyror, sikurse përcaktohet për të, në disa raste nga studiues të ndryshëm.

Portin e madh të Porto Palermos, si një përcaktim i Strabonit, e saktëson edhe William Martin Leake, i dërguari i Britanisë së Madhe pranë oborrit të Ali Pashë Tepelenës, i cili ka botuar shënime nga udhëtimi i tij në Greqinë e Veriut, në dhjetor të vitit 1804 dhe në vjeshtë të një viti më pas.

Ja si e përshkruan ai këtë gji, së bashku me hapësirën ku ngrihet edhe kalaja. “Palérimo, Panormusi i lashtë, të cilin Straboni e përshkruan si një port të madh në mes të maleve Cerauniane, dhe kështu dallon qartë nga Panormusi i Oricum, ndahet në dy gjire nga një gadishull shkëmbor, që del në mes të tij, asgjë më shumë se një rrethim i vogël katror që përmban një shtëpi, një kishë dhe dy katër kile. Pasi i solla një letër Bulu-báshit ose komandantit, zbarkoj sapo mbërrijmë dhe strehohem nga shiu në banesën e tij të vogël, e cila është e vetmja në vend që ka një oxhak. Në anën e kodrave që kufizojnë ndarjen jugore të portit janë disa ara me misër dhe vreshta, të cilat, së bashku me disa dele në kodra, kulloten nga dhjetë ushtarët që garnizonin kalanë”. [4] *William Martin Leake, Travels in Northern Greece (London 1835), volume 1, pp. 1-105, 363-384*

Këto janë dokumente të shkruara, që na e sjellin këtë objekt, në dimensionin e vet të rëndësisë shumëshekullore dhe na bën ta perceptojmë këtë gji dhe port njëkohësisht, si një objekt me peshë për rajonin, përveçse për bregdetin e Jugut.

Nga ana tjetër, pavarësisht se në këtë zonë, për shkaqe të ndryshme të natyrës objektive, janë bërë shumë pak gërmime, ka patur tentativa për të pasuruar tablonë e të dhënave me prova konkrete, të siguruar përmes eksplorimit tokësor, apo nënujor.

Njëra prej tyre lidhet me kërkimet përnjohëse të zhvilluara në pellgun e Delvinës dhe në Bregdetin Jon, gjatë ekspeditave arkeologjike të viteve 2008-2010, si vazhdim i kërkimeve të kryera në fushën e prehistorisë në zonën e Butrintit.

Duke ju referuar rishikimit të vendbanimeve dhe fortifikimeve

prehistorike për zonën nga Borshi në Dhërmi, Ilir Gjipali, arkeolog në fushën e prehistorisë, shkruan: “Ajo që bie në sy për këto vendbanime është se disa prej tyre nuk u kanë shpëtuar dëmtimeve të rënda nga punimet ushtarake dhe nga ndërtimet e banesave pas viteve ’90-të. Në njërin prej tyre, në Armeridhë të Porto Palermos, u gjet qeramikë e periudhës së bronzit që dëshmon praninë e një vendbanimi të tillë pranë territorit ku ka ekzistuar fortifikimi prehistorik, i cili sot nuk ruhet.

Kështu, nuk ruhet vendbanimi i fortifikuar i Gurrës së Qeparoit, ku janë vendosur shtëpitë e reja të fshatit, Kolëza e Kudhësit dhe Armeridha në Porto Palermo, të dëmtuara këto nga ushtria... Kontrolli në territorin ku ka ekzistuar fortifikimi i Armeridhës, gjë që është bërë e mundur pas lirimit të këtyre territoreve nga ushtria, tregoi për mungesën e çdo gjurme të mureve fortifikues, por në anën jugore të lartësisë në fjalë, u konstatuan gjurmë banimi të periudhës së bronzit”. [5] *Ilir Gjipali, Vendbanime të reja në Pellgun e Delvinës dhe në Bregdetin Jon, Iliria 34.2009. pp. 201-221 Iliria nr. XXXIV & J. Koçi, “Fortifikimet parahistorike në bregdetin kaon”, Iliria 1991, 1-2 fq 39-61*



Fig 2 - Harta e vendbanimeve të reja të zbuluara në Pellgun e Delvinës dhe Bregdetin Jon

Duke analizuar me kujdes këto përcaktime që sjell Gjipali, arrijmë në përfundimin se, Porto Palermo, ose Panorma e lashtë, ridimensionohet në shtrirjen kohore, duke u shtyrë në prehistori. Fortifikimi prehistorik i Armeridhës, sikurse shihet edhe në hartë, ndodhet në kepin veriperëndimor të gjirit të Porto Palermos. Për rrjedhojë, kjo rezulton të jetë një e dhënë e rëndësishme për hershmërinë e Panormës dhe ekzistencën e saj, jo vetëm si një port, por edhe si një hapësirë më e gjerë e plotësuar me elementë të tjerë, sikundër është një qendër e fortifikuar për të mbrojtur këtë port të madh dhe të rëndësishëm natyror.

Materialet arkeologjike të gjetura në funddetin e pjesës veriperëndimore të këtij gjiri, gjatë gërmimeve të realizuara për thellimin e basenit të bazës ushtarake detare në vitet 1970-të, janë dëshmi e këtij fakti historik, që na e sjell në vëmendje Gjipali. Por, duke e parë dhe analizuar këtë hapësirë detare dhe portuale, si një të vetëm, zhvendosemi më në jug, gjeografikisht dhe historikisht. Kthehemi sërish pas në kohë, në atë që përcjell Dhimosten Budina për Porto Palermos, në “Harta arkeologjike e bregdetit Jon dhe e pellgut të Delvinës”, botuar në 1971.

“Në këtë gji të bukur, mbi një kodër të vogël, të rrethuar nga të tri anët me ujë, ndodhet një kala mesjetare, ndërtuar në kohën e Ali Pashë Tepelenës. Në sipërfaqen e kodrës, tek-tuk, takohen fragmente qeramike të kohës antike. Sipas burimeve të autorëve antikë, vendi mbi të cilin ngrihet kalaja lokalizohet me limanin e lashtë Panormi. (6) *(Straboni VII, 58, Prolemeu III 13,2)*”.

Tashmë, pas kësaj, tabloja shfaqet më e plotë dhe Panorma përcillet si një hapësirë e unifikuar në të gjithë gjerësinë e saj, në këtë gji ku, siç e përcakton Pouqueville, “...*hyrja në portin e Palermos, zona e erës së të cilit mund të përcaktohet nga një vijë mesatare nga perëndimi në lindje, e tërhequr rreth pesë milje në veri të Fano-s dhe Merleres, hapet në dymbëdhjetë degë midis shkëmbinjve, gjysmë e lodhur nga lëvizja e valëve* ...Për t’u dëgjuar, është e nevojshme të dihet se Porti i Palermos, në një periferi të përafërt prej pesë miljesh, duke përfshirë këtu sinuozitetet dhe aksidentet e bregdetit, paraqet tre ankorime të dallueshme, krahë malesh të larta dhe të paarritshme në disa vende; të aftë, në zhvillimin e tyre, të strehojnë një flotë të

konsiderueshme”.

Pra edhe pjesa e projekcionit gjeografik, apo shkëmbor, ose e emërtuar ndryshe edhe si kodra ku ngrihet kështjella, na shfaqet me përmbajtjen e elementeve që dëshmojnë për ekzistencën në të, të strukturave të një qendre të banuar, apo të një njësie të fortifikuar në mbrojtje të portit, ose të limanit. Dhe, për ta zgjeruar edhe më tej argumentin në këtë pikë gjeografike dhe strategjike të portit, sjellim në vëmendje rezultatet e një ekspedite arkeologjike nënujore, të realizuar këtu në periudhën 2007-2008, ndërkohë që u publikuan në përfundim të përpunimit të të dhënave.

Saktësisht, të dhënat e detajuara u publikuan në fillim të muajit maj të vitit 2008. “Progetto Liburna Archeologia subacquea in Albania Campagne 2007/2008”) ishte projekti që plotësoi disi boshllëkun e kërkimeve arkeologjike dhe nxjerrjen në pah të të dhënave që do të përmbushnin në mënyrë të konsiderueshme tablonë e ekzistencës dhe funksionimit në kohë të Porto Palermos, si një nga portet më të rëndësishme në rajon, prej lashtësisë. [7] **Progetto Liburna Archeologia subacquea in Albania Campagne 2007/2008 L'ARCHEOLOGO SUBACQUEO XIV, 2-3. Maggio-Dicembre 2008.**



Dhe, në fakt, sa herë tentohet të ridimensionohet vizioni për këtë gji natyror, që ka funksionuar si një port i rëndësishëm rajonal, përgjatë mijëra viteve, evokohet ajo çka është shkruar për të nga gjeografë të shquar të antikitetit, ndër të cilët, Straboni, mbetet ndër më të cituarit. Dëshmia e **Straboni (Strab. VII, 5.8 dhe 7.5)** sipas të cilit “...**porti i madh Pànormos, i vendosur në qendër të maleve të Ceraunit, ishte në rrugën që të çonte në Gjirin e Ambrakisë dhe Korinthit, në një distancë prej 1300 stadesh dhe ishte lidhur me Orikumin, porti i të cilit do të ishte...**”. Përcaktimi strabonian, edhe pse disi kontradiktor në dukje, për shkak se qyteti i Orikumit ishte i pajisur ndërkohë me një strukturë të madhe porti në periudhën që citohet, në të vërtetë evidenton rëndësinë e Panormos, atë që në fakt, duket se ka qenë një nga rolet kryesore të këtij porti prej lashtësisë; shkurtimein e distancave për të lundruar dhe për të kapur më lehtë Korcira (Kerkyra) dhe destinacionet juglindore, duke shmangur kështu rrotullimin përreth kepit Acroceraunio. Përkundër kësaj, porti i Orikumit garantonte rrugët detare në drejtim të veriut.



Fig. 3 – Harta që pasqyron rrugët detare nga brigjet e Italisë drejt Himarës (Panormës) dhe Korfuzit

Duke u rikthyer tek përfundimet e nxjerr nga kërkimet arkeologjike në Porto Palermo, në kuadër të projektit të sipërpërmendur, duhet të theksojmë se, gjiri si një hapësirë e mbrojtur natyrore, ofron mundësi ancorimi të mrekullueshme në të gjithë hapësirën dhe në të gjitha stinët dhe sfidat atmosferike, falë konfigurimit natyror. Kjo veçanti, i ka dhënë këtij porti vlera të veçanta qysh në lashtësi, duke u cilësuar shpesh si një port natyror.

Por, në një përcaktim më të saktë, Porto Palermo (Panorma), mund të ndahet në tre zona përkatëse.

1. Në veri të ishullit, ku ofrohet strehë dhe mbrojtje për mjetet lundruese nga era jugore;
2. Zona e vendosur në veriperëndim të gjirit, që përkon me hyrjen për në tunelin e nëndetëseve, ku mundësohet mbrojtja nga era e veriut, që vlerësohet sfida atmosferike më e rrezikshme
3. Zona jugore, që ofron mbrojtje mjaft të mirë nga erërat e jugut, juglindjes dhe jugperëndimit.

Të tre këto zona u bënë objekt i kërkimeve dhe gjetjeve arkeologjike (më pak zona 3, për shkak të vështirësive natyrore), gjatë të cilave u nxorën edhe përfundimet përkatëse dhe që shkojnë në kahe të plotësimit të kuadrit të perceptimit të kësaj hapësire detare në të gjitha dimensionet.




Fig. 5 – Harta e zonave të marra në studim

Përpara se të paraqesim shkurtimisht rezultatet e këtyre kërkimeve arkeologjike nënujore, duhet theksuar se, ekspertët e përfshirë në këtë proces, mendojnë se, projekcioni shkëmbor ku është ndërtuar kështjella, ka qenë një ishull, i cili më pas është mbushur me material natyror, duke krijuar kështu istmin artificial, që e lidh atë me brezin e tokës. “... në shtrirjen qendrore të bregdetit midis dy kepave ndodhet një ishull (i lidhur më pas me tokën përmes një istmushi artificial).”.[8] *Progetto Liburna Archeologia subacquea in Albania Campagne 2007/2008 L'ARCHEOLOGO SUBACQUEO XIV, 2-3. Maggio-Dicembre 2008.*

Nisur edhe nga faktet dokumentare të prezantuara deri tani, rezultatet e kërkimeve arkeologjike duket se shkuan në të njëjtën kah të përforcimit të tyre, çka nis qysh me zonën ku u shfaqën rezultate më të shumta me interes arkeologjik dhe që përkon me pjesën në veri të ishullit, në një distancë 25 deri në 35 metra prej tij, ku ekziston një pengesë shkëmbore natyrore e cila ka nxitur procesin e grumbullimit dhe konservimit të materialeve, duke parandaluar rrëshqitjen e tyre përgjatë shtratit të pjerrët të detit. “Prania e rrënojave në zonë duket shumë e mundshme, megjithëse me siguri, duke pasur parasysh natyrën e shtratit të detit të karakterizuar nga një pjerrësi e fortë drejt qendrës së gjirit, ku thellësia i kalon 80 metra, ato mund të vendosen në thellësi të konsiderueshme, të paarrtshme nga mjetet e zhytjes normale me cilindra ajri.

Që gjiri i Porto Palermos mund të sigurojë strehë ose të lejojë ancorime të përkohshme gjatë rrugëve të transportit bregdetar, si dhe nga materiali amforik i rikuperuar, konfirmohet nga dy lloj trungje plumbi, spirancë fikse e epokës romake, njëra prej të cilave e lënë në fund, e futur mes shkëmbinjve - ndoshta shkak i braktisjes në këtë gjiri në kohët e lashta - dhe tjetra me një kuti drejtkëndëshe pa strumbullar me dy krahë të rumbullakosur në fund dhe në pjesë e lakuar”.[9] *Progetto Liburna Archeologia subacquea in Albania Campagne 2007/2008 L'ARCHEOLOGO SUBACQUEO XIV, 2-3. Maggio-Dicembre 2008.*



Fig. 6 – Foto e një spirance të zbuluar gjatë kërkimeve arkeologjike nënujore Projekti L'ARCHEOLOGICO SUBACQUEO XIV

Nisur nga ky realitet, apo më saktë dokumentacion arkeologjik, grupi i ekspertëve arriti në përfundimin se, gjithçka dëshmon për një frekuentim të Porto Palermos gjatë të paktën një mijë vjetësh të historisë së lundrimit. **Dhe, më tej akoma, ky dokumentacion arkeologjik i grumbulluar në këto kërkime nënujore, provon faktin e rëndësishëm të përfshirjes së plotë të këtij porti, si edhe të territorit shqiptar në rrugët kryesore detare tregtare, me prioritet zonën e Adriatikut dhe atë të Mesdheut lindor.**

Materiali i shumtë qeramik dhe metalik, në formën e amforave, spirancave etj., që u grumbullua dhe që ju nënshtua procesit të vlerësimit laboratorik, rikuperimit etj., krijoi një mundësi të gjerë perceptimi e vëzhgimi, për të nxjerrë përfundime lidhur me periudhën historike të frekuentimit të këtij gjiri natyror, të këtij porti, në përgjithësi të kësaj shtrirjeje bregdetare. Janë përfundime mjaft interesante, sepse edhe materiali i gjetur ka qenë i tillë. Kështu, mes enëve më të vjetra të gjetura dhe që përdorshin për nevojat e transportit, u identifikuan fragmente që dëshmonin formën e kalimit midis amforave të llojit greko-italike dhe Lamboglia 2, të dhëna që përkonin me periudhën midis shekujve të tretë dhe të dytë. p.e.s., apo amforave të përhapura në rajonin e Adriatikut, duke filluar nga gjysma e dytë e shek. I p.e.s. dhe gjatë gjithë shekullit I e.s.



Foto 7 – Amforë e gjetur gjatë kërkimeve arkeologjike nënujore Projekti L'ARCHEOLOGICO SUBACQUEO XIV

Rezultatet e kësaj ekspedite arkeologjike, që synonte gjurmimin e frekuentimit të zonës me karakter portual, vijnë edhe me detaje të tjera interesante, mes të cilave përfshihet edhe një amforë që mendohet të jetë prodhuar në Kios rreth fundit të shek. I p.e.s., ndërkohë që periudha antike e vonë përfaqësohet nga një sërë materialesh të tjera arkeologjike ku veçon një tip amforë cisternë. Në vijim, në materialin e gjetur, evidentohet edhe prania e një koleksioni Güsenin III, që është tipik për periudhën mes shekujve XII dhe XIII. Dhe po ashtu u gjetën edhe një enë zjarri qeramike me një mur të rrahur, një enë e emaluar dhe një pjatë, e cila mendohet se i përket dhe përkon me prodhimin e qeramikës tradicionale pulieze të shekullit të 19-të.



Foto 8 – majtas, Amfora Chiota (zona 8), në Qendër Amfora Lamboglia (zona 3), djathtas Amfora Cretese TRCI (zona 8)


Po ashtu gjatë kërkimeve nënujore të shtrira në pika të tjera të gjirit, sikundër dëshmohet edhe në hartën shoqëruese, janë gjetur amfora që janë të dokumentuara qartësisht në depozitat detare të Italisë së Jugut, Sicilisë, por po ashtu edhe në veri të Adriatikut, në detin Tirren, si edhe në brigjet e Afrikës së Veriut, Korintit, Korfuzit, përgjatë brigjeve të Salentos, kanalit të Otrantos etj. Përfshihet gjithashtu edhe një amforë e prodhuar në një nga ishujt e bregdetit kroat. Ndërkohë, një detaj interesant, lidhet me fazën arkaike, përmes gjetjes së amforës “chiota”, që u identifikua në Zonën 8, sipas figurës që përfaqëson hartën e kërkimeve arkeologjike nënujore.

Veçantia e këtij fakti, lidhet edhe me zonën ku u gjet kjo amforë, e cila është diku pranë bregut, mes projeksionit shkëmbor dhe kepit juglindor. Kjo dëshmon ekzistencën e aktivitetit në një fashë më të gjerë, që, siç perceptohet lehtësisht, kap gjithë gjerësinë e gjirit. Kjo dëshmi interesante, na e provon këtë gjë, si një detaj që na jep të kuptojmë se hapësira detare e Porto Palermos, ka qenë funksionale në të gjithë gjeografinë e saj, në dimensionin natyror dhe kohor.

Janë gjithashtu me mjaft vlerë dhe çojnë në interpretime të rëndësishme, duke zgjeruar perceptimin e pranisë së aktivitetit portual në këtë gji detar, përgjatë disa periudhave historike, gjetjet në pika të tjera të kësaj hapësire detare, sipas skemës së figurës ilustruese për këtë ekspeditë arkeologjike nënujore.

Nga ana tjetër gjetja, e një grupi prej 5 ekzemplarësh, të gjithë të përqendruar në të njëjtën zonë (zona 2 dhe 3), në një thellësi midis 26 dhe 32 metra, mund të çojë në hipotezën e pranisë së një rrënoje, ngarkesa e së cilës është shpërndarë në pika ku thellësia është më e madhe. Kjo dëshmon për mundësinë e ekzistencës së strukturave fortifikuese në projeksionin shkëmbor, ku sot ndodhet kështjella.

Ndërkohë, zbulimi në zonën 9, i një qafe amfore të vonë të Rodias së vonë dhe një amfore të llojit Kretas TRC 1 (Zona 2), që daton në shek. IV e.s në fazën fillestare të prodhimit të tij, dëshmon për ekzistencën dhe zhvillimin e tregtisë së verërave me zonën e Egjeut.



Amfora Zemer 57 (area 9).

Amfora Dressel 24 (area 1).

Amfora Africana II D1 (area 8)

Fig. 9 – majtas Amfora Zemër 57 (zona 9), qendër Amfora Dressel 24 (zona 1), Amfora Afrikana II D1 (zona 8)

Veç këtyre, kronologjikisht, në materialin e shumtë arkeologjik që u gjet gjatë ekspeditës në fjalë, përfshihen, amfora Dressel 24, e cila për krahasim me disa ekzemplarë të dëshmuar në Pompei dhe Ostia, datohet në një periudhë më të hershme (shek. I pas Krishtit), amfora që i përkasin familjes së amforave të grupuara në klasifikimin e D. Pieri si ATO 8 (Amphore Tardive Orientale 8), amfora Agorà M 273 (Zona 2), Agorà M 328 dhe lloji i amforës Samos, të cilat mund të klasifikohen në mënyrë kronologjike, ndërmjet shekullit V dhe VII dhe përdoren për transportin e verës, një enë e referuar si ‘amforë globulare’ ose LR 2 similis,

e prodhimit oriental në shekullin VII dhe morfologjikisht e krahasueshme me një ekzemplar të dokumentuar në Stamboll, qeramika e zakonshme nga tavolina dhe qilarja, tenxheret për gatimin e ushqimeve të periudhës së antikitetit të vonë, mesjetare dhe moderne, vërtetime të qeramikës tradicionale të epokës bashkëkohore dhe soba me tub terrakote.

Dhe, së bashku me këto, amforat e tipit Otranto I dhe II (Zona 1) së bashku me Güsenin III, dëshmojnë për qarkullimin e mallrave në gjirin e Porto Palermos, në periudhën mesjetare.



Foto 10 – majtas Amfora LR2 (zona 3), qendër Amfora Otranto (zona 1), djathtas Amfora Gusein (zona 3)

Interpretimi i këtij materiali arkeologjik nënujor, çon në një përfundim të padyshimtë se, aktiviteti portual në Porto Palermo, është i pranishëm në të gjitha periudhat, nga prehistoria, deri në ato moderne, në fillim të shekullit XIX, kur ajo vlerësohet si një pikë e avancuar e Pashallëkut të Janinës, nën sundimin e Ali Pashës, si pjesë e strategjisë së tij për ekspansion terriroresh dhe zgjerim.

Mjafton ky material arkeologjik i gjetur në zonën nënujore të Porto Palermos, për të nxjerrë përfundime të rëndësishme, që e përcaktojnë këtë gji detar, si një nyje të rëndësishme detare, për aktivitetin tregtar me rajone të ndryshme.

Amforat, duke qenë mbartësit kryesorë të produkteve të vajit dhe të verës që importoheshin apo eksportoheshin përmes detit, në antikitet, përbëjnë edhe informacionin kryesor për të krijuar një

vizion të qartë për tregtinë antike, ashtu sikundër edhe për t'u njohur me zhvillimin e shkëmbimeve tregtare mes vendeve dhe rajoneve të ndryshme. Kështu për shembull, kolonët korintas dhe korkyras ishin ata që integruan bregdetin e Adriatikut lindor apo të Epirit, në një rrjet të gjerë shkëmbimesh me botën greke.

Në fakt, amforat korintike A dhe B, janë pjesë e materialit arkeologjik të gjetur në Porto Palermo, ashtu siç janë gjetur edhe amforat e tipit Rodi, si dëshmi e aktivitetit tregtar të këtij porti me ishujt e Egjeut. Në fakt, rolin kryesor në fluksin e importeve nga ishujt e Egjeut e luan Rodi. Sikurse e pamë më lart, përveç amforave të Rodosit, në këtë dokumentacion arkeologjik janë të pranishme edhe ato të ishujve të tjerë të Egjeut, Tasosit, Kiosit dhe Samosit. Këtu duhet të veçojmë një fakt mjaft interesant. Për herë të parë pas Durrësit, një amforë e llojit të Kiosit, zbulohet në nënujin e Porto Palermos. Për të perceptuar veçantinë e një fakti të tillë, mjafton të citojmë Saimir Shpuzën, i cili për këtë amforë shprehet; *“...amforat e Kiosit, që eksportojnë verën shumë të njohur të këtij ishulli, i gjejmë vetëm në Durrës, për shkak se kjo lloj vere ishte e një cilësie shumë të lartë dhe konsumohej vetëm në qytetet ku jetonin elita shumë të pasura”*.

Kuptohet qartësisht domethënia e pranisë së kësaj amfore, për të menduar se, elita e komunitetit të banorëve në këtë zonë, importonte dhe konsumonte verën e Kiosit, me parametrat që përmend Shpuza. Nga ana tjetër, duhet theksuar fakti se, fundi i shekullit III p.e.s, është shumë i rëndësishëm për sa u takon shkëmbimeve tregtare në Adriatik, por jo vetëm. Në këtë periudhë, nis të dobësohet monopoli egjean, si rrjedhojë e një sërë faktorësh ku më i rëndësishmi është politika e re tregtare që ndoqën Roma dhe Athina, në kuadër të riorganizimit në Mesdhe, si dhe pasojë e një orientimi të ri të tregtisë së Rodit. Në këto kushte, tregtarët italikë të verës dhe të vajit, monopolizuan tregtinë e këtyre rajoneve që mbetën jashtë influencës së Rodit. *“Italianët e vendosur qysh në shekullin II p.e.s në Iliri, luajtën dhe rolin kryesor në futjen e verës italike në këto terrirore”*. [10] *Saimir Shpuza. Importimi dhe prodhimi i verës dhe vajit në Ilirinë e Jugut (shekujt III-I p. e. s.) / Import and Local Production of Wine and Oil in the South Illyria (III-I Centuries B. C.) Iliria Année 2007, 33. pp. 219-232*

Ky fakt, reflektohet përmes prezencës së shpeshtë të amforave greko-italike, që, sikurse analizuam më lartë, janë të pranishme edhe në Porto Palermo. Këto amfora të prodhuara në shekujt III dhe II p.e.s në Siçili dhe Magna Grecia, dëshmojnë edhe për shkëmbimet e para në masë ndërmjet dy brigjeve të Adriatikut. Ato i gjejmë pothuajse në të gjitha qendrat ilire dhe në Epir, ndërkohë që më pas u zëvendësuan nga amforat Dressel, Lamboglia dhe ato të Brindisit, të cilat janë përdorur si bartësit kryesorë të vajit dhe të verës, gjatë dy shekujve të fundit para erës sonë.

Amforat Lamboglia 2, që prodhoheshin në pjesën adriatikase të Italisë, janë gjetur mes të tjerash edhe në Butrint dhe Sarandë, ndërkohë që duhet thënë se, bashkë me Dressel 1, prezenca e tyre, haset vetëm në qytetet kryesore, përkundër faktit që greko italiket gjejnë përhapje në shumë qendra të brendësisë së territorit. “Kjo lidhet me faktin që, ndoshta braktisja e pjesës më të madhe të qendrave ilire si pasojë e administrimit të ri romak, bëri që jeta të përqendrohej vetëm në qendrat kryesore, prandaj dhe këto amfora gjejnë përhapje të limituar”. [11] *Saimir Shpuza. Importimi dhe prodhimi i verës dhe vajit në Ilirinë e Jugut (shekujt III-I p. e. s.) / Import and Local Production of Wine and Oil in the South Illyria (III-I Centuries B. C.) Iliria Année 2007, 33. pp. 219-232*

Në këtë arsyetim duhet theksuar se, në përputhje edhe me përshkrimin që bën Ptoleme për Panormën, si qendër e banuar dhe port, ajo duhet të ketë qenë vërtetë e tillë. Por, jo vetëm kaq. Ajo mund të ketë marrë më shumë rëndësi, në fund të shekullit II p.e.s, kur romakët ndërmorën një ekspeditë shkatërruese në Epir, në përfundim të konfliktit iliro-romak të vitit 170 p.e.s, ku u përfshinë edhe Epiri dhe Maqedonia. Pas triumfit të Romës, konsulli romak Pal Emili, me lejen e senatit, shkatërroi 70 qytete dhe ktheu në skllëvër 150 mijë njerëz të cilët u dërguan në Romë. Këtë moment e përshkruan edhe Straboni, i cili shkruan mes të tjerash se, “gjithë Epiri dhe Iliria ishin të pasura. Kurse tani një pjesë prej tyre është shkretuar dhe vendet e banuara janë fshatra dhe gërmadha të braktisura”. (Straboni.VII,10) Paralizimi dhe rrënimi i vendit dhe shpërngulja e popullsisë nga zonat malore drejt atyre fushore dhe kodrinore, që ishte edhe një nga parimet e politikës që ndoqi Roma. Pjesë e këtij realiteti historik mund të jetë edhe kjo pjesë e Epirit. Pranë Panormës ishte një qendër

e banuar, e cila njihet me emrin qyteza e Karos, e cila ndodhej në veri të fshatit Qemaro, mbi një kodër shkëmbore në lartësi prej 450 metra mbi nivelin e detit. Mendohet se kjo qytezë të ketë përjetuar fundin e vet, në periudhën në fjalë dhe popullsia e mbetur të jetë zhvendosur drejt bregdetit.

Porto Palermo, ka qenë aty, një gji natyror dhe një port i rëndësishëm, pjesë e rrugëve detare të lundrimit për një periudhë mijëra vjeçare.

“Panormos duhet të ketë qenë stacioni portual kryesor, por jo i vetmi, i futur në një sistem të përmendur portesh të vogla natyrore (gjiri i Dafinës, Baia dell’Orso, etj.), disa prej të cilave kanë një vokacion të qartë detar dhe kulturor(Grama), që, e vendosur përgjatë një brezi të thyer bregdetar, atë të maleve të Acroceraunit, pa vendbanime të mëdha portuale, pas Butrintit dhe Onchesmos në jug dhe përpara Orikos dhe Aulonës në veri, e bën të sigurtë lundrimin bregdetar të anijeve të mëdha dhe të vogla”.

[12] *Giuliano Volpe, Giacomo Disantarosa, Danilo Leone, Maria Turchiano, Progetto Liburna Archeologia subacquea in Albania Campagne 2007/2008 L’ARCHEOLOGO SUBACQUEO XIV, 2-3. Maggio-Dicembre 2008.*

Të gjitha burimet dëshmojnë në çdo rast, për rëndësinë e Panormos, që e bënte më të lehtë lundrimin e anijeve drejt Korciras (Korfuzit) dhe në destinacionet e tjera juglindore, duke shmangur lundrimin përreth Kepit Acroceraunio, sikundër konfigurimet edhe në figurën shoqëruese.

“Ajo që është e rëndësishme të ritheksohet, është fakti se, nga dokumentacioni arkeologjik i grumbulluar, dëshmohet për një frekuentim të Porto Palermos gjatë një periudhe mijëvjeçare të historisë së lundrimit”. [13] *Giuliano Volpe, Giacomo Disantarosa, Danilo Leone, Maria Turchiano, Progetto Liburna Archeologia subacquea in Albania Campagne 2007/2008 L’ARCHEOLOGO SUBACQUEO XIV, 2-3. Maggio-Dicembre 2008.*

Nisur nga këto, vjen edhe një herë më e fortë dhe më tepër përcaktuese, dëshmia që na ka lënë gjeografi grek, Straboni, “Porti i madh Panormos, i vendosur në qendër të maleve të Ceraunit, ndodhej në rrugën që të çonte në Gjirin e Ambrakisë në Korinth, në një distancë prej 1300 stadesh dhe lidhej me Orikos, prej të cilit. do të përbënte portin”. [14] *Straboni*

5. STRAB 7.5.8: μετὰ δ' Ἀπολλωνίαν Βουλιακὴ καὶ Ἰρικὸν καὶ τὸ ἐπίγειον αὐτοῦ ὁ Πάνορμος καὶ τὰ Κεραυνία ὄρη, ἡ ἀρχὴ τοῦ στόματος τοῦ Ἰονίου κόλπου καὶ τοῦ Ἀδρίου. STRAB 7.7.5: ὁ δὲ πλοῦς ἀπὸ τῶν Χαθόνων ἀρξαιένω πρὸς ἀνίσχοντα ἦλιον καὶ πρὸς τὸν Ἀμβρακικὸν κόλπον καὶ τὸν Κορινθιακόν, ἐν δεξιᾷ ἔχοντι τὸ Αὐσονίον πέλαγος, ἐν ἀριστερᾷ δὲ τὴν Ἠπειρον, εἰσὶ χίλιοι καὶ τριακόσιοι στάδιοι ἀπὸ τῶν Κεραυνίων ἐπὶ τὸ στόμα τοῦ Ἀμβρακικοῦ κόλπου. ἐν τούτῳ δ' ἐστὶ τῷ διαστήματι Πάνορμος τε λιμὴν μέγας ἐν μέσοις τοῖς Κεραυνίοις ὄρεσι, καὶ μετὰ ταῦτα Ὀγγησμος λιμὴν ἄλλος κτλ. Recentemente a circa km 2 a sud-est del villaggio di Borsh è

Foto 11 – Shkrimi origjinal Straboni

Dhe përmes këtij porti të madh, ka lulëzuar tregtia me pikat dhe vendet më të njohura të rajonit dhe më gjerë, duke përfshirë Korinthin, ishujt e Egjeut, Korfuzin, Italinë, Kroacinë, Afrikën e Veriut, një port ku janë ancoruar edhe anijet romake, që kanë lënë pas gjurmët e tyre, si një dëshmi e gjallë e intensitetit të komunikimit mes dy brigjeve. Një pikë e tillë me rëndësi, nuk kishte sesi të përvijohet vetëm si një gji apo port natyror, ndërkohë që aktiviteti, siç edhe argumentuam më sipër ishte më shumë se i tillë.

Prandaj dhe Porto Palermo, Panorma e antikitetit dhe e prehistorisë, ka përcjellë deri vonë dimensionet e një qendre, që i tejkalon ato të një porti, aq më shumë natyror.

KAPITULLI II

Himara, një histori nga thellësia e shekujve

Historia e Himarës nis në thellësinë e shekujve. Sipas Moikom Zeqos, *“...emri i saj përmendet tek Homeri, të paktën prej shekullit XIII përpara Krishtit”*.

Madje edhe Marin Barleti, duke cituar Homerin, shkruan se, *“kjo është Himara e Odiseut, vend malor kundrejt Korkyrës, me popull të pamposhtur, luftarak”*.

Gjithashtu, Dhimos Budina, në përshkrimin që i bën Himarës, në shumë dimensione që lidhen me hershmërinë e saj, si qendër e banuar, apo e fortifikuar, ndalet mes të tjerash tek kështjella e saj, ku, siç thekson ai, *“...përveç mureve antike, kalaja ka edhe mure mesjetare. Muret antike janë ndërtuar me blloqe gurësh të mëdhenj në formë paralelopipedi dhe trapezoide. Blloqet janë punuar mirë në të katër faqet e anshme. Ato janë vendosur në të thatë në fugatura të rregullta. Nga ana e jugut ka një kullë katërkëndëshe, në një lartësi prej pesë radhë gurësh. Sipas analogjisë me monumentet e tjera dhe teknikës së ndërtimit, ato i përkasin shek. III p.e. sonë”*. [15] (Dh. Budina. Raport i vitit 1962. *“Harta arkeologjike e Bregdetit Jon dhe e pellgut të Delvinës”*. Iliria 1971 1 pp. 275-342)





Foto 12 – Fragment e murit rrethues të Kështjellës së Himarës

Si një qendër të fortifikuar, Himarën e përmend Plini (NHIV, 1), të cilën e vendos mbi malet Akrokeraune. Gjithashtu, Spiro Rusha, në librin e tij, “Himara në stuhitë e shekujve”, parashtron idenë e vet se Himara është përmendur edhe nga Homeri, tek “Odiseja”, ku përshkruan episode nga lundrimi i tij; “Odiseja është nisur nga ishulli Ajaja, ku banonte Çircjia dhe lundroi nga perëndimi drejt lindjes dhe arritën atje ku është krahina dhe qyteti i burrave himariotë,ku populli jeton pa e parë diellin për shkak të reve të mjegullës, që mbulon tërë krahinën”. [16] (S. Rusha. *Himara në stuhitë e shekujve*. Tiranë, 2002.

“...Nga perëndimi, kur rrugët i mbulojnë hijet e natës, arritëm në kufijtë e oqeanit, ku truall e banesa kanë kimerët. Jeton ky popull krejt mbuluar me mjegull dhe me re, pëlhurë që kurrë s’e çan të thuash, një rreze dielli”. [17] Homeri. “Odisea”. *Kënga XI.15*

Dhe, për të përforcuar këtë hipotezë, kemi edhe përshkrimet e François Pouqueville, konsull i Francës në oborin e Ali Pashë Tepelenës në Janinë, i cili pranon faktin se, në periudhën që përshkruan Homeri, ato re mund të ishin ndoshta produkt i vullkaneve. “Nëse Homeri zgjodhi malet e Çimarës për skenën e marrëdhënieve skëterre, për shkak të avujve të dëmshëm me të cilët, në kohën e tij, ato ishin të bollshme, gjërat duhet të kenë

ndryshuar shumë në rrjedhën e tre mijë viteve. Sepse, në kohën e sotme, asnjë pjesë e bregdetit të Epirit nuk zotëron ajër më të pastër dhe më të pastër, se shpatet perëndimore të maleve të Çimarës” [18] (François Pouqueville. *Voyage de La GRECE*).



Në fakt, Pouqueville, është ndalur në një përshkrim të detajuar të Himarës, duke nisur nga antikiteti dhe duke na lënë gjurmë të periudhave të hershme në këtë krahinë me emër. Përshkrimet e tij janë të veçanta dhe në disa prej tyre, ai u referohet autorëve të lashtë, si Homerit, apo emrave të tjerë të shquar të antikitetit. Duke patur si referencë Homerin dhe librin e tij “Odisea”, Pouqueville shprehet mes të tjerash se, “Ceraunia është vendi që supozohet nga disa komentues për t’u treguar nga Circe në udhëzimet e saj drejtuar Ulksit, ku ai duhej të gjente Aornosin, atje për të thirrur hijen e Tiresias, për t’u konsultuar me të në lidhje me procedurat e tij përfundimtare”.

“*Acroceraunian, ose më saktë malet Cerauniane, u quajtën kështu nga të lashtët, nga termi grek keraunos, që nënkupton bubullima; sepse, nga lartësia e tyre, dhe veçanërisht nga pozicioni i tyre në det, ata ishin shumë të ekspozuar dhe shpesh u vërejtën të goditeshin nga rrufeja*”, jep shpjegimin e vet, Pouqueville në lbrin e tij, ku Himara zë një vend të veçantë. Sepse teksa, nisët në udhëtimin e tij, nga Raguza (Dubrovniku i sotëm), ai përshkon një itinerar sfidues në lundrimin e vet plot të papritura, duke u ankoruar fillimisht në ishullin e Sazanit, përballë maleve Akrokeraune, për të vijuar më pas drejt Porto Palermos, që ishte edhe skela e parë dhe më e afërt, rreth 7 milje larg Korfuzit. Ndjesia që i krijon madhështia e këtyre brigjeve, nuk mund të mos lerë mbresa tek Pouqueville, një njeri sigurisht mjaft i ditur, i cili, mesa duket përpara nisjes së tij, ka shfletuar mjaft autorë për t’u njohur me vendet ku do të qëndronte vite të tëra në përmbushje të misionit të vet. Konsulli i Francës pranë Aliut, fillimisht një mik i shquar i tij dhe më pas, i shndërruar në një armik të deklaruar, për shkak të interesave të kundërta të vendit të tij me ato të Pashait të Janinës, do t’i botonte këto mbresa, në atë që përbën librin e tij, me titull “**Voyage de La Grece**” dhe që është një nga burimet më të cituara nga studiues të ndryshëm, që kanë patur në fokusin e tyre profilin e këtij pashallëku dhe raporteve të tij me Portën e Lartë.

Duke u zhytur tërësisht në këtë histori që lë mbresa të pashlyera, duke u zhvendosur në shekuj njeri pas tjetrit, duke kapërcyer periudha e personazhe historike, Pouqueville, e bën edhe më konkret përshkrimin e vet, duke sjellë në vëmendje margaritarë kuriozitetesh e faktesh, të cilat ai i qëmton nga kujtesa e vet, nga vepra të autorëve të lashtë që ai i ka në mendje. Për një moment, ai bën një “hop”, nga Homeri dhe zhvendoset diku pranë mesjetës, në një trajektore të mrekullueshme që të ngelet në mendje. Duket se madhështia e Himarës, e këtyre maleve, ajo çka ai ka lexuar për të, për historinë e saj, të vjetër dhe të re, e kanë lënë të mrekulluar, e kanë bërë disi edhe poet. Dhe ai hyn në detaje, duke i renditur ato në sfondin e natyrës së egër dhe të mrekullueshme dhe të historisë së shekujve. Ja si e përshkruan ai në një moment, duke ju referuar kështjellës së Himarës, pjesës së brendshme të saj. “... por në lagje duhet parë një mbyllje, me sa duket e një moshe

shumë të madhe, ndoshta mbetjet e Chimaæra e Homerit, pranë së cilës Plini vendos Shatërvanin Mbretëror. Ky fortifikim i lashtë është quajtur nga vendasit “Kështjella e vjetër e mbretëreshës”, për shkak të monedhave që gjenden shpesh në të, që mbajnë figurën e një femre, me një Pegasus në anën e pasme; emblema që përgjithësisht i atribuohen Apolonisë, më në veri në bregdet. Mbretëresha për të cilën aludohet nga Chimariotët, ishte ndoshta princesha Anna Comnena, e cila përmend Chimarën në historinë e saj të garës, midis babait të saj Aleksis dhe normanëve, në fund të shekullit të njëmbëdhjetë. Me përmbysjen e qytetit të vjetër, banorët e mbijetuar themeluan Çimarën e sotme, me rreth 500 familje, të gjithë të krishterë”. [17] **François Pouqueville. Voyage de La Grece**)

Ai sjell ngjarje pas ngjarjeje, si për ta bërë më konkret dhe më bindës rrëfimin. Nuk i qëndron gjithmonë besnik narracionit të vet, herë - herë me nota poetike, por grumbullon dhe përzgjedh momente e personazhe, shpesh edhe duke rendur pas tyre, pa respektuar kronologjinë kohore. Nuk ka sesi, t’i shpëtojë atij një nga ngjarjet më të shënuara të fiksuara në brigjet e Himarës, poshtë Palasës, një nga fshatrat më të spikatura të kësaj krahine, ku, siç shprehet ai “...një ligë e gjysmë në veriperëndim nga ai vend është përroi i “Strada Bianca”, ose “Rouga aspri” (Rrugët e bardha”-shën.im), i vënë re më parë, përtej të cilit është gjiri dhe rruga e Daorsos, e quajtur nga italianët Val d’Orso”. Dhe, pikërisht në këtë vend, në vitin 48 p.e. sonë, zbarkoi Çezari në pikëfillimin e aksionit të tij kundër rivalit, Pompeut. “Emri i Palæassa kujton Palæste e Cezarit, ku trupat e tij u zbarkuan në këtë bregdet, kur ndiqte antagonistin e tij Pompey. Por “stacioni i qetë për anijet mes shkëmbinjve dhe rreziqeve të tjera të bregdetit Ceraunian”, i përmendur në Komentaret (B. Civ. III. 6.) nuk është aq i dukshëm...”. [18] (**F.Pouqueville. “Voyage de La Grece”**)

Pouqueville, është ndoshta nja nga udhëtarët e huaj që i kanë kushtuar më shumë vend Himarës dhe historisë së saj, në përshkrimet e tyre. Ai i referohet mjaftueshëm antikitetit, duke cituar dhe veçuar pasazhe që janë spikatës për historinë e saj. Duke cituar herë pas here Homerin, ai sjell në vëmendje dimensionet e asaj çka përfaqëson Himara në sfondin historik. Sikundër cituam

më lart, Pouqueville është i mendimit se, në Himarë ndodhet “Burimi i Argjendtë”, të cilin e përmend Plini. Kjo lidhet me atë që thuhet në dokumentet mesjetare, ku përmendet “Burimi Mbretëror”, ku vinin edhe perandorët e Bizantit.

Dhe, traditën luftarake dhe historinë e pasur të kësaj krahine, e përmend edhe Marin Barleti, i cili, mes të tjerash sjell shembullin e princit Andrea Topia, si pjesëmarrës në Kuvendin e Lezhës, ku, sipas tij, ai ka pohuar se, paraardhësit e tij, “.. *ishin të njohur si princër edhe për sundimin e Himarës së Ulksit, një vend malor përballë Korkyrës, ku banon një popull i pamposhtur dhe trim.... të cilin e quajmë zakonisht himarjotë. Ata i kanë përbuzur gjithmonë turqit e harbuar pas nënshtrimit të Epirit, me vdekjen e Skënderbeut dhe kanë jetuar me një farë lirie të pashoqe të natyrës*”.[19] (Marin Barleti. *Histori e Skënderbeut*. Fq.93.)

Ndërkohë, është mbresëlënëse ajo që ka thënë francezi, Leon Rei, se, “...*Shqipëria mund të mburret me historinë e Himarës*”.

Dhe, kështu, gurët e mozaikut të historisë së kësaj krahine në shekuj, nisin dhe plotësohen periudhë pas periudhe. Sipas, Moikom Zeqo, themelet e mureve të kalasë së Himarës kanë gurë të mëdhenj ciklopikë, të tipizuara si mure pellazgjike, që të paktën janë të lashtë prej shekullit V para Krishtit, por, shton ai, padyshim në këto mure, jeta ka qenë më e vjetër.



Foto 13 – Harta topografike e Kalasë së Himarës

“Pashë dhe vëzhgova në mënyrë të veçantë kalanë e Himarës. Muret pellazgjike qenë tepër të dukshme, hijerënda dhe të lexueshme. Mbi to dukeshin mbeturinat e rindërtimit të kësaj kalaje nga Justiniani i Madh...Kjo kala pati një rindërtim edhe në shekullin XII, gjatë betejave apokaliptike të normanëve nga njëra anë dhe bizantinëve dhe arbërve nga ana tjetër”. [20] (Moikom Zeqo. “*Të vërteta të panjohura e të pathëna për Himarën*”. Tiranë 5.05.2003).

Dhe, kështu historia e Himarës, pasurohet. Shkrimet për të shtohen, ashtu siç shtohen edhe ata që shkruajnë për të. Sepse, historia e saj është grishëse. Të nxit për të depërtuar tek ajo, për të eksploruar e nxjerrë vlera. Prandaj dhe gjithçka që zbulon për historinë e kësaj krahine, të shtyn ta evidentosh. “Himara shfaqet në një dimension të trefishtë territorial. Në Defterin 1431/1432, Himara emërtohet si një qytet (nefs-i Himara) dhe kishte 117 shtëpi, gjë që e vinte atë në të njëjtin nivel me Gjirokastrën (121 shtëpi) e Krujën (125 shtëpi)”. [21] (Pëllumb Xhufi. *Arbërit e Jonit*. Fq. 134.)

Dhe, më tej, ai saktëson se, “Por, pavarësisht ndarjeve administrative osmane, burimet e identifikojnë shpeshherë Himarën me krejt krahinën e Labërisë (Arbërit). [22] (Pëllumb Xhufi. *Arbërit e Jonit*. Fq. 135.)

“Në 1566, në një raport, Juan Saetta, i dërguar i Mëkëmbësit të Napolit, e cilëson Himarën sërish si qytet. Si qytet e përmend edhe mitropolitin i Durrësit, Simon Laskari, më 1661). [23] (Pëllumb Xhufi. *Arbërit e Jonit*. Fq. 135)

Himara dëshmohet si peshkopatë qysh në vitin 1020, fillimisht nën varësinë e selisë mitropolitane të Ohrit e më tej të Paupaktit e duke filluar nga gjysma e dytë e shekullit XV, si sufragane e Janinës. Vetë kështjella e Himarës identifikohet ndonjëherë me kishën peshkopale të Shën Sergjit e Bakut. [24] (A. Meksi. “*Disa kapela bizantine të vendit tonë*”, në *Monumentet*. 10. 1975, fq. 79-80. Pëllumb Xhufi. *Arbërit e Jonit*. Fq. 136).

Një histori që shtrihet dhe rrok në vetvete, një hapësirë territoriale më të gjerë, ku çdo pjesë e saj, përbën një individualitet më vete. “Kështu, për komandantin venecian Domenico Mocenigo, më 1691, Himara ishte vargmali që zgjatej bregut të detit i shënuar

nga fshatra të ndryshme, ku nuk kishte “turq” (myslimanë). Në vitin 1732 në Himarë kishin mbetur vetëm 15 fshatra të krishtera, që do të ishin kthyer edhe ato, po të mos ishte vepra e misioneve baziliane që i vuri fre procesit të islamizimit në fshatrat e Bregut”.
[24] (Pëllumb Xhufi. Arbërit e Jonit. Fq. 135)

Në këtë pasazh të Xhufit, në një nga botimet e tij më të plota, marrim një informacion shumë kompleks për të dhëna dhe ngjarje të ndryshme, që në një këndvështrim të caktuar mund përcjellin mesazhe të rëndësishme. Mes tyre, prania e misionit bazilian, për të cilin do flasim pak më poshtë, përbën një nga informacionet më të rëndësishme, në disa dimensione.

Dhe, ndërkaq, duke mbetur tek ajo çka përfaqësonte Himara, në aspektin gjeografik, etnik, demografik, apo urban, na vjen në ndihmë sërish Pëllumb Xhufi, i cili bën një përcaktim më të detajuar, duke ju referuar një vëllimi dokumentar të gjerë.

“Si territor, emri Himarë i atribuohet sipas rastit, qytetit Himarë dhe provincës Himarë, dallim ky që bëhet nga vetë himarjotët në një letër të 14 tetorit 1566 për mëkëmbësin e Napolit. Provinca e Himarës përfshinte fshatrat Palasë, Dhërmi, Himarë, Vuno, Ilias, Pilur, Qeparo e Kudhës. Në fakt edhe në shekujt XV-XVIII, edhe të huajt e konsiderojnë Himarën pjesë të Shqipërisë, por një pjesë të veçantë të saj. Në raport me Shqipërinë që sundohej nga të huajt dhe e tillë ishte Shqipëria “veneciane” dhe Shqipëria “turke”, Himara bënte pjesë në territoret e lira shqiptare. Këtë status lirie, Himara e gëzonte falë “maleve të frikshme e të paafuërshme të saj”. Sigurisht, këtu nuk është fjala as për qytetin e Himarës e as për provincën e Himarës, por për një koncept më të gjerë. Në letrën që i dërguan Papës Gregori XIII, në 1581, Himarjotët i paraqesin atij emër për emër listën e fshatrave që, sipas tyre, përfshiheshin në konceptin Himarë. Lista fillon me Himarën qytet, që aty paraqitet si lokalitet e peshkopatë, e vazhdon me fshatrat Dukat, Brataj (Brocoto), Kallar, Tërbaç (Trumazei), Sotirianë, Palasë, Pangaladhë, Dhërmi, Ilias, Vuno, Qeparo, Kudhës, Pilur, Kuç, Progonat, Lopës, Kastel, Nivicë, Piqeras, Bunec, Tornichei (Vërmik), Bubar (që në vitin 1579 shfaqet e bashkuar me Nivicën duke krijuar fshatin Nivicë-Bubar), Borsh (Oressa), Baiades (??), Terna (Fterrë), Zarocorica (Çorraj), Kamenica, Finiqi, Damësi,

Lekli, Dragoti, Karjani (??), Kunevica (Gumenica), Peshtan, Bernacus (?), Ceprishta (?), Shën Vasili, Zhulati. Pra, brenda Himarës përfshihen edhe fshatrat e Labërisë, madje edhe ndonjë fshat i Toskërisë si, si Peshtan Dragot, Damës. Edhe dy shekuj më vonë në 1759, 17 nëntor, në letrën e tyre për careshën e Rusisë Elisabeta Petrovna, himarjotët flasin sërish me konceptin e Himarës së Madhe.

Më tej, konceptin e zgjeruar etno-demo-gjeografik për Himarën e jep Juan Thomas Saetta, i dërguar i Mëkëmbësit të Napolit, në 1566, në funksion të lidhjes së një aleance ushtarake mes Napolit e Himarës. Ai e nis me Palasën (Balascia), fshat i mbështetur në faqen e malit, 1.5 milje larg bregut, me 130 shtëpi dhe nxirrte 150 luftëtarë. Një milje larg Palasës ndodhej Pangalati (Pangalade), edhe ajo në faqe të malit në të njëjtën largësi nga deti si Palasa, me 200 familje dhe 250 luftëtarë. Pangalada, prej shekullit XVI-XVII, pushon së ekzistuari si vendbanim, Më tej vjen Dhërmiu (Trimade) me 90 familje, por nxirrte 150 luftëtarë; Iliasi (Igliati), 1.5 milje larg bregut, me 20 familje e 30 luftëtarë, Vuno me 250 familje. Më tej, Himara, në majë të një mali e rrethuar nga tre anë prej humnerave të thella. **Himara nuk kishte port.** Numri i familjeve ishte 300 dhe i luftëtarëve 350. Mandej Piluri, në lindje të Himarës, në majë të një mali. Banorët e tij vranë 200 turq, kur këta dogjën Himarën. Megjithëse ishin vetëm 80 familje, ishin në gjendje të nxirrnin 230 luftëtarë. *[25] (Pëllumb Xhufi. Arbërit e Jonit. Fq.121)*

Në rrjedhën e luftërave me Perandorinë Osmane, ku ajo nuk u nënshtrua asnjëherë, Himara spikat edhe për një ngjarje tërësisht të veçantë. Është fjala për kryengritjen e vitit 1537, kur në Himarë erdhi një nga sulltanët më të mëdhenj të të gjithë historisë së kësaj perandorie, Sulejman Kanunliu dhe, sipas historianëve osmanë, ai u sulmua nga një djalë himarjot gjatë kohës që pushonte, por, arriti të shpëtonte. Damiani, kështu quhej himarjoti, ndonëse nuk arriti të realizonte qëllimit, sepse u copëtua nga rojat e sulltanit, mbeti në historinë e kësaj krahine, por edhe më gjerë për këtë akt të jashtëzakonshëm, që pasonte atë që ndodhi në 1389 në Kosovë, kur u vra sulltan Murati.

Edhe në këtë betejë, himarjotët nuk u dorëzuan dhe nuk u

nënshkruan edhe në vijim, çka e detyroi Portën e Lartë t'i njihje Himarës një lloj autonomie. Kjo ngjarje përkon me momentin kur sulltani njohu dhe shpalli Venomet e Himarës. Venomet e Himarës, që u shkruan në pllaka bakri të mëdha, sanksiononin vetëqeverisjen e himarjotëve, mospagimin e taksave dhe të drejtën për të përdorur flamurin e tyre të lundrimit me anije. Ndër këto taksa, haraçi ishte kryesori dhe pagimi apo mospagimi i tij, përcaktonte në thelb raportin e një komuniteti me Portën e Lartë.

Pushtimi Osman është një histori kryengritjesh të himarjotëve, të cilët nuk kanë rreshtur së luftuari për lirinë e tyre, duke u ndeshur me perandorinë më të madhe të kohës, por edhe duke e parë Perëndimin, si faktorin dhe rrugën mbështetëse për të realizuar këtë aspiratë. Prandaj dhe ata ishin në kërkim të çdo faktori që mund t'i shërbente realizimit të kësaj kauze. Në këtë kontekst, në 12 korrik 1577, pleqtë e Himarës i dërguan një letër Papa Gregorit XIII, ku vënë në dukje faktin se krenohen me Skënderbeun dhe kërkojnë nga Evropa mbështetje për t'i furnizuar me armë për të luftuar kundër pushtuesit turk. Po ashtu, të njëjtin veprim kryen himarjotët edhe në vitin 1581, duke kërkuar sërish mbështetje prej Papës, për kryengritjen e radhës kundër turqve. Dhe, pas kësaj, nis ajo që në histori emërtohet misioni i murgjve bazilianë që u shtri në territorin e Himarës në një aktivitet që zgjati pothuajse dy shekuj, XVI-XVIII. “Në vitin 1577, me nismë të Papa Gregorit XIII, u themelua në Romë Kolegji Ortodoks i Shën Athanasit, një katalizator i propagandës papale për bashkimin e kishave ku, arbëreshët e Italisë luajtën një rol kryesues”. [26] (*Pëllumb Xhufi. Arbërit e Jonit. Fq.670*).

Ky akt mjaft i rëndësishëm dhe i paprecedent, shënon edhe pikënisjen e strukturimit dhe, më pas, fillimit të aktivitetit të këtij misioni në brigjet e Himarës. Gjatë kësaj periudhe, misionarët katolikë, kryesisht me origjinë shqiptare, u bënë të njohur për aktivitetin e tyre në promovimin e gjuhës shqipe, përmes kryerjes së ceremonive fetare në shqip, etj.

“Nga viti 1630 deri në 1730, në Rivierën e Jonit u shtri në kohë aksioni i Papatit që synonte kthimin në besnikërinë e tij të popullsisë ortodokse të Shqipërisë së Poshtme. Protagonistë ishin murgjit bazilianë të formuar në manastiret e ritit ortodoks

të Shën Nilit në Grottaferrata, Kolegjit të Mezzojusos në Siquili dhe në Kolegjin Ortodoks të Shën Athanasit në Romë, të krijuar nga Papa Gregori XIII në 1571. Studenti i parë i Kolegjit ishte, sipas Xhufit, një himarjot me emrin Andrea Vrana”. [27] (*Pëllumb Xhufi. Arbërit e Jonit. Fq.1340*)

Disa nga emrat më të njohur të këtij misioni, veçohen Neofit Rodino, Giuseppe Schiro, Nilo Katalano etj.

Sikundër përmendëm më lart, ajo që shënon një pikë kulmore në historinë e Himarës, lidhet me raportet e saj me Portën e Lartë, në atë që përbën autonominë e saj, e sanksionuar kjo në ato që njihen me emrin, Venomet e Himarës.

Ky realitet, ndoshta unik në të gjithë hapësirën e Perandorisë Osmane, është ruajtur në Himarë deri në periudhën e pas Luftës II Botërore. Privilegjet, ose autonomia e Himarës, e kanë pikënisjen në periudhën e luftës me Sulltan Bajazitin II, duke u sanksionuar në vitin 1492. Mes këtyre privilegjeve përfshihen, ruajtja e sistemit të pronës së vogël private mbi pasuritë e patundshme, si dhe ajo kolektive mbi kullotat, pyjet, burimet etj., çka do të thoshte mosshtrirja e sistemit të timareve në Himarë, vetadministrimi i krahinës përmes organeve tradicionale, si pleqësitë, import eksporti i produkteve pa taksa doganore (pra, Himara zonë e lirë), e drejta e lundrimit të lirë, pa kufizime me anijet e tyre në të gjitha portet e Perandorisë, pa ju nënshtruar procesit të kontrollit, e drejta e himarjotëve për t'u paraqitur përpara organeve zyrtare të armatosur.

Po ashtu, himarjotët gëzonin të drejtën për të caktuar përfaqësues të krahinës në Stamboll, duke komunikuar drejtpërdrejtë me Vezirin e Madh për çështje të rëndësishme të krahinës. Ata kishin detyrimin gjithashtu, të angazhoheshin në luftë, por duke patur të drejtën për t'u identifikuar me flamurin e tyre dhe të drejtuar nga kapedanët e tyre, ndërkohë që detyroheshin të paguanin haraçin, si taksa kryesore, si një shenjë e njohjes së autoritetit të Sulltanit.

Por, ishte pikërisht, mospagimi i rregullt i haraçit, që do të thoshte kundërshtim dhe mosnjohje e autoritetit të Sulltanit, shkaku që, herë pas here në këtë krahinë të nisnin kryengritje të armatosura, të cilat reflektojnë mospajtimin e banorëve të Himarës me Portën

e Lartë dhe mosnjohja e autoritetit të saj në këtë pjesë të bregdetit. Mes tyre veçohen ato në vitin 1537, 1554-1556, apo kryengritja tjetër e Himarë-Kurveleshit në 1565, kur refuzonin të paguanin haraçin dhe të dërgonin djemtë ushtarë.

Në fakt, sa kohë kështjella e Himarës ishte në këmbë, Himara mbetej vendi i papushtueshëm, që burimet historike përmendin vazhdimisht. Por, në kryengritjet e përsëritura që ndoqën ato të viteve 1480, muret e kështjellës së Himarës ishin dëmtuar rëndë dhe po ashtu edhe kisha peshkopale e Shën Sergjit e Bakut. Në letrat e tyre për Mëkëmbësin e perandorit Karli V në Napoli, më 1530, dhe për Papa Gregori XIII më 1577, himarjotët kërkuan ndihma në të holla dhe në specialistë muratorë pikërisht për meremetimin e mureve të rrëzuara të Himarës dhe të kishës peshkopale të djegur nga turqit. [28] *(I. Zamputi, Dokumente të shekullit XVI-XVII për Historinë e Shqipërisë, vëll.I. Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë: 1989. Fq.340. Pëllumb Xhufi. Arbërit e Jonit. Fq. 135).*

Megjithatë, pati momente kur, himarjotët për shkaqe dhe faktorë të ndryshëm, ndoqën një politikë pajtimi, ose njohjeje të përkohshme të autoritetit të Portës së Lartë. Dhe kjo duket në një ngjarje të vitit 1558, kur këtë krahinë e vizitoi sanxhakbeu i Delvinës dhe burrat e Himarës dhe fshatrave përreth, shkuan për ta përshëndetur, duke i çuar njëkohësisht edhe dhurata.

Apo në një tjetër moment në fund të shekullit XVII, në kushtet kur procesi i islamizimit të një pjese të mirë të fshatrave fqinjë të Arbëri-Labërisë, apo për faktorë të tjerë të pafavorshëm, të brendshëm dhe të jashtëm, himarjotët u detyruan të njihnin autoritetin e Portës së Lartë, duke paguar një haraç modest, që llogaritej në gjysmë reali për çdo shtëpi. [29] *(Nino Borgia. Murgjit bazilianë të Italisë në Shqipëri. Fq.264.)*

Por, pavarësisht kësaj, Himara, e gjithë treva e saj, për shkak të traditës dhe natyrës së banorëve, mbeti një zonë e lirë, ku, turqit nuk mund të ushtronin autoritetin e tyre dhe as mund të ishin prezentë. Kryengritjet e njëpasnjëshme të himarjotëve, krijuan një realitet të tillë, një hapësirë të lirë jashtë ndikimit të autoritetit të Perandorisë Osmane, me përjashtim të momenteve të caktuara, por edhe ato fragmentare, kur himarjotët kanë njohur indirekt

këtë autoritet.

Por, ai që do të vendoste një farë autoriteti të Portës mbi Himarën dhe gjithë trevën e saj, do të ishte, një himarjot, Ajaz Pashai, një ndër gjeneralët kryesorë të Sulltan Sulejmanit të Madhërisëm. Bajliu i Venedikut në Konstandinopojë në 1526, Pietro Bragadin, shkruante mes të tjerash se ai ishte me kombësi shqiptare, kishte lindur afër Himarës dhe në atë kohë ishte 44 vjeç. Në përcaktimin e tij, për Ajaz Pashën, përfaqësuesi venecian nënvizonte se, ai ishte një luftëtar i madh, ndonëse i pashkollë, që nuk dinte shkrim e këndim dhe madje nuk dinte as të fliste, ndërkohë që nëna e tij ishte murgeshë në një manastir pranë Vlorës, që mendohet se ishte Zvërneci.

Por edhe Ajaz Pasha, që mbërriti me ushtrinë e vet në Himarë, i mbështetur edhe nga Sanxhakbeu Sinan Pasha, mundi t'i shtronte himarjotët vetëm pasi u premtoi atyre t'i lironte nga taksa kryesore, haraçi, dhe t'u njihte një sërë privilegjesh kundrejt njohjes së sovranitetit të sulltanit dhe pagesës së taksës për kokë, si edhe të dhjetën e bagëtisë. [30] *Pëllumb Xhufi, Arbërit e Jonit, fq.138-139*

Por edhe kjo njohje pothuajse simbolike e sovranitetit të sulltanit, apo autoritetit të Portës së Lartë, ishte e përkohshme. Mjafton të kujtojmë se vetëm pak vite pas kësaj, turqit u përpoqën që përmes nxitjes së përçarjes së banorëve të kësaj zone më ata të Labërisë, t'i ngrinte këta të fundit në luftë kundër Himarës.

Kjo dokumentohet, me një letër që himarjotët i dërgonin në nëntor të vitit 1532 markezit të Atripaldës, me synimin për të siguruar prej Napolit, një ndihmë të posaçme për t'i rezistuar presionit të Portës së Lartë.

Dhe, kështu, Himara vjen deri sot nga rrugëtimi i saj ndër shekuj, si një model inspirimi. Ashtu si vargjet lapidar të Bajronit në veprën e tij, "Çajld Harold". *Të bijt' e Himarës, që s'falin as mikun/Si mundet ta lenë të gjallë armikun? /Si s'markan dot gjak me pushkat besnike, /Ka shenj' më të bukur se zemra armike?*

KAPITULLI III

Himara dhe Venecia, bashkëjetesë 4 shekullore

Historia e Himarës, në një pjesë të konsiderueshme të saj, është e lidhur me atë të Republikës së Venedikut. Këto dy realitete historike, kanë qenë bashkudhëtare për rreth 4 shekuj, në një rrugë plot sfida e të papritura, të ngërthyer nga faktorë të ndryshëm, rajonalë e më gjerë. *Pikënisja e kësaj “bashkëjetese” historike, nis prej vitit 1386, kur, venecianët u bënë faktikisht zotër të Korfuzit, ku qëndruan deri në 1797, kur, kjo republikë shënoi fundin e ekzistencës, pas ekspansionit të Napoleon Bonapartit në Itali dhe Traktatit të Kampio Formios.* Ka qenë një bashkëjetesë, apo një bashkëudhëtim i vështirë me parashikime dhe të papritura, me përfitime të dyanshme, ose edhe me kundërshti, rrjedhojë e interesave reciproke dhe e ndërthurjes së tyre me ato të faktorëve të tjerë.

Këto dy realitete, kanë qenë krah njëra - tjetrës në periudha të konsiderueshme, duke lënë gjurmë dhe duke përcjellë deri në ditët tona, prova të gjalla dhe të forta të bashkëpunimit, të ndikimit të ndërsjellët dhe të përfitimit. Por, krahas kësaj edhe të momenteve dhe periudhave kur, kjo bashkëjetesë, ka qenë përjashtuese, për shkak të pozicionimeve në kahe të ndryshme, sa herë që interesat ishin kundërshtuese. Për të kuptuar më qartë këtë marrëdhënie më shumë se katër shekullore, na vjen në ndihmë një përcaktim i historianit Pëllumb Xhufi. “Për të gjitha këto ngjarje, ky territor (bregdeti i Shqipërisë, veçanërisht ai i Shqipërisë së Poshtme-shën.im), ka shërbyer si një prapavijë, ku venecianët, të interesuar për të ruajtur korridorin në detin

Adriatik, donin të ngrinin vatra rezistence të popullsisë shqiptare, që t’i krijonin probleme Perandorisë Osmane, në mënyrë që ajo të mos e përdorte flotën e saj në frontin e Kretës, apo të Danubit, në Veri me austrohungarezët, por t’i mbante të gozhuara në këto territore”. [31] (*Pëllumb Xhufi. Gazeta Panorama. Tiranë. 31 maj 2017*).

Kjo frazë, si një sentencë kuptimplotë, përcjell katërçipërisht të vërtetën e madhe, mbi të cilën është ndërtuar filozofia dhe strategjia e marrëdhënieve mes Venedikut dhe Shqipërisë, pas invazionit turk në Ballkan, veçanërisht Shqipërisë së Poshtme, ku përfshihet Himara dhe bregdeti i saj strategjik. Përmes saj, kuptojmë dhe zbërthejmë ngjarje dhe periudha, qëndrime e kundërshti, pajtime dhe marrëveshje, mbështetje dhe braktisje.

Dhe këtë raport shumëshekullor, që shtyhet edhe më tej se fundshekulli XIV, pra viti 1386, duhet ta shohim në dy dimensione, në dy segmente; atë të marrëdhënieve mes këtyre dy realiteteve dhe të impaktit që ka lënë ky raport, në aspekte të ndryshme jetës, të përditshmërisë dhe më gjerë, në mentalitetin dhe stilin arkitekturor, në simbole dhe simbolika. Dhe, kur flasim për Venedikun, nuk duhet të limitohemi vetëm tek kjo republikë, sepse në raportin e ndërsjellët me të, duhet të përfshijmë edhe faktorë të tjerë, që, për arsye rivalitetesh, kanë qenë pjesë aktive e zhvillimeve në rajon dhe në bregdetin e Shqipërisë së Jugut, në Himarë. Dhe, këtu është fjala për Mbretërinë e Napolit, prania e të cilës në bregdetin shqiptar, ka qenë e spikatur. Mjafton të kujtojmë këtu marrëdhëniet e kësaj mbretërie me Skënderbeun dhe marrëveshjet e lidhura mes tyre, për të mos folur më pas për rivalitetin e saj me Venedikun në bregdetin e Jugut, në Himarë, deri në shumë shekuj më pas.

Prandaj dhe kur flasim për raportet e Himarës me Venedikun, këtë gjë mund ta realizojmë më mirë, sikurse thamë, nëse këtë raport do ta shohim pak më gjerë, duke përfshirë edhe faktorë të tjerë, në planin gjeografik, atë historik, kulturor, etj. Kështu, Himara dhe brigjet dalmate p.sh, kanë të përbashkëta një sërë elementesh, mes të cilëve detin, apo lidhjet me Italinë, d.m.th., Venedikun. Dhe, po ta shohim pak më ndryshe këtë moment, mund të themi se, një tipologji ndërlihdhëse e brigjeve dalmate me Himarën e ka

pikënisjen në raportet e hershme të bregdetit të Shqipërisë me Venedikun, fillimisht në antikitet dhe më pas në mesjetë, kur këto raporte për shkaqe që janë të njohura, kaluan në një nivel tjetër. E shohim këtë fakt, në disa drejtime, veçanërisht në stilin e shtëpive, që, Moikom Zeqo, i emërton dalmato-venedikase (është fjala për grupin e banesave brenda mureve të kështjellës së Himarës-shën.im), në disa aspekte të procesit të rikonstruksionit të kështjellave, si edhe në një fakt më konkret dhe më të dukshëm, që lidhet me praninë e relievit me Luanin e Shën Markut, që është edhe emblemë e njohur historike e Republikës së Venedikut.

Këtë fakt e përshkruan Moikom Zeqo, në një paragraf të plotë. Ai e vendos veten e vet në rolin e protagonistit, të një vizitori vëzhgues dhe eksplorues që përshkon të gjithë hapësirën e një modeli që limitohet në dimensione fizike, por jo në kohë.

“Asnjëherë nuk më ka mahnitur kalaja e Himarës sa këtë herë. Brenda rrethit të saj është një lagje ndërtesash prej guri, me dritare të mëdha, të stilit dalmato-venecian. Ndikimi i Venedikut këtu ka qenë shekullor. Deri në 1947, ka ekzistuar relievi me figurën e Luanit të Shën Markut, që, më pas e çuan në fondet e Muzeut Arkeologjik në Tiranë. ...Një lagje me shtëpi të tilla ndodhet në Ulqin, shtëpi të ngjashme ka në Budva, në Tivar, dy të tilla janë ende sot edhe në Durrës. Ky stil arkitekturor është një dëshmi e fortë...”. [32] (Moikom Zeqo. “Të vërteta të panjohura e të pathëna për Himarën”. Tiranë 5.05.2003).

Dëshminë për praninë e relievit me emblemën e Luanit të Shën Markut, e gjejmë edhe në një përshkrim të George P. Scriven, ushtarak i lartë amerikan dhe udhëtar, i cili në “Some highways of Albania and a forgotten Riviera”, shkruan mes të tjerash: “...Në Vuno, Luani i Shën Markut buzëqesh vrazhdë nga shkëmbinjtë...”. [34] (Scriven, George P. (Prill 1921). *Some highways of Albania and a forgotten Riviera. Geographical Review. American Geographical Society. 11 (2): 198–206. doi: 10.2307/207325. JSTOR 207325.*




Foto 14 – Foto e botimit original “Some highways of Albania and a forgotten Riviera” Geographical Review. American Geographical Society te (Scriven, George P. (Prill 1921).

Ky reliev, që u hoq në vitin 1947 dhe ndodhet në Muzeun Arkeologjik në Tiranë, është një dëshmi e fortë e këtij realiteti, ashtu siç janë banesat e sipërpërmendura, ashtu siç është i tillë edhe përshkrimi që i bën Scriven peizazhit natyror, urban dhe arkitekturor, gjatë udhëtimit të tij në këtë pjesë të bregdetit në vitin 1897, ndërkohë që kryente funksionet e të dërguarit të posaçëm dhe më pas të atashet ushtarak në Ambasadën e SHBA në Greqi.

Dhe është po ky autor, që, në shënimet e veta, të botuara në vitin 1921, e cilëson kështjellën e Porto Palermos, si një objekt venecian, ndoshta duke u nisur nga ky realitet që ai konstatoi në të gjithë këtë pjesë të bregdetit dhe në kontekstin e një sfondi, ku ndikimi venecian ishte një fakt i dukshëm qartësisht. Gjithsesi, ky argument, të cilin do e përmendim më pas, përbën edhe një provë të rëndësishme në zinxhirin e hallkave që evidentojnë konkluzionin e padiskutueshëm të ndikimit venecian në Bregdetin e Jugut.

Madje edhe shënimet e një komandanti venecian, si Domenico Mocenigo, që na sjell një përcaktim ndryshe për Himarën, në këndvështrimin e simbolikës së peizazhit natyror, përbëjnë një argument për raportin në fjalë. “...për komandantin venecian Domenico Mocenigo, më 1691, Himara ishte vargmali që zgjatej bregut të detit, i shënjuar nga fshatra të ndryshme, ku nuk kishte

“turq” (myslimanë)”. [33] (Pëllumb Xhufi. *Arbërit e Jonit. Fq. 135*)

Por, po ashtu janë mjaft të domethënëse edhe momente të tjera, kur raportet me Venedikun dhe rëndësia që kishte Himara për Republikën, pasqyrohen në dokumente e marrëveshje mes faktorëve të tjerë më shumë se rajonalë. Kështu, kur në fillim të shekullit XVII, u diskutua për një marrëveshje të mundshme mes himarjotëve dhe Perandorisë Osmane, për sistemin e fortifikimit të Himarës, gjë që u shfrytëzua prej turqve për të ndërtuar një bazë detare në Porto Palermo, një projekt që, nuk u realizua, për shkak se ndalohej nga një marrëveshje që Porta e Lartë kishte bërë më herët me Republikën e Venedikut.

Dhe, Porta e Lartë, i ka respektuar marrëveshjet me venecianët në të gjithë historinë e marrëdhënieve përkatese, pavarësisht interesave që ato kishin në rajon. Kështu edhe në rastin e Himarës. Kjo, sepse Himara konsiderohej një faktor tepër i rëndësishëm nga Venediku, veçanërisht në funksion të Korfuzit venecian, domethënë të Korfuzit që zotërohej nga Republika dhe ku furnizimet me produkte kryesore, siguroheshin nga Himara. Nga Himara vinin në Korfuz drithëra e produkte të tjera (dalla Cimera si trazeno formenti et altre biave per l'insula di Corfu). Si treg drithi, Himara duket se u hap fillimisht në 1624 për meritë të Bajliut të Korfuzit, Piero Marcello, i cili e pohon një gjë të tillë në një raport për Senatin. [34] *“Quella scalla della Cimera fu da me Bailo introdotta et apperta l'anno passato, ne prima veduta da altri” (ASV, Dispaçi, Corfu, b.14(1625-1626: raport i Bajliut Piero Marcello, Korfuz, 14 shkurt 1625.*

Por, nuk ishte vetëm kjo. Himara ishte dhe shërbente si një treg tranzit për Korfuzin, jo vetëm për drithëra por edhe për produkte të tjera ushqimore, të cilat vinin nga zona të njohura për produkte të tilla si, fusha e Beratit, ajo e derdhjes së poshtme të lumit Vjosë etj. Dhe, veç këtyre, bregdeti i Himarës mund të shërbente edhe si burim informacioni i natyrës strategjike për autoritetet veneciane të Korfuzit, në funksion të mbrojtjes së ishullit nga çdo sulm i papritur nga ana e turqve. Këto të vërteta fiksohen në dokumentet e kohës. *“Proveditori venecian i Korfuzit, Marco Michiel, vinte në dukje në vitin 1559, se anijet veneciane mund të ndaleshin në*

*Himarë për t'u furnizuar me ushqime dhe ujë. Nëpërmjet Himarës mund të dërgoheshin letra e mesazhe në brendësi të Shqipërisë, në Dalmaci e kudo qoftë. Dhe, në fund, përfundonte raportin e tij, Michiel, miqësia me himarjotët duhet mbajtur me çdo kusht, pavarësisht se me bëmat e tyre ata i dëmtonin shpeshherë interesat veneciane. Në fund të fundit, qeveritarët venecianë të Korfuzit, nëpërmjet Himarës mund të informoheshin për lëvizjet e turqve të Vlorës dhe të bregdetit të Shqipërisë. [35] (Pëllumb Xhufi. *Arbërit e Jonit, fq.137-138*)*

Por, për të hyrë në thelbin e interesave të Venedikut për bregdetin e jugut, ku përfshihej edhe Himara, duhet të shkojmë më në thellësi të historisë, qysh në momentin e pranisë së Serenisimas në këtë rajon, në bregdetin e Shqipërisë, me Durrësin, Lezhën, Vlorën.

Shtënia në dorë e Korfuzit, i cili qysh në kohën e Kryqëzatës IV kishte qenë objekt rivaliteti të ashpër mes Gjenovës dhe Venedikut, më 1258 ishte përvetësuar nga Manfred Hohenstaufen, si territor i Mbretërisë së Napolit (Sicilisë), përbënte një zhvillim të rëndësishëm dhe madje kolosal në funksion të interesave të Republikës. Ky fakt, reflekton ndryshimin e raportit të forcave në favor të Venedikut prej momentit kur ky lëshoi në det një flotë të re e të fuqishme. Dhe, në fakt, prej këtij momenti, gjithçka, çdo zhvillim në këtë rajon, kishte në thelbin e vet interesat e Republikës, e cila nuk u cënua edhe në shekujt vijues, pavarësisht faktit se, Perandoria Osmane përmes ekspansionit të saj, vuri nën sundimin e vet pjesën më të madhe të kësaj hapësire dhe më gjerë. Dorëzimi i Korfuzit u realizua në 9 qershor 1386 dhe në 8 janar 1387, bashkësia e komunitetit të Korfuzit, përmes përfaqësuesve të saj, nënshkroi edhe aktin e betimit. Por, Venediku nuk u mjaftua me kaq. Më tej u morën në zotërim edhe kështjella e Butrintit. Dhe, prej këtij momenti, gjithçka në rajon foli në emër dhe për Venedikun. Të gjithë faktorët lokalë dhe raportet e tyre me Venedikun, na vijnë përmes dëshmish të shumta dhe materialesh po ashtu të shumta historike. Pjesa më e madhe e zhvillimeve këtu lidhen me interesat e kësaj Republike, ashtu si edhe me marrëdhëniet dhe rivalitetin e saj me faktorë të tjerë më shumë se rajonalë, sikundër Perandoria Osmane, Mbretëria e Napolit etj. Prandaj dhe shfaqja e Perandorisë Osmane në këto brigje, në

brigjet e Shqipërisë dhe më poshtë, ishte edhe një kërcënim për rrugët dhe tregjet e saj, për vetë territoret që kishte në zotërim, apo që aspironte t'i kishte nën ndikimin e vet. Ishin ngjarje që do të thoshin se asgjë nuk do të ishte më si më parë dhe kërkoheshin domosdoshmërisht ekuilibra të rinj, me faktorë e aktorë të rinj në skenë. Perandoria Osmane, si forca më e madhe e kohës, nuk kishte zbarkuar në këtë rajon për t'u kthyer sërish pas, por, përkundrazi, për të qëndruar gjatë, çka u provua edhe me dekadat dhe shekujt që pasuan. Në këto kushte, Republika ndjeu kërcënimin dhe u përpoq të përshtatej me strategjinë përkatëse ndaj këtij realiteti të ri. Në fakt, në prag të shfaqjes së rrezikut otoman, Republika tentoi të zaptonte të gjitha qendrat bregdetare të cilat garantonin dhe siguronin rrugët detare të Mesdheut. Qysh nga viti 1080 kur nënshkroi traktatin e parë me Perandorin e Bizantit, Aleks I Komneni, venecianët pretenduan të ushtronin sovranitetin në atë që u emërtua "Gjiri i Venedikut" dhe që niste nga Istria në veri dhe shkonte deri në Kanalin e Otrantos në jug, në segmentin që bashkonte Kepin e Gjuhëzës në Karaburun, me Kepin Santa Maria di Leuca, në Kalabri. Në të gjithë këtë hapësirë detare nuk mund të lundronte askush, veç mjeteve lundruese veneciane. Prandaj dhe me konceptin e "Të drejtës ekskluzive mbi Adriatikut", venecianët i referoheshin traktatit të sipërpërmendur me Perandorin e Bizantit, si edhe aktit të ndarjes së Perandorisë Bizantine, që u nënshkrua nga fuqitë pjesëmarrëse në Kryqëzatën IV, në vitin 1204, sipas të cilës përfitonte një numër kolonish si edhe të drejta sovraane mbi rrugët detare të Adriatikut dhe Jonit. Këtë gjë, Republika e kishte arritur, por deri në momentin kur ekspansioni i Perandorisë Osmane u orientua drejt perëndimit dhe mbërriti në këtë rajon. Dhe, gjërat ndryshuan me shpejtësi përballë rrezikut otoman.

"Ndaj edhe pas pushtimit Osman të Vlorës (Në 1417-shënimi im.), venecianët u përpoqën të shpëtojnë, ç'mund të shpëtonin, nga zotërimet e tyre përgjatë vijës bregdetare veri-jug. Në mënyrë të veçantë, në segmentin jugor të saj, pas vendosjes së tyre në Korfuz, në vitin 1386, venecianët veçuan një brez të interesave të tyre të patjetërsueshme, që fillonte nga Porto Palermo (Himarë), e zgjatej deri në Frar (Fanari), poshtë Pargës. Për ruajtjen e

juridiksionit të vet, në këtë trakt të bregdetit jonian, Venediku pranoi, herë-herë, të hyjë në një konflikt të pabarabartë me Perandorinë Osmane, sikurse ndodhi në 1499, 1537 e 1571. Në jug të këtij trakti ndodhej Preveza, zotërim Osman prej vitit 1449, ndërsa më në veri ndodhej Vlora, zotërim i osmanëve prej vitit 1417". [36] (Pëllumb Xhufi. *Arbërit e Jonit. Fq.24-25*).

Por, Republika, sikurse del edhe nga ky paragraf, arriti të riekulibronte gjërat. Marrëdhëniet me Portën e Lartë, hynë në një kalvar zhvillimesh, kur, herë dominonte paqja e herë konflikti. Kjo ka qenë edhe tabloja e marrëdhënieve mes dy fuqive të kohës, në këtë rajon.

Përsa kohë mes Republikës dhe Portës së Lartë, mbretëroi paqja, venecianët shmangën çdo rast për konflikt me turqit përtej zonës së tyre të juridiksionit. Në fakt, kjo zonë u përcaktua përfundimisht në vitin 1479, me Traktatin e nënshkruar midis Portës së Lartë dhe Republikës. Kjo marrëveshje shënoi një kulm në aspektin formal në marrëdhëniet mes tyre, sepse në realitet, Venediku nuk hoqi dorë asnjëherë nga ideja për të zotëruar bastionet e bregdetit adriatiko-jonian. "Kështu, sa herë që Porta binte në vështirësi dhe nevoja e ruajtjes së paqes me të zhbëhej, Venediku nuk nguroi të tentonte ripushtimin, siç bëri në 1690, kur u përpoq të bëjë të pamundurën e t'u rrëmbejë turqve kështjellat e Vlorës, Kaninës e të Durrësit. Ky akt shënoi edhe sfidën më të rëndë që Republika e Venedikut i bëri Portës së Lartë në 200 vjet "të bashkekzistencës paqësore". (37) (37) (Pëllumb Xhufi. *Arbërit e Jonit*)

Kjo, sepse, nga skelat e të gjithë brezit të bregdetit, nga të gjitha pikat dhe portet e brezit që thamë më sipër, duhej të eksportoheshin drejt Korfuzit, por edhe drejt Venedikut, drithi dhe produktet e tjera, mishi e valanidhi, lënda drusore, por edhe rekrutët që ishin angazhuar në betejat në emër të Republikës. Sepse Republika kishte nevojë edhe për rekrutë, çka ishte një praktikë e kohës dhe Himara me banorët e vet me traditë luftarake, përbënte një mundësi të mirë, gjë që edhe u shfrytëzua prej Venedikut, ashtu sikundër edhe prej Napolit etj.

Siç thamë, prej vitit 1386, pasi Korfuzi ra nën zotërimin venecian, Republika pretendonte se trakti bregdetar mes Porto

Palermos dhe Fanarit me gjatësi rreth 80 milje dhe që emërtohej “bregu i Arbërorëve” (Riviera d’Albanesi), ishte historikisht nën juridiksionin e Korfuzit, që do të thotë, të vetë Republikës. [38] 28 gusht 1553, “*Riviera d’Albanesi ditto Paracalamo che è da Palermo fin al Fanaro, la qual rivierae de longezza de miglia ottanta in circa*”, Gerasimos D. Pagkrates, *Oi ektheseis ton veneton Ereunon bailon kai pronoiton tes Kerkyras (16 aionas), Ethniko, Idryma Ereunon, Institutou Byzantinon Ereunon, Athinë. 2008. Fq. 93.*

Por, ky brez bregdetar, me rëndësi të jashtëzakonshme strategjike, u shndërrua në një burim mosmarrëveshjesh e konfliktesh mes Portës së Lartë dhe Sinjorisë. Kështu që, pavarësisht pretendimeve veneciane, osmanët që ishin realisht zotërit e kësaj pjese të bregdetit, nuk kishte sesi të pajtoheshin. Kush zotëronte këtë brez, do të thoshte se kishte nën kontroll dy segmentet strategjike detare; Kanalin e Korfuzit dhe Kanalin e Otrantos.

Ishte kjo edhe një nga arsyet që, pushtimin e Vlorës prej turqve në vitin 1417, venecianët u përpoqën ta kompensojnë me ngritjen e një baze të tyre mbështetëse në ishullin e Sazanit, përmes të cilit synonin të kontrollonin dhe vëzhgonin lëvizjet e anijeve luftarake osmane të përqendruara në Vlorë, apo në Grykën e Vjosës. Kështu venecianët pretendonin juridiksionin e tyre mbi të gjithë krahun e Arbërisë që shtrihej prej ishullit të Sazanit e deri në Fanar. [39] *Pëllumb Xhufi, “Arbërit e Jonit”, fq.45*

Venecianët nuk mund të pajtoheshin me këtë realitet, por në vijimësi do të përpiqeshin herë pas here të rimerrnin bastionet e humbura, sikurse thamë. Dhe, në këto ndërmarrje, do të përpiqeshin të angazhonin faktorët lokalë, ku Himara ishte në një rol parësor. Janë disa shembuj nga historia që e dëshmojnë këtë fakt, që në vetvete shkojnë në funksion të argumenteve të bashkëpunimit të Venedikut me Himarjotët. Ishte, sigurisht, një bashkëpunim me interesa të ndërsjella, përmes të cilit, Venediku përpiqej të realizonte synimet e veta, ndërkohë që himarjotët nga ana tjetër, mendonin të largonin osmanët dhe të orientoheshin drejt Evropës.

Bashkëpunimi mes Republikës së Venedikut dhe Himariotëve u ngjiti edhe në nivelin ushtarak, duke u sjellë si palë ndërluftuese

dhe duke patur një kundërshtar të përbashkët; turqit osmanë. Ky fakt pasqyrohet gjerësisht në dokumentet e kohës, në mjaft raste. Ai pasqyrohet edhe në një ngjarje të vitit 1501, kur Kapiteni i Përgjithshëm i Detit, Benedetto di Ca de Pesaro, në një tentativë për të sulmuar dhe shkatërruar një flotë turke të ankoruar në grykëderdhjen e lumit Vjosë, arriti të përfshinte edhe himarjotët.

Angazhimi i himariotëve në këtë ngjarje, nisi me bisedimet paraprake për të marrë dakordësinë e tyre, në një takim që u zhvillua në Porto Palermo. Në 8 mars të vitit 1501, kapiteni i Flotës veneciane, shkoi në Porto Palermo për të marrë fjalën e himarjotëve, lidhur me sulmin e planifikuar kundër turqve në Vlorë dhe në Vjosë. Pas katër ditë bisedimesh në kuvertën e galerës (anije ushtarake-shënimi im) së kapitenit venecian “...u vendos që sulmi, si nga toka nga ana e shqiptarëve edhe nga deti, nga ana e venecianëve, do të shpërthehej njëkohësisht, në datën 13 mars pas dhënies së sinjalit, që do të ishte një e shtënë topi. Në fakt, në 13 mars, një flotë anijesh të lehta të komanduara nga kapiteni venecian Marco Orio, arriti të futej në grykën e Vjosës dhe të përshkruajë 14 milje në thellësi të lumit. [40] *(ASV, Consiglio de Dieci: Lettere Rettori, b.291, c.3: raport i Kapitenit të Detit, 14 shkurt, 1501. Pëllumb Xhufi. Arbërit e Jonit. Fq.303)*

Pavarësisht se si rrodhi fati i betejës që do të zhvillohej në brendësi të lumit Vjosë, ajo që është e rëndësishme në këtë rast, lidhet me faktin se, në këtë betejë me turqit osmanë, pjesë e përplasjeve të herëpashershme mes dy fuqive të mëdha të kohës, venecianët kërkuan mbështetjen e Himarjotëve, ashtu siç e kishin kërkuar atë më parë, apo siç e kërkuan edhe në vijimësi, sa herë që interesat e ndërsjellta përputheshin dhe himarjotët e shihnin Venedikun si mundësinë më të mirë për të larguar turqit nga territoret e tyre. Madje, prania dhe mbështetja e Venedikut në aspiratën perëndimore të himariotëve, duhet parë edhe si motiv nxitës në disa prej kryengritjeve të shumta të kësaj krahine, kundër Perandorisë Otomane. Në këtë këndvështrim duhen vlerësuar kryengritjet në vitet 1537, 1554-1556, apo kryengritja tjetër e Himarë-Kurveleshit në 1565, të cilat shpërthyen si reagim i banorëve që kundërshtonin pagesën e haraçit (taksa kryesore që paguanin himarjotët sa herë njihnin autoritetin e Portës së

Lartë në territoret e tyre-shën.im) dhe dërgimin e djemve ushtarë në shërbim të sulltanit. Dhe, ajo që ishte më e dukshme në këtë histori, është fakti se, **në kryengritjet e Himarë-Kurveleshit në 1566, luftëtarët shqiptarë, veç flamujve me simbolet e tyre, mbanin edhe flamurin venecian me simbolin e Luanit të Shën Markut.**

“Ky fakt, mund të jetë një provë të qartë se venecianët qëndronin në një farë mënyre, pas lëvizjeve në fjalë. Në fakt, lidhja me Venedikun dhe shkëputja nga pushteti Osman ishte një aspiratë e qartë e tyre dhe kur kishte nevojë, Republika e Shën Markut e shfrytëzoi atë për interesat e saj, siç ndodhi në ngjarjet dramatike të vitit 1571. [41] (*Pëllumb Xhufi. Arbërit e Jonit. Fq.643*)

Dhe, në të vërtetë, turqit herë pas here, veçanërisht pas kryengritjeve të mësipërme, akuzonin venecianët e Korfuzit si mbështetës, nxitës dhe burim për armatimin e kryengritësve shqiptarë, ashtu sikundër edhe strehues të tyre në ishull, sa herë paraqitej nevoja. Por, duke ju referuar asaj që thotë Xhufi më sipër, jo gjithmonë Venediku është vlerësuar si aleatja dhe mbështetësja e himarjotëve për të realizuar aspiratat e tyre kundër Portës së Lartë. Kështu, në vitin 1571, rreth 3000 kryengritës himarjotë, që luftuan përkrah venecianëve për të dëbuar turqit nga kështjella e Sopotit dhe Nivica, si edhe territore të tjera, u lanë të vetëm përballë turqve, për shkak se Venediku nënshkroi marrëveshjen për paqen e radhës me Portën e Lartë. Për këtë arsye, duke filluar nga gjysma e dytë e shekullit XVI në Himarë dhe më gjerë, nisi të përfshihej gjithmonë e më shumë kurora e Napolit, ose edhe “shtëpia mëmë e Spanjës”. Kujtojmë këtu, praninë e saj dhe angazhimin e kësaj kurore në mbështetje të Skënderbeut, në shekullit XV.

Në fakt edhe me kurorën e Napolit, marrëdhëniet dhe aleancat nuk ishin të qëndrueshme pa fund. Kujtojmë këtu, vitin 1567, kur popullsitë e Himarës dhe të Arbërit pritën një ndihmë dhe mbështetje konkrete të spanjollëve (d.m.th. të kurorës së Napolit), pas një premtimi paraprak, por që nuk mbërriti kurrë. Në këto kushte, ata u orientuan drejt një aleance të re me Venedikun, i cili kishte hyrë në konfliktin e radhës me perandorinë osmane. Kështu që, pas kësaj, himarjotët kërkuar aleanca të tjera, gjë që shprehet edhe në letrën që ata i dërguan Papa Grigorit XIII në 12

korrik të vitit 1577, në të cilën kërkuar ndihmë për rindërtimin e selisë peshkopale të Himarës, të djegur tre herë, si edhe armë për të vijuar qëndresën kundër turqve.

Por, rivaliteti mes venecianëve dhe kurorës së Napolit në Himarë, reflektohet edhe në rekrutimin e djemve nga kjo krahinë për nevoja të luftës. Venediku e shihte me shqetësim prezencën e kurorës në Himarë, ashtu sikurse nga ana tjetër edhe napolitanët silleshin me të njëjtin shqetësim. Repartet me “stratitotë” himarjotë në rradhët e ushtrisë napolitanë, ishin dëshmi e këtij rivaliteti. Përpjekjet për t’u rrëmbyer venecianëve ushtarë e kompani të tëra, rishfaqen me forcë kur në Napoli u krijua i famshmi Regjiment Mbretëror Maqedon me rekrutë shqiptarë. Madje, ushtarët shqiptarë të trupave veneciane gjithmonë e më pak aktive, u bënë në atë kohë objekt i joshjeve të napolitanëve.

Pati edhe emigrime masive për këtë qëllim, sikurse ishte emigrimi i himarjotëve, më saktë e një numri të madh familjesh nga Palasa në fund të shekullit XVI, që u vendosën në Otranto dhe në Napoli, ku djemtë u përfshinë në ushtrinë e Napolit. Në shek.XVI, spanjollët e Napolit kishin vazhdimisht reparte me ushtarë shqiptarë dhe njëlloj si edhe Venediku, ata zbatuan në shekullin XVI-XVII, një politikë të rregullt rekrutimesh të luftëtarëve himarjotë, që u përfshinë në fronte të ndryshme të luftës.

KAPITULLI IV

4.1 Himara dhe Venediku, bashkë kundër Portës së Lartë

Himara shfaqet në një dimension të trefishtë territorial. Në Defterin 1431/1432, Himara emërtohet si një qytet (nefs-i Himara) dhe kishte 117 shtëpi, gjë që e vinte atë në të njëjtin nivel me Gjirokastrën (121 shtëpi) e Krujën (125 shtëpi). Por, pavarësisht ndarjeve administrative osmane, burimet e identifikojnë shpeshherë Himarën me krejt krahinën e Labërisë (Arbërit). Kështu, për komandantin venecian Domenico Mocenigo, më 1691, Himara ishte vargmali që zgjatej bregut të detit i shënjuar nga fshatra të ndryshme, ku nuk kishte “turq” (myslimanë). Në vitin 1732 në Himarë kishin mbetur vetëm 15 fshatra të krishtera, që do të ishin kthyer edhe ato, po të mos ishte vepra e misioneve baziliane që i vuri fre procesit të islamizimit në fshatrat e Bregut. Në 1566, një raport, Juan Saetta, i dërguar i Mëkëmbësit të Napolit, e cilëson Himarën sërish si qytet. Si qytet e përmend edhe mitropoliti i Durrësit, Simon Laskari, më 1661. [42] (Pëllumb Xhufi. *Arbërit e Jonit. Fq. 135.*) (Pëllumb Xhufi. *Arbërit e Jonit. Fq. 134. 135*)

Himara dëshmohej si peshkopatë qysh në vitin 1020, fillimisht nën varësinë e selisë mitropolitane të Ohrit e më tej të Paupaktit e, duke filluar nga gjysma e dytë e shekullit XV, si sufragane e Janinës. Vetë kështjella e Himarës identifikohet ndonjëherë me kishën peshkopale të Shën Sergjit e Bakut. [43] (A. Meksi. “Disa kapela bizantine të vendit tonë”, në *Monumentet. 10. 1975, fq. 79-80.*)

Në kryengritjet e përsëritura që ndoqën ato të viteve 1480, muret e kështjellës së Himarës ishin dëmtuar rëndë dhe, po ashtu edhe

kisha peshkopale e Shën Sergjit e Bakut. Në letrat e tyre për Mëkëmbësin e perandorit Karli V në Napoli, më 1530, dhe për Papa Gregori XIII më 1577, himarjotët kërkuan ndihma në të holla dhe në specialistë muratorë pikërisht për meremetimin e mureve të rrëzuara të Himarës dhe të kishës peshkopale të djegur nga turqit. [44] (I. Zamputi, *Dokumente të shekullit XVI-XVII për Historinë e Shqipërisë, vëll. I. Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë: 1989. Fq.340.*)

Një tjetër moment i vështirë për himarjotët, është ai i fillimit të shekullit XVII dhe që lidhet edhe me fortesën e Porto Palermos. Në vitin 1602, përfaqësues të Himarës dhe Vunoit, shkuan tek Kedir Pasha, sanxhakbeu i Delvinës, ku i kërkuan mbështetje për të fortifikuar këto fshatra, duke ofruar si garanci besnikërie 70 djem, respektivisht 40 dhe 30 për secilin. Sanxhakbeu pranoi menjëherë propozimin, duke premtuar se do të dërgonte njerëz dhe material për të filluar punën, por, jo sipas asaj çka kërkonin himarjotët. Përkundër asaj çka kërkuan ata, në shenjë njohjeje të autoritetit të Portës së Lartë, ai propozoi të mos rindërtonte kështjellën mbi kodër, **por të rindërtonte nga e para një fortesë në Porto Palermo**, si një mundësi për të mbajtur nën kontroll himarjotët, në rast se ata do të ngriheshin kundër perandorisë, sikundër kishte ndodhur shumë herë të tjera.

**sappiamo, che li Chimarioti sono andati dal sanzacho figliolo del Peribei li quali gli havevano promeso cento figlioli per fabricarli Cimara et li dissero venghi a fabricarne la fortezza, et lui li rispose dicendoli: Io ho mandato a Constantinopoli, affin che mi venghi commissione per fabricarlo, et il signor Bailo de Constantinopoli ha impendito et non lascia, chel façi ma se volete chel fabbrichi, dattemi doi mille cechini per mandarli in donativo al Bassa, che forsi ne dara licentia di farlo et il negotio rimase cosi.*

(ne e dimë se çimarioti shkoi te sanzaço djali i Peribeit, i cili i premtoi njëqind fëmijë për të ndërtuar Cimarën dhe u tha të vinin të ndërtonin kështjellën, dhe ai u përgjigj atyre duke thënë: Unë kam dërguar në Kostandinopojë, që të bëhet një komision. më dërgoi për të ndërtuar kështjellën. , dhe Signor Bailo de

Constantinopoli është ndalur dhe nuk do ta lërë ta bëjë atë, por nëse doni që ai të ndërtojë, më jepni një mijë çekë që t'i dërgoj si donacion për Bassa-n, i cili mund të ketë iu dha leja për ta bërë këtë dhe negociatat mbetën të tilla).

Pëllumb Xhufi: Arbërit e Jonit Fq,141 p.I. ASV Dispaçi Corfu, b.4(1602-1608), dëshmi e Kristofor Pecalit nga Dhërmiu, Korfuz 14 korrik, 1603.

***et di più il detto Chidir Bey ha preso informata da dui veçhiardi di Porto Panormo dove egli h disegnato fortificata che havera la Cimara; far anco un forte in detto porto per dar ricetta a fuste et galeotte*

dhe për më tepër Chidir Beu i përmendur u informua nga dy pleq të Porto Panormos ku ai ka projektuar një fortifikim që ka Cimara; për të ndërtuar një fortesë në portin e përmendur për t'i dhënë strehë fuste et galeotte

fq 140 Pëllumb Xhufi: Arbërit e Jonit Fq,140 p.I. ASV Dispaçi Corfu, b.4(1602-1608), dëshmi e Kristofor Bixhilit nga Dhërmiu, Korfuz 2 nentor 1602

Pra, duke shfrytëzuar këtë rrethanë të krijuar, turqit menduan të ndërtojnë një bazë detare aty ku, në të vërtetë, nuk mund të bëhej kjo gjë, për shkak se ndalohej nga një marrëveshje që Porta e Lartë kishte bërë me Republikën e Venedikut. Dhe, në të vërtetë, kështu ndodhi. Pak kohë më vonë, sanxhakbeu i Delvinës, njoftoi se leja nga qendra nuk erdhi për shkak të ndërhyrjes së Bajliut të Venedikut në Konstandinopojë. “Siç duket, Venecianët e kishin kuptuar që turqit donin të shfrytëzonin kërkesën e himarjotëve për të ndërtuar një kështjellë për mbrojtjen e vendit, duke vendosur të ndërtojnë, sigurisht për veten e tyre, bazën dhe fortesën e Porto Palermos. ***

Në fund të shekullit XVII, në kushtet kur ishte realizuar procesi i islamizimit të një pjese të mirë të fshatrave fqinjë të Arbëri-Labërisë, si edhe pranisë së faktorëve të tjerë të pafavorshëm, të brendshëm dhe të jashtëm, himarjotët u detyruan të njihnin autoritetin e Portës së Lartë, duke paguar një haraç modest, që llogaritej në gjysmë reali për çdo shtëpi. [45] (*Nino Borgia. Murgjit bazilianë të Italisë në Shqipëri. Fq.264.*)

Himara konsiderohej një faktor tepër i rëndësishëm nga Venediku, sidomos në funksion të Korfuzit venecian. Nga Himara vinin në Korfuz, drithëra e produkte të tjera (dalla Cimera si trazeno formenti et altre biave per l'insula di Corfu). Si treg drithi, Himara duket se u hap fillimisht në 1624 për meritë të Bajliut të Korfuzit, Piero Marcello, i cili e pohon një gjë të tillë në një raport për Senatin. Duhet të mendojmë se në rastin e Himarës, kemi të bëjmë me një treg tranzit, i hapur në një vend të përshtatshëm të bregdetit, gjasash tek “Rrugët e Bardha”, ku drithi e produktet e tjera ushqimore vinin nga vise të dëgjua për produkte të tilla, siç ishte fusha e Beratit dhe ajo e derdhjes së poshtme të Vjosës. Proveditori venecian i Korfuzit, Marco Michiel, vinte në dukje në vitin 1559, se anijet veneciane mund të ndaleshin në Himarë për t'u furnizuar me ushqime dhe ujë. Njëpërmjet Himarës mund të dërgoheshin letra e mesazhe në brendësi të Shqipërisë, në Dalmaci e kudo qoftë. Dhe, në fund, përfundonte raportin e tij, Michiel, miqësia me himarjotët duhet mbajtur me çdo kusht, pavarësisht se me bëmat e tyre ata i dëmtonin shpeshherë interesat veneciane. Në fund të fundit, qeveritarët venecianë të Korfuzit, njëpërmjet Himarës mund të informoheshin për lëvizjet e turqve të Vlorës dhe të bregdetit të Shqipërisë. Rreth vitit 1470, Himara kaloi nën autoritetin e Portës së Lartë dhe siç shkruan kronisti, Stefano Magno, atë vit bajliu i Korfuzit, Lorenzo da Leçe, ia dorëzoi Himarën të dërguarve të Sulltan Mehmetit II. [46] *Pëllumb Xhufi. Arbërit e Jonit, fq.137-138*

Por, pavarësisht kësaj, Himara, e gjithë treva e saj, për shkak të traditës dhe natyrës së banorëve të, mbeti një zonë e lirë, ku, turqit nuk mund të ushtronin autoritetin e tyre dhe as mund të ishin prezentë. Kryengritjet e njëpasnjëshme të himarjotëve, krijuan një realitet të tillë, një hapësirë të lirë jashtë ndikimit të autoritetit të Perandorisë Osmane, me përjashtim të momenteve të caktuara, por edhe ato fragmentare, kur himarjotët kanë njohur indirekt këtë autoritet.

Por, ai që do të vendoste një farë autoriteti të Portës mbi Himarën dhe gjithë trevën e saj, do të ishte, një himarjot, Ajaz Pashai, një ndër gjeneralët kryesorë të Sulltan Sulejmanit të Madhërisë, i cili, siç shkruante në vitin 1526 bajliu i Venedikut në Konstandinopojë,

Pietro Bragadin, ishte ke kombësi shqiptare, lindur afër Himarës dhe në atë kohë ishte 44 vjeç. Në përcaktimin e tij, për Ajaz Pashën, përfaqësuesi venecian theksonte se, ai ishte një luftëtar i madh, ndonëse i pashkollë, që nuk dinte shkrim e këndim dhe madje nuk dinte as të fliste, ndërkohë që nëna e tij ishte murgeshë në një manastir pranë Vlorës, ndoshta në Zvërnec. Por edhe Ajaz Pasha, që mbërriti me ushtrinë e vet në Himarë, i mbështetur edhe nga Sanxhakbeu, Sinan Pasha, mundi t'i shtronte himarjotët vetëm pasi u premtoi atyre t'i lironte nga taksa kryesore, haraçi, dhe t'u njihje një sërë privilegjesh kundrejt njohjes së sovranitetit të sulltanit dhe pagesës së taksës për kokë, si edhe të dhjetën e bagëtisë. [47] *Pëllumb Xhufi, Arbërit e Jonit, fq.138-139*

Por edhe kjo njohje pothuajse simbolike e sovranitetit të sulltanit, apo autoritetit të Portës së Lartë, ishte e përkohshme. Mjafton të kujtojmë se vetëm pak vite pas kësaj, turqit u përpoqën që, përmes nxitjes së përçarjes së banorëve të kësaj zone me ata të Labërisë, t'i ngrinte këta të fundit në luftë kundër Himarës. Kjo dokumentohet, me një letër që himarjotët i dërgonin në nëntor të vitit 1532 markezit të Atripaldës, me synimin për të siguruar prej Napolit, një ndihmë të posaçme për t'i rezistuar presionit të Portës së Lartë.

Prandaj dhe pas pushtimit të Vlorës prej osmanëve, Republika e përshtati politikën e vet me filozofinë e pragmatizmit, me idenë për të shpëtuar çfarë mund të shpëtohej. Në këtë kuadër, pas pushtimit të Korfuzit në vitin 1386, venecianët veçuan një brez të interesave të tyre thelbësore, që niste nga Porto Palermo dhe vazhdonte deri në Frar, poshtë Pargës. Në funksion të kësaj dhe për të ruajtur të paprekur juridiksionin në këtë brez, Republika dërgoi herë ra në konflikt me Perandorinë Otomane, ndonëse në kushte jo të barabarta, çka spikat veçanërisht në 1499, 1537 dhe 1571.

Kjo shpjegon edhe faktin që, për sa kohë mes Republikës dhe Portës së Lartë, mbretëroi paqja, venecianët shmangën çdo rast për konflikt me turqit përtej zonës së tyre të juridiksionit, të përcaktuar përfundimisht me Traktatin e nënshkruar në 1479, midis Portës së Lartë dhe Republikës. Por, kjo nuk do të thotë se, Venediku hoqi dorë nga ambicia për të zotëruar të gjitha

bastionet e bregdetit adriatiko-jonian. Sa herë që Porta e Lartë binte në vështirësi dhe nevoja e ruajtjes së paqes me të zhbëhej, Venediku tentonte ripushtimin, siç bëri në 1690, kur u përpoq t'u rrëmbente turqve kështjellat e Vlorës, Kaninës e Durrësit. Ky akt shënoi edhe sfidën më të rëndë që Republika e Venedikut i bëri Portës së Lartë në 200 vjet "të bashkekzistencës paqësore". Nga skelat e këtij brezi bregdetar, drejt Korfuzit e Venedikut, duhej të vërshonin drithi, mishi, valanidhi, si dhe rekrutët ushtarakë që luftonin për Sinjorinë në Dalmaci, Itali, Peloponez, Qipro, apo Kretë.

Nga ana tjetër, nga kjo zonë, në Korfuz mbërrinin edhe informacione për lëvizjet e anijeve dhe trupave, për lëvizjet kryengritëse, infiltrimet e të huajve. Republika kishte ngritur një sistem informatorësh rastësorë, apo me agjentë të paguar, që e furnizonin atë dhe Korfuzin me të dhëna të ndryshme që u paraprinin qëndrimeve në raport me Portën e Lartë etj.

Prej vitit 1386, kur Korfuzi ra nën diktatin venecian, Republika pretendonte se trakti bregdetar mes Porto Palermos dhe Fanarit, rreth 80 milje i gjatë, ishte historikisht nën juridiksionin e Korfuzit, pra, të Republikës së Venedikut. Gjeografikisht dhe etnikisht, ky trakt, quhej prej venecianëve, "bregu i Arbërorëve", (Riviera d'Albanesi), [48] *28 gusht 1553, "Riviera d'Albanesi ditte Paracalamo che e da Palormo fin al Fanaro, la qual rivierae de longezza de miglia ottanta in circa", Gerasimos D. Pagkrates, Oi ektheseis ton veneton Ereunon bailon kai pronoiton tes Kerkyras (16 aionas), Ethniko, Idryma Ereunon, Institouto Byzantinon Ereunon, Athinë. 2008. Fq. 93.*

Por edhe në këndvështrimin politik, venecianët e konsideronin atë, zotërimin e tyre. Kjo gjë, u krijoi problem me perandorinë osmane, që në të vërtetë ishin realisht zotëruarit e saj prej gjysmës së parë të shekullit XV. Ky brez konsiderohej me rëndësi të jashtëzakonshme për rrugët e lundrimit përgjatë Adriatikut lindor dhe për kontrollin e dy segmenteve strategjike të këtyre rrugëve; Kanalin e Korfuzit dhe Kanalin e Otrantos.

Nën një arsyetim të tillë, shpjegohen edhe të gjitha lëvizjet që bënin venecianët në këtë rajon, në funksion të interesave të tyre. Kështu, pushtimin e Vlorës prej turqve në vitin 1417,

ata u përpoqën ta kompensonin, duke ngritur një bazë të tyre mbështetëse në ishullin e Sazanit, përmes të cilit kontrollonin dhe vëzhgonin lëvizjet e anijeve luftarake osmane të përqendruara në Vlorë, apo në Grykën e Vjosës. “Kështu venecianët pretendonin juridiksionin e tyre mbi të gjithë krahun e Arbërisë që shtrihet prej ishullit të Sazanit e deri në Fanar”. [49] **Pëllumb Xhufi, “Arbërit e Jonit”, fq.45**

Kjo na jep mundësinë të shpjegojmë edhe “zigzagun”, e marrëdhënive mes Republikës dhe Himarës e himarjotëve, të cilat, pavarësisht gjithçkaje, kanë qenë të vazhdueshme, me ulje ngritjet përkatëse, sipas periudhave dhe interesave. Bashkëpunimi mes Republikës së Venedikut dhe Himarjotëve, pasqyrohet edhe në një ngjarje të vitit 1501, kur Kapiteni i Përgjithshëm i Detit, Benedetto di Ca de Pesaro, shfaqet në një tentativë për të sulmuar dhe shkatërruar një flotë turke të ankoruar në grykëderdhjen e lumit Vjosë. Këtu, del sërisht emri i Porto Palermos, si një vend ku zhvilloheshin takime të rëndësishme. “Në 8 mars, Kapiteni i Flotës erdhi në Porto Palermo, për të marrë besën e himarjotëve, lidhur me sulmin e tyre kundër turqve, në Vjosë e në Vlorë. Për 4 ditë me radhë, në Porto Palermo, në kuvertën e galerës së Kapitenit, erdhën me radhë pleqtë e fshatrave, për të dhënë besën si më sipër. Kapiteni urdhëroi që, gjithë miqve t’u shtrohej tryeza për të ngrënë, por kur konstatoi se, këta hanin pak dhe pinin shumë, urdhëroi t’u jepej verë me bollëk. U vendos që, sulmi, si nga toka nga ana e shqiptarëve edhe nga deti, nga ana e venecianëve, do të shpërthehej njëkohësisht, në datën 13 mars pas dhënies së sinjalit, që do të ishte një e shtënë topi. Në fakt, në 13 mars, një flotë anijesh të lehta të komanduara nga kapiteni venecian, Marco Orio, arriti të futej në grykën e Vjosës dhe të përshkruajë 14 milje në thellësi të lumit. (50) **(Pëllumb Xhufi. Arbërit e Jonit. Fq.303)**

Pavarësisht se si rrodhi fati i betejës që do të zhvillohej në brendësi të lumit Vjosë, ajo që është e rëndësishme lidhet me faktin se, në këtë betejë me turqit osmanë, pjesë e përplasjeve të herëpashershme mes dy fuqive të mëdha të kohës, venecianët kërkuan mbështetjen e Himarjotëve, takimin me të cilët e zhvilluan në Porto Palermo, që është porti i vetëm ku mund të ankorohen

mjete lundruese ushtarake të mëdha për kohën, siç ishin galerat. Kujtojmë këtu se, nga përshkrimet që i janë bërë këtij gjiri dhe porti detar, është përcaktuar se, mund të ankoroheshin dhe të strehoheshin deri në 30 galera.

Ky realitet dhe këto zhvillime të shekullit XVI, e kanë burimin në ngjarje me rëndësi që i kanë paraprirë shekujve. Mes tyre, spikat marrja në zotërim e Korfuzit prej Republikës. Është ngjarja më e rëndësishme në kohën kur ndodhi dhe përcaktuese për zhvillimet që pasuan rajonin në dekadat dhe shekujt vijues. Viti 1386, shënohet si një moment kthese në historinë e Shqipërisë së Poshtme dhe të ishujve të Jonit. Kjo, sepse në 28 maj të atij viti, pas një periudhe më shumë se një vjeçare përpjekjesh dhe intrigash, marrëveshjesh e bisedimesh, Republika e Venedikut arriti të merrte në zotërim Korfuzin. “Pretendimet e Venedikut mbi ishujt e Jonit dhe skelave kryesore të steresë epiro-shqiptare, datonin qysh nga koha e Kryqëzatës IV (1204), kur i famshmi traktat mbi ndarjen e territoreve bizantine, i nënshkruar nga fuqitë pjesëmarrëse në Kryqëzatë, ia atribuonte Republikës ato territore”. (51) **(Pëllumb Xhufi. Arbërit e Jonit. Fq.315)**

Por, shtënia në dorë e Korfuzit, i cili qysh në kohën e Kryqëzatës IV kishte qenë objekt rivaliteti të ashpër mes Gjenovës dhe Venedikut, më 1258 ishte përvetësuar nga Manfred Hohenstaufen, si territor i Mbretërisë së Napolit (Sicilisë), përbënte një zhvillim të rëndësishëm dhe madje kolosal në funksion të interesave të Republikës. Ky fakt, reflekton ndryshimin e raportit të forcave në favor të Venedikut, prej momentit kur ky lëshoi në det një flotë të re e të fuqishme. Dhe, në fakt, prej këtij momenti, gjithçka, çdo zhvillim në këtë rajon, kishte në thelbin e vet interesat e Republikës, e cila nuk u cënoa edhe në shekujt vijues, pavarësisht faktit se, Perandoria Osmane përmes ekspansionit të saj, vuri nën sundimin e vet pjesën më të madhe të kësaj hapësire dhe më gjerë. Dorëzimi i Korfuzit u realizua në 9 qershor 1386 dhe në 8 janar 1387, bashkësia e komunitetit të Korfuzit, përmes përfaqësuesve të saj, nënshkroi edhe aktin e betimit. Por, Venediku nuk u mjaftua me kaq. Më tej, u mor në zotërim edhe kështjella e Butrintit. Dhe, prej këtij momenti, gjithçka në rajon foli në emër dhe për Venedikun. Të gjithë faktorët lokalë dhe raportet e tyre me

Venedikun, na vijonë përmes dëshmish të shumta dhe materialesh po ashtu të shumta historike. Pjesa më e madhe e zhvillimeve këtu lidhen me interesat e kësaj Republike, ashtu si edhe me marrëdhëniet dhe rivalitetin e saj me faktorë të tjerë më shumë se rajonalë, sikundër Perandoria Osmane, Mbretëria e Napolit etj. Për të kuptuar dimensionet e këtij rivaliteti, mjafton të sjellim një përcaktim të Luigi Ugolinit, arkeologut të njohur italian.



Foto: Në Butrint, shekulli XV

“Kur në shekullin XV shtrinë sundimin e tyre në Shqipërinë Jugore, turqit nuk e shihnin me sy të mirë faktin që, rivalja e tyre e madhe, Venediku, të mbante Butrintin kaq të rëndësishëm e të përfitonte nga të ardhurat e peshkatoreve që shtoheshin përherë e më shumë nga organizimi e metodat e mira të shfrytëzimit.” (52) (Luigi M. Ugolini, “Butrinti, miti i Eneas”)

Prandaj dhe, nëse nxjerrim dhe evidentojmë rëndësinë që ka patur Porto Palermo në periudhën që po flasim, atë e lidhim me ngjarje dhe detaje të ndryshme që lidhen me venecianët. Mjafton të përmendim faktin se, gjithë kjo pjesë e bregdetit të Shqipërisë së Poshtme, pjesa e steresë, u shndërruan në burim potencial për

furnizimin e Korfuzit, ose edhe të vetë Venedikut, me produkte të ndryshme, drithë, vaj, verë, valanidh, për të perceptuar rëndësinë që kishte ajo për vetë Republikën. Ashtu si në të gjithë bregdetin shqiptar, në Durrës, Shkodër, Lezhë, Vlorë etj., edhe në Himarë, Venediku kishte interesa mjaft të forta që dalin dhe shfaqen në të gjithë historinë e prezencës së saj këtu, deri në 1797, që shënoi edhe fundin e Republikës, pas marrëveshjes së Kampo Formios dhe triumfit të Napoleon Bonapartit. Ishte një histori më shumë se 4 shekujloze, që ka lënë gjurmët e veta, të cilat edhe sot janë ende të dukshme.

“Në fakt, Riviera shqiptare, me skelat e saj, ishte historikisht baza e furnizimit të ishullit të Korfuzit, me produkte ushqimore, sidomos me drithë dhe mbeti si e tillë edhe pas kalimit të Korfuzit në duart e venecianëve dhe për gjithë vitet dhe shekujt që ishulli qëndroi nën sovranitetin e Republikës. Rreth 150 vjet më vonë, aty nga viti 1580, në “Librin E Artë”, të bashkisë së Korfuzit, evidentohet me të njëjtën forcë, sikundër edhe në kërkesën e vitit 1440, nevoja ekzistenciale për të ruajtur juridiksionin e ishullit mbi tregjet e drithit, nga Porto Palermo deri në Frar (Fonar).

(53) (Pëllumb Xhufi. Arbërit e Jonit. Fq.537).

Ndërprerja e furnizimeve nga toka, që do të thotë nga bregdeti në fjalë, për arsye të ndryshme, mund të shoqërohet me një zinxhir ngjarjesh dhe deri me zinë e bukës në ishull. Ngjarje të tilla nuk ishin të rralla dhe as të pakta. Mes tyre përmendet zija e bukës e vitit 1559. Ajo ishte rrjedhojë e nismës që ndërmorën turqit për të ndërtuar fortesat e Margëlliçit dhe të Sopotit (Borsh), çka kishte çuar në forcimin e kontrollit të territorit prej tyre dhe, për pasojë edhe në bllokimin e marrëdhënieve me Korfuzin e sunduar nga Venediku, duke bërë që edhe eksporti i drithit drejt ishullit të ndërpritej.

Dhe këtu shfaqet edhe një here, rëndësia që kishte Porto Palermo në këtë drejtim. Kjo peshë e Porto Palermos, në procesin e eksportit të drithërave drejt ishullit, ishte përvijuar prej viteve të para të sundimit venecian në Korfuz. Prandaj dhe qysh në vitin 1440, ishte kërkuar dhe tentuar që, drithërat e prodhuara në Shqipërinë e Poshtme, të eksportoreshin vetëm në ishull. “Në 1440, banorët e Korfuzit i deklarorin Senatit se, për shkak të tokave të varfra e

jo pjellore, ishulli nuk mund të siguronte bukën e vitit dhe nëse ai nuk ishte braktisur nga popullsia, kjo i dedikohej importeve të drithit që vinin në Korfuz nga skelat e steresë, nga Porto Palermo deri në Fanar” **(54) (Pëllumb Xhufi. Arbërit e Jonit. Fq.539).**

Prandaj dhe ata kërkonin që, drithërat e kësaj zone të eksportoheshin vetëm drejt Korfuzit dhe jo destinacioneve të tjera, sepse vetëm kështu do të sigurohej ekzistenca e ishullit. Dhe, madje kërkesat e banorëve të këtij ishulli, arritën deri atje sa të përjashtonin nga drejta e importit edhe vetë Republikën e Venedikut, ashtu sikundër këmbëngulën për aplikimin e gjobave të rënda deri në 100 dukatë, për të gjitha rastet që do të konstatoheshin. Nëse edhe pas kësaj, do të kishte tregtarë që do të dërgonin drithin në destinacione të tjera, ata së pari duhej të paraqiteshin në Korfuz, për t’u pajisur me leje të posaçme dhe të dorëzonin 15 për qind të ngarkesës, e cila do të blihej nga autoritetet për nevojat e popullsisë, me çmimin e origjinës. Ky shembull, tregon qartësisht se sa e fortë dhe e rëndësishme ishte beteja dhe konkurrenca në tregun e drithit, që shkonte deri atje sa t’i propozoheshin Republikës masa që, vërtetë mund të çonin në rritjen e të ardhurave përmes tarifave doganore, por, ato binin ndesh me parimet dhe filozofinë që kishte krijuar dhe e bazonte kjo Republikë, ekzistencën e vet. Prandaj dhe Senati e hodhi poshtë kërkesën e banorëve të Korfuzit, me arsyetimin se, “...Venediku nuk mund të shkelte aq hapur mbi një parim të predikuar nga ai vetë, atë të tregtisë së lirë dhe të tregjeve të hapura, mbi bazën e të cilit kishte ndërtuar perandorinë e vet tregtare”. **(55) (Po aty. Fq.541)**

Një filozofi e tillë, që bazonte ekzistencën e një shteti, të një republike, në kolonat dhe parimet e tregut të lirë, përbën një margaritar në mënyrën e strukturimit dhe funksionimit të një vendi, në shekullin XV, aq më tepër kjo Republika e Venedikut, apo Republika e Shën Markut, apo Sinjoria, apo Serenisima, fuqia më e madhe detare e kohës, ose ndër më të mëdhatë. Potencia e saj, reflektohet edhe tek fakti se, Perandoria Osmane, në pjesën më të madhe, preferoi të ndërtonte një lloj bashkëjetese me këtë republikë, çka reflektohet në marrëveshjet e nënshkruara mes tyre, sikundër është ajo e vitit 1573 dhe veçanërisht ajo e vitit 1479, që e kemi përmendur më lart, ku përcaktohej, mes të tjerash,

përfundimisht juridiksioni i Republikës përgjatë vijës bregdetare. Ishte kjo marrëveshje, që pasoi zhvillimet e mëdha që ndodhën në fund të shekullit XIV, kur, venecianët morën në zotërim ishullin e Korfuzit etj., me zhvillimet në vitin 1386 dhe që u konfirmuan në 8 janar të vitit pasardhës, kur komuniteti i banorëve korfiotë njohu autoritetin e kësaj republike. Kështu që, vërtetë thuhet që, Senati nuk e pranoi kërkesën e komunitetit të banorëve të këtij ishulli, për të mos lejuar eksportin e drithit prej bregdetit nga Porto Palermo deri në Fanar, në destinacione të tjera, por, nga ana tjetër, njohu si të ligjshëm faktin që, çdo tregtar drithi duhet të shiste 15 për qind të mallit për nevojat e banorëve të ishullit, me çmimin e blerjes. Në këtë mënyrë, drithi shqiptar, ose më saktë i Shqipërisë së Poshtme, vlerësohej si një mall shumë i rëndësishëm për nevojat e Korfuzit, por jo vetëm. Drithi që vinte nga Shqipëria ishte jetik gjatë luftërave në të cilat u përfshi Republika, në shekujt XVI-XVII. Madje, ishte një nga detyrat e Proveditorit të Korfuzit, sigurimi i drithërave prej Shqipërisë. Lidhur me këtë realitet, në librin “Arbërit e Jonit”, nënvizohet; “Drithi shqiptar merrte kështu, rëndësinë e një malli strategjik, i domosdoshëm për furnizimin dhe sigurimin e bukës për popullsinë e Korfuzit dhe për garantimin, përmes tij, të rendit e të stabilitetit social e politik në atë bazë të rëndësishme veneciane...”.

Dhe, në të gjithë këtë vëllim tregtie, porti dhe gjiri i Porto Palermos, kishin një rëndësi parësore për eksportin e drithit drejt ishullit, apo destinacioneve të tjera. Aq e vërtetë është kjo sa, në dy momente, në vitin 1560 dhe në 1672, popullsia e Korfuzit u përball me pasojat e një urie të tmerrshme të shkaktuar nga bllokimi i eksporteve prej bregdetit shqiptar.

Drithërat, si mall strategjik, u përdorën gjithashtu për realizimin e synimeve strategjike dhe në këto kushte, në dy rastet në fjalë, osmanët ushtruan të drejtën e tyre për të bllokuar tregtinë përmes skelave që funksiononin përgjatë bregdetit, nga Porto Palermo në jug, çka u shoqërua me mungesën e furnizimit të ishullit me drithëra dhe me vdekjen nga uria të një numri të madh banorësh.

-Kryengritjet e Himarës në vitet 1537, 1554-1556, apo kryengritja tjetër e Himarë-Kurveleshit në 1565, si refuzim për të paguar haraçin dhe për të dërguar djemtë ushtarë.

Në kryengritjet e Himarë-Kurveleshit në 1566, luftëtarët shqiptarë, veç flamujve me simbolet e tyre, mbanin edhe flamurin venecian me simbolin e Shën Markut. Ky fakt, mund të jetë një provë eksplicite se venecianët qëndronin në një farë mënyre, pas lëvizjeve në fjalë. Në fakt, lidhja me Venedikun dhe shkëputja nga pushteti Osman, ishte një aspiratë e qartë e himarjotëve dhe kur kishte nevojë, Republika e Shën Markut e shfrytëzoi atë për nevojat e saj, siç ndodhi në ngjarjet dramatike të vitit 1571. **(56) (Pëllumb Xhufi. Arbërit e Jonit. Fq.643)**

Duke filluar nga gjysma e dytë e shekullit XVI, në Himarë dhe më gjerë, filloi të përfshihej gjithnjë e më shumë kurora e Napolit dhe shtëpia mëmë e Spanjës. Kjo, për shkak se venecianët i lanë në baltë për më shumë se një herë kryengritjet e shqiptarëve, të himarjotëve dhe, në përgjithësi, të popujve të Ballkanit.

Kështu që, pas kësaj, himarjotët kërkuan aleanca të tjera, gjë që shprehet edhe në letrën që ata i dërguan Papa Grigorit XIII në 12 korrik të vitit 1577, në të cilën, pasi prezantohen si pasardhës të Skënderbeut, përshkruajnë gjendjen e tyre dhe luftën e pareshtur me turqit, ndërkohë që njoftojnë dërgimin e një përfaqësie në Romë për të kërkuar ndihmë për rindërtimin e selisë peshkopale të Himarës, të djegur tre herë, si edhe armë për të vijuar qëndresën kundër turqve.

Nga ana tjetër, qëndresa e himarjotëve kundër Portës së Lartë, pasqyrohet edhe në një letër të shqiptarit Pjetër Kunkaro në 1570, për Mëkëmbësin e Napolit. “Sipas tij, tre sulltanë osmanë kishin tentuar t’i nënshtonin himarjotët, por ishin të detyruar të tërhiqeshin me humbje të mëdha. Por, atë që nuk arritën me forcë, e arritën me dhëlpëri kur, në 1548, ata i bindën himarjotët t’u dorëzonin kështjellën e Sopotit, ku vendosën një garnizon turk. **Më vonë, ndërtuan edhe fortesa të tjera përgjatë bregdetit, për të kontrolluar territorin.**

Në 1566, u zhvillua një betejë e rëndësishme, kur, rreth 8 mijë trupa osmane që mbërritën me luftanije fillimisht në Vlorë dhe pastaj zbarkuan në Himarë (Porto Palermo), u thyen keq nga kryengritësit himarjotë që arrinin në rreth 10 mijë luftëtarë. Pas kësaj, osmanët, që u tërhoqën me anijet e tyre, u vunë zjarrin disa fshatrave të Himarës. Qëllimi i zbarkimit të turqve, ishte që

himarjotët të paguanin haraçin.

Pas zhgënjimit për mbështetjen e spanjollëve, himarjotët, duke nisur prej vitit 1567, u orientuan drejt një aleance ushtarake me Republikën e Venedikut, që, në atë kohë hyri në një konflikt të ri me Portën e Lartë. **(57) (Pëllumb Xhufi. Arbërit e Jonit. Fq.665)** Pas përplasjes së madhe të Lepantos, të vitit 1571, mes flotës osmane dhe asaj të bashkuar, veneciane, spanjolle e papale, himarjotët nisën një bashkëpunim konkret me Venedikun dhe, konkretisht, për të realizuar pushtimin në qershor të vitit 1571, të kështjellës së Sopotit, prej venecianëve.

Në vitin 1575, në 28 korrik, himarjotët bashkëpunuan me Mbretërinë e Napolit dhe Spanjollët, për të shkatërruar kështjellën e Sopotit, që himarjotët ua kishin rrëmbyer turqve pak kohë më parë. Në një letër të nëntorit të vitit 1576, për Mëkëmbësin e Napolit, himarjotët kujtonin se 15 vjet para këtij momenti, ata ishin vënë nën sundimin e Mbretit të Spanjës. Në vitin 1577, me nismë të Papa Gregorit XIII, u themelua në Romë Kolegji Ortodoks i Shën Athanasit, një katalizator i propagandës papale për bashkimin e kishave ku, arbëreshët e Italisë luajtën një rol kryesues **(58) (Pëllumb Xhufi. Arbërit e Jonit. Fq.669, 670)**

4.2 Kryengritja e Himarës e vitit 1596.

Emigrimi i Himarjotëve drejt Napolit(siç ishte ai i një numri të madh familjesh nga Palasa në fund të shekullit XVI, që u vendosën atje dhe në Otranto, ku u përfshinë në ushtrinë e Napolit, një punë që ata e bënin shumë mirë), ka qenë një realitet që ka shoqëruar marrëdhëniet mes Bregdetit të Jugut me anën tjetër të Adriatikut. Prania e rekrutëve shqiptarë në ushtrinë e Mbretërisë së Napolit, në 1608, dëshmohet edhe nga një mbishkrim mortar në kishën ortodokse të Shën Pjetrit në Napoli, mbi varrin e dy vëllezërve, komandantë të një trupe prej 300 stratiotësh shqiptarë. Në shek. XVI, spanjollët e Napolit kishin rregullisht kompani ushtarësh shqiptarë. Ashtu si venecianët edhe spanjollët e Napolit, zbatuan në shekullin XVI-XVII, një politikë të rregullt rekrutimesh të luftëtarëve shqiptarë, të cilët u angazhuan në fronte të ndryshme. Përpjekjet për t’i rrëmbyer venecianëve ushtarë e kompani të tëra, rishfaqen me forcë kur në Napoli u krijua i famshmi Regjiment Mbretëror Maqedon, me rekrutë shqiptarë. Ushtarët shqiptarë të

trupave veneciane, gjithmonë e më pak aktive, u bënë në atë kohë objekt i joshjeve të napolitanëve. **(59) (Pëllumb Xhufi, Arbërit e Jonit, fq. 1337).** Kjo dëshmon edhe për rivalitetin mes Venedikut dhe Mbretërisë së Napolit, në këtë zonë.

Dhe një rast tërësisht i veçantë, lidhet me një ngjarje të vitit 1676. Në vjeshtën e vitit në fjalë, pranë autoriteteve veneciane të Korfuzit, mbërriti një informacion, ku vihej në dukje aktiviteti në rritje i spanjollëve (Napoletanëve-Shën.im), për të rekrutuar ushtarë shqiptarë në shërbim të tyre. Gjon Gjoni, një shqiptar që thotë se i ka shërbyer dhe do të vazhdojë t'i shërbejë Republikës, pasi përcjell një informacion të detajuar për çka po ndodhte në bregdet, propozon mes të tjerash edhe zgjidhjen e tij, për t'i dhënë fund këtij fenomeni dhe Venediku të rikthehej në faktor zotërues edhe në këtë drejtim. “Sipas tij, nëse Venecianët do të do të poziciononin një galerë (anije luftime) në Porto Palermo, askush nuk do të guxonte të largohej nga brigjet e Himarës”. **(60) (Pëllumb Xhufi, Arbërit e Jonit, Fq.1342)**

KAPITULLI V

Ali Pasha, venecianët dhe loja e tij me fuqitë e mëdha në rajon

Në hyrje të kanalit të Vivarit, në hyrje të gjirit të Butrintit, ndodhet një fortesë e vogël, e cila nga stili arkitektonik identifikohet lehtësisht me garnizonet tipike të ndërtuara dikur nga venecianët. Dhe, vërtetë, kjo fortesë është ndërtuar nga venecianët në kohën që këta të fundit, si fuqia më e madhe detare e shekujve 14-15 e më tej, dominonin Adriatikun, Jonin, Egjeun e përtej, morën këto pika me interes ekonomik e tregtar dhe ngritën fortesat garnizon për të kontrolluar qarkullimin detar, atë tregtar dhe për të realizuar dominimin e tyre politik dhe ushtarak. **[61] Irakli Koçollari, “Korrespondenca dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës”, fq 637-638**

Kjo fortesë do të mbetej në zotërim të venecianëve deri në fundin e shekullit XVIII, deri në atë moment kur, ngjarje të rëndësishme do të tronditnin Evropën. Bonaparti do të marshonte triumfues, jo vetëm në lindje dhe perëndim, por edhe drejt jugut, duke vënë në zotërim edhe territore të Venedikut dhe, më tej, ato të Italisë.

Me Traktatin e Kampo Formios, Bonaparti mori në zotërim territoret e dikurshme të Republikës së Venedikut. Në korrik të vitit 1797, francezët morën Korfuzin dhe ishuj të tjerë të Jonit, si dhe bazat ushtarake kontinentale, mes të cilave edhe Butrintin. **[62] Boppe, A: L’Albanie et Napoleon 1797-1814, Paris 1914. Irakli Koçollari, “Korrespondenca dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës”, fq.638.**

Me nënshkrimin e Traktatit të Kampo Formios në vitin 1797, ju dha fund sundimit të Republikës së Venedikut (e cila zotëronte

Korfuzin, Ishujt Jonianë dhe katër qytete në stere përballë tyre; Prevezën, Pargën, Butrintin e Vonicën), zotërimet e të cilës në ishuj dhe në stere, u vendosën nën sundimin francez. Kështu, kufijtë e Francës u shtrinë deri në ata të Pashallëkut të Janinës. **[63] Historia e Popullit Shqiptar. Toena, Tiranë 2002, fq.642.**

Por, Ali Pasha, me miratimin edhe të Portës së Lartë, ndërmoi një sulm të befasishëm ndaj garnizoneve të Prevezës dhe Butrintit, duke u shkaktuar francezëve dëme të mëdha dhe duke shtënë në dorë këto territore me interes të jashtëzakonshëm strategjik. Nga ana tjetër, në vitin 1799, flota ruse, nën komandën e admiralit Ushakov, në aleancë me flotën turke, sulmuan Korfuzin dhe Shtatë ishujt e Jonit, Lefkadhë, Zakyntho, Itakë etj., duke i marrë ato. Pas kësaj, trupat ruse zbarkuan edhe në pjesën kontinentale, duke marrë nën zotërim edhe baza të tjera, mes të cilave edhe Butrintin.

Guvernatori rus i Shtatë Ishujve të Jonit, Jorgio Mocenigo, Admirali i Flotës Ruse, gjenerali Anrep dhe konsulli rus në Korfuz, Liperaqi Benaqi, i kërkuan Ali Pashës të largonte trupat nga fortesa e Vivarit, në gjirin e Butrintit, pasi aty do të dislokoheshin trupat ruse të flotës së Ushakovit, çka ishte vendosur në marrëveshjen mes fitimtarëve, rusëve dhe turqve. **[64] Ars. Grigori “Ta pasaliqia tis Alvanias qe...”, Athina 2007, Akademia Slavikon, Erevnon) “Korrespondenca dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës”, fq.640.**

Në fakt, rusët kishin përdorur mënyra të ndryshme, duke korruptuar një pjesë të familjeve të parisë së Sulit, Çamërisë dhe Himarës, për t’ua kundërvënë Ali Pashës. Por, ndërkohë, ai u përgjigj me shtim të forcave në bazën ushtarake të Vivarit dhe në Butrint, duke u dërguar njoftimin përfaqësuesve rusë në Korfuz, se kjo bazë ishte blerë prej venecianëve. Rusët u tërhoqën përkohësisht, por në shtator të vitit 1804, i dërguan ultimatum Pashait në Janinë, duke i kërkuar dorëzimin e bazës së Vivarit, me pretendimin se ajo bënte pjesë në sovranitetin e Republikës së Shtatë Ishujve Jonianë **[65] “Korrespondenca dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës”, fq.640.**

Pas takimeve të njëpasnjëshme mes të dërguarit të Ali Pashës në Korfuz, Mitropoliti i kishës së Artës, Ignatios dhe përfaqësuesve

të Rusisë në Korfuz, Konsullit Benaqi, Guvernatorit rus Mocenigo dhe gjeneralit të flotës ruse në Korfuz, Anrep, çështja e dorëzimit të bazës së Vivarit, mbeti një mollë e nxehtë dhe vazhdoi për një kohë relativisht të gjatë, deri në momentin që, me marrëveshjen e Tilsit në korrik të vitit 1807, (“Traktati i Tilsit), Franca mori sërish në zotërim Republikën e Shtatë Ishujve të Jonit dhe, bashkë me të edhe Butrintin.

Por, këtu del fare qartë loja diplomatike e Ali Pashës, për të shfrytëzuar interesat mes fuqive të kohës, Britanisë së Madhe, Francës, Rusisë dhe Portës së Lartë dhe të realizonte objektivat e veta territoriale, veçanërisht pas shembjes së Republikës së Venedikut në 1797, me Traktatin e Kampo Formios.

Ali Pashë Tepelena, ky personazh historik, protagonist në një prej periudhave më të spikatura, më të rëndësishme në historinë, jo vetëm të Shqipërisë, është parë dhe vlerësuar në një mënyrë kontradiktore, me epitete që shpesh nuk janë përputhur me atë që ai ishte dhe përfaqësonte realisht. Kjo është evidentuar së pari, tek vlerësimet e bëra nga kancelaritë osmane, ose Porta e Lartë, pas tronditjes që shkaktoi rebelimi i Pashait të Janinës me synimin “... për të paralajmëruar çdo disidencë, prirje separatiste, apo kryengritje të ngjashme me të...” **[66] Irakli Koçollari. “Korrespondenca dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës”, fq. 7.**

Ishin pothuajse të njëjta epitete që u përdorën edhe për Skënderbeun, pas vdekjes së tij, “I pabesë”, “I pafe”, “tradhtar i profetit”, “tiran” etj.

Por, paralelisht me propagandën osmane, në të njëjtën linjë ishte edhe propaganda franceze, ku përfshihen edhe autorë të letrave, që shkruan me cinizëm për Ali Pashën dhe shqiptarët e asaj periudhe. Mes tyre, spikati konsulli i Francës në Janinë, Fransua Pouqueville, fillimisht mik i Ali Pashës, por më pas kundërshtar dhe armik i tij deri në vdekjen e Pashait. Madje, Pouqueville, ishte edhe autor dhe frymëzues e zbatues i skemave dhe organizimeve për largimin e Ali Pashës nga fronti dhe i përpjekjeve për vrasjen e tij **[67] Ibrahim Manzur Efendi “Kujtime për Ali Pashë Tepelenën. Tiranë 2003.**

Në të njëjtat linja me ta, ishte edhe shkrimtari i njohur francez

Aleksandër Dyma. E gjithë makina propogandistike franceze, e përvijoi Pashanë e Janinës, në formën dhe me trajtat më të paskrupullta, në funksion të interesave të paplotësuara, apo të kundërshtuara në këtë rajon, duke lënë gjurmë dhe impakt negativ për të dhe për vetë shqiptarët, në opinionin francez, por jo vetëm, në institucionet e këtij vendi dhe në mbarë Evropën. “Fatkeqësisht, kjo fushatë ishte e njëanshme dhe nuk pati arenë dhe sheshluftimi të denjë, me mundësi të barabarta dyluftimi mes palëve, pasi as Pashai, as shqiptarët nuk patën as shanse, as mjete dhe as makinë propogandistike për t’u kundërpërgjigjur dhe për të sqaruar opinionet me pretendime dhe argumentet e tyre, të ndryshme me ato që ishin hedhur në arenën e luftës mediatike prej “artileriesë” propogandistike të institucioneve franceze dhe osmane. [68] *Pouqueville, F.C.H.L, “Travells in Epirus, Albania, Macedonian and Thesaly”, Paris 1820.*

Por, përkundër këtij realiteti, pati edhe tentativa për të hedhur dritë mbi të vërtetat e figurës dhe asaj çka përfaqësoi Ali Pasha, duke nxjerrë dhe zbuluar arsyet e asaj çka synonte makina propogandistike franceze përmes eliminimit të Ali Pashës, si mënyra më e mirë për t’i hapur rrugë një pushtimi francez në territoret shqiptare. Mes tyre, ishte fillimisht Boppe, me veprën e vet, “Napoleoni dhe Ali Pasha” dhe më tej, studiuesi francez Alphonse de Beauchami, nga i cili mes të tjerash na vjen shprehja, “Pouqueville nuk ishte gjithmonë objektiv ndaj shqiptarëve, veçmas ndaj Ali Pashës...”. [69] *Beaucham Alphonse de “The life of Ali Pacha, of Joannina: late vizier of Epirus, surnamed Aslan, or...”, Cornhill London 1823. Irakli Koçollari, “Korrespondenca dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës”, fq.11.*

Pouqueville shihte tek Ali Pasha, pengesën kryesore për realizimin e misionit të tij në këto anë. Në linjën e zbulimit të të vërtetave rreth figurës së Ali Pashës, ishte edhe ushtaraku britanik Davenport, i cili përcakton se, qëndrimet subjektive për Ali Pashën, dalloheshin qartë në vlerësimet e francezëve për të, duke theksuar këtu veçanërisht etiketimet për të si, “tiran i vërtetë që është gati të sakrifikojë gjithçka për të plotësuar ambiciet e tij”. [70] *Davenport, R.A. “Life of Ali Pasha of Tepeleni-Vizier of Epirus”. Tomas Tegg, London 1816. I.Koçollari, “Korrespondenca*

dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës”, fq.11.

Dhe përkundër këtij përcaktimi dhe duke ju referuar edhe vlerësimeve të ushtarakut britanik Smart Hjuhx (Hudge), ai vëren se Hjuhx nuk kishte vënë re tek Ali Pasha, asnjë predispozitë gjakatari, apo etje për hakmarrje. Përkundër kësaj, ai e vlerësonte atë si një njeri zemërgjerë dhe me pamje të çiltër.

Dhe, si për ta mbyllur këtë, gazetari danez Olaf Bronstad, që kishte vizituar oborrin e Ali Pashë Tepelenës, shkruante për të, në një intervistë me Pashain “E qeshura e tij e vazhdueshme zakonisht nuk kishte asnjë shenjë mashtrimi apo dinakërie... Fliste rrjedhshëm, qartë dhe troç, lëvizte shpejt, trupin e kishte si grek, ndërsa shpirtin si shqiptar”. [71] *Bronsted, Peter Olaf “Interviews with Ali Pacha”, The Danish Institute in Athens. Athina 1999, fq 53. I.Koçollari. “Korrespondenca dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës”, fq.12*

Por, ku e kanë burimin dhe shkakun këto qëndrime të makinës propogandistike shtetërore franceze, aq më tepër për një personazh historik dhe me peshë në hapësirën e Perandorisë Otomane, i cilësuar fillimisht si mik i Francës dhe aleat i saj. Ato duhen kërkuar tek politika e interesave të këtij vendi, në rajon. Synimet e Bonapartit dhe të vetë francezëve, për të zbarkuar dhe invaduar territoret e Epirit, dolën shumë shpejt në dritë dhe Ali Pasha, që do të informohej në një moment optimal për këto synime, nga aleat i hershëm i Francës, do të shndërrohej në një kundërshtar të rreptë dhe të rrezikshëm të saj, duke e shoqëruar këtë qëndrim dhe kthesë edhe me marrjen e masave përkatëse, për të parandaluar situata të pakthyeshme ekspansioniste. Pikërisht, këtu, nis dhe transformohet në të kundërtën e dikurshme propaganda dhe qëndrimet e francezëve, që filluan një sulm të kombinuar ndaj tij, duke bërë presion edhe pranë Portës së Lartë, e trembur edhe ajo, për pozicionin e pavarur të Pashait të Janinës.

Ali Pasha, ishte një monark me privilegjet që ofronte monarkia, të cilat ai sigurisht që nuk do të rrezikonte t’i humbiste. Ishte produkt i një hapësirë territoriale dhe mentaliteti ballkanik, i mbujtur nga mentaliteti mesjetar dhe ndikime të tjera, të cilat kishin lënë gjurmë në karakterin dhe formimin e tij. Por, nga ana tjetër, ai pati meritën se, diti të nuhaste dhe të orientohej drejt

perëndimit, andej nga ndiheshin sinjalet e zhvillimeve politike e platformave revolucionare, filozofitë përparimtare të Rusoit, Didëroit e Volterit, fryma revolucionare e Robespierit e Maratit. Gjatë periudhës kur në Francë mbretëronte Luigji XVI, ai kishte ditur të përfitonte dhe të instalonte funksionin e Konsullit të Përgjithshëm të Francës, si një mundësi për t'i hapur rrugë dhe për t'i paraprirë zhvillimit të marrëdhënieve tregtare mes Francës dhe shqiptarëve, si dhe rritjen e ndikimit të Mbretit Luigj XVI në territorin që zotëronte. “Qyteti i Janinës ishte bërë jo vetëm një nga qytetet më të industrializuara të të gjithë Greqisë, por edhe selia e Greqisë moderne nën Ali Pashën”. [72] *Beaucham Alphonse de “The life of Ali Pacha, of Joannina: late vizier of Epirus, surnamed Aslan, or...”*, Cornhill London 1823. Fq.104-105 *Irakli Koçollari, “Korrespondenca dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës”, fq.17*

Janina ishte bërë një epiqendër dhe destinacion për të huajt, për diplomatë, gazetarë, studiues, piktorë, njerëz të artit, misionarë, seli e zyrave konsullore diplomatike, çka e kishte kthyer praktikisht atë “...në një metropol kozmopolit”. [73] *Irakli Koçollari, “Korrespondenca dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës”, fq. 20*

Zgjerimi dhe konsolidimi i kufijve të Pashallëkut të Janinës, çka është shoqëruar edhe me një sërë procesesh të tjera, në aspektin strukturor shtetformues dhe zhvillimor, duke përfshirë forcimin e rendit dhe të sigurisë, me realizimin dhe nxitjen e rritjes së investimeve madhore në infrastrukturë, si dhe vendosja dhe zgjerimi në vazhdimësi i marrëdhënieve tregtare dhe eksport importet me qendra të mëdha dhe kryeqytete të njohura, si Stambolli, Vjena, Napoli, Trieste, apo marrëveshjet e nënshkruara tregtare me Francën, Britaninë e Madhe, Rusinë etj., u reflektuan shumë shpejt në dimensionet e performancës së këtij pashallëku dhe të vetë qytetit të Janinës, si një nga qendrat administrative dhe një nga hapësirat më të zhvilluara në Perandorinë Osmane.

Kjo nuk ishte rastësi dhe aq më tepër një realitet, që u shfaq papritmas. Gjithçka ishte rrjedhojë e një procesi shumëvjeçar, e implementimit të një vizioni që tejkalonte dukshëm atë të një monarku provincial ballkanik. Realiteti i krijuar në këtë kënd

të Perandorisë, i vënë në dukje nga dhjetëra udhëtarë, njerëz të shquar të mendimit dhe letrave, të diplomacisë e politikës ndërkombëtare, ishte krijuar gradualisht dhe ishte derivat i reformave dhe drejtimit me një qasje të re dhe të avancuar për kohën, i një njeriu që, pavarësisht territoreve ku kishte ndërtuar mbretërimin e vet, mendjen dhe frymëzimin e gjente gjatë, në perëndimin ku gëlonte fryma e revolucioneve dhe mendimit përparimtar, ku dinamika e ndryshimeve ishte shtrirë dhe kishte përfshirë të gjithë dimensionin strukturor, social, politik e ekonomik që përcakton profilin e një vendi, ku, vetë monarkitë ishin vënë nën presionin e ndryshimeve të mëdha substanciale. Ali Pashë Tepelena, e ndjente që në tërësinë e raporteve që ai duhej të ndërtonte me kancelari dhe faktorë më shumë se rajonalë, ishte perëndimi, ishin kancelaritë evropiane, ato që do të shkonin dhe do të përmbushnin kahen e interesave dhe ambicieve të tij, për të krijuar një njësi territoriale të unifikuar dhe të pavarur nga Porta e Lartë.

Prandaj dhe duke nuhatur e zbardhur lojën e interesave të fuqive të mëdha të kohës në rajon, mes të cilave, Francës, Britanisë së Madhe, Ruisë, ai u mundua të fluidonte mes tyre, të gjente shtratin e duhur dhe të përfitonte nga to. Me intuitën dhe zgjuarsinë, apo dinakërinë natyrore, ai u përpoq të imponohej, duke aplikuar herë - herë edhe forcën, apo avantazhet e faktit të kryer. Dikur, një nga miqtë më të mëdhenj të Francës, duke nisur prej viteve të para të sundimit të tij, kur shfrytëzoi privilegjet e marrëdhënieve efektive me Luigjin XVI, Pashai i Janinës, u kthye në të kundërtën e vet, duke u shndërruar ndër kundërshtarët, apo armiqtë e deklaruar të vendit të revolucioneve. Interesat e Francës dhe ato të Pashait shqiptar, nuk shkonin më në të njëjtën shtrat, apo rrjedhë të një lumi herë të qetë dhe herë të furishëm, që vërshonte drejt deltës në detin e dimensionit Osman. Prandaj dhe francezët luajtën fort për ta rrëzuar nga froni atë, duke lobuar dhe mbështetur, jo vetëm faktorë e aktorë vendas lokalë, por edhe duke nxitur dhe shpifur pranë Portës së Lartë, ku injektuan atë që, në fakt ishte realitet, aspiratën e sundimitarit të Janinës, për të dalë më vete, në një territor që ishte skaji i Perandorisë ndaj Perëndimit. Këtu e gjen bazën edhe ajo çka bëri më pas makina propagandistike

franceze, për të denigruar figurën e tij, përmes personazheve të njohura e të spikatura të politikës, diplomacisë e letrave, mes të cilëve Pouqueville e Aleksandër Dyma. Prandaj dhe Ali Pasha, kërkoi dhe u orientua drejt faktorëve të tjerë, drejt Britanisë së Madhe, duke shfrytëzuar interesat e saj, fuqinë dhe potencialin e saj ushtarak. Por edhe ndaj Rusisë, në momente të caktuara, për të mënjeluar rrezikun që vinte nga faktorët lokalë, nga suljet, himarjet e çamët. Ishte një lojë, që Pashanë e Janinës, nuk e lodhte, por, përkundrazi e joshte në vazhdimësi për të qenë në vorbullën e saj, sepse i tillë ishte ai. Pëlqente të qëndronte e të bëhej pjesë e dinamikës, e sfidave. Periudha e sundimit të tij, nuk ngjasonte aspak me atë të një moçali që qelbet me ndenjësinë e vet. Përkundrazi. Ishte kjo dinamikë, që çlironte tek ai energjinë e nevojshme për të ecur gjithmonë përpara, për të synuar e për të arritur objektiva, për të sulmuar e mënjeluar nga rruga e vet, aktorë që përfshiheshin edhe në rrethin e lidhjeve të tij miqësore, sikundër Ibrahim Pasha i Beratit, dy djemtë e të cilit ishin dhëndurë të Ali Pashës.

Janina, ku gëlonte jeta, ku oborri i sundimitarit të saj ngjasonte me sallonet e oborreve në monarkitë perëndimore, ku profili zhvillimor ishte një realitet që nxiste zilinë provinciale. Pashallëku që ishte shndërruar në një makth për Portën e Lartë, për shkak të rebelimit herë të heshtur e herë të hapur të sundimitarit të saj kryeneç, nuk do të mund të qëndronte gjatë kështu, krenar dhe sfidues ndaj Stambollit. Ali Pasha e dinte këtë. Prandaj dhe e gjithë filozofia e tij e sundimit, ishte e bazuar në disa shtylla që kishin si referencë kultivimin dhe përfshirjen në vetvete të atyre elementëve që do t'i mundësonin betejën e vazhdueshme e të gjatë, me ata që, në finale të përbaljes, aplikuan dinakërinë e fermanit të faljes, për të nxjerrë nga skena sfiduesin më shumë se tre dekadash.

Nuk ishte rastësi që ambiciet dhe synimet e implementuara të Pashait të Janinës, nisën të shfaqen në terren në fund të shekullit XVIII dhe fillimit të shekullit XIX.

“Çmontimi” i Republikës së Venedikut dhe rënia e saj pas pushtimit nga Bonaparti në vitin 1797, shënoi edhe një moment shumë të rëndësishëm në rajonin ku ndërthureshin interesat e fuqive të mëdha të kohës.

“Pushtimi francez i Italisë dhe rënia e Republikës Veneciane me traktatin e Campo Formio në 1797, ndryshoi ekuilibrin e politikës së fuqisë në Mesdhe. Franca aneksoi të gjithë territorin e Republikës së vjetër të Shën Markut, përfshirë Ishujt Jon dhe vartësitë e tyre kontinentale përgjatë bregdetit shqiptar. Ky aneksim krijoi arsyet dhe mjetet e marrëdhënieve midis francezëve dhe Ali Pashës, duke i futur francezët në detin Adriatik, Jon dhe madje edhe Epirin si trashëgimtar të Venedikut.

Që andej, Republika e Venedikut kishte ndjekur gjithmonë politika delikate për të mbajtur marrëdhënie të mira me bejlerët autonomë të Shqipërisë, në afërsi të territoreve të saj. As Franca, si sovrani i ri i këtyre vendeve nuk ishte immune nga kjo domosdoshmëri. Nga ana tjetër, drithi dhe druri shqiptar ishin vendimtarë për trupat franceze në gadishullin italian. Për më tepër, këto rajone kishin një rëndësi të madhe strategjike, pasi ato përbënin një nga të paktat udhëkryq tregtie midis Lindjes dhe Perëndimit në Mesdhe”. [74] **İLKER DEMİR. TEPEDELENLI ALI PASHA AND THE WEST: A HISTORY OF HIS RELATIONS WITH FRANCE AND GREAT BRITAIN 1798-1820 The Institute of Economics and Social Sciences of Bilkent University DEPARTMENT OF HISTORY BILKENT UNIVERSITY ANKARA, December 2007 (Fq. 49)**

Republika e Venedikut, me një histori superfuqie detare dhe kontinentale për pothuajse 10 shekuj, kishte në zotërim Korfuzin, Kretën, ishte ndikuese e drejtpërdrejtë në rajonin bregdetar të Himarës, deri në Sarandë e Butrint, përmes marrëveshjesh detyruese, kontrollonte me flotën e saj rrugët detare në rajon e më gjerë. Kështu që, pas shembjes së saj, natyrshëm nisi procesi i vendosjes dhe rivendosjes së ekuilibrave të rinj rajonalë, ku, Porta e Lartë, Franca, Britania, nxituan për të marrë nën zotërim territoret dikur nën zotërimin venecian. Dhe vetë Ali Pasha, u bë pjesë e kësaj “loje”, duke nxituar të vihej në zotërim të këtyre territoreve. Ose më saktë, të atyre që shtriheshin në pjesën kontinentale, në Epir, në Butrint dhe në veriperëndim, në rajonin bregdetar të jugut, në Himarë, ku venecianët kishin hedhur rrënjë qysh në shekullin XIV.

Dhe, sigurisht, ky synim, kjo ambicie, nuk mund dhe s’kishte sesi

të realizohej as brenda një dite dhe as brenda një jave, një muaji, një viti. Do të duheshin vite që Pashai i Janinës, të ecte hap pas hapi, në funksion të përmbushjes së objektivave të tij. Përballë kishte shumë faktorë, fuqitë më të mëdha të kohës, kishte Portën e Lartë, por edhe kundërshtarët lokalë rivalë për zaptim terrioresh, pashallarë e bejlerë, por edhe krerë zonash e komunitetesh, apo krahina të tëra, që kundërshtonin ëndrrat e tij, mes tyre, suljetët e himarjetët, që nuk pranuan të nënshtroheshin.

Këtu, në këtë det përplasjesh e lojërash politike, diplomatike e ushtarake, duhen kërkuar dhe gjetur rrënjët e fenomeneve që dominuan jetën në hapësirën e Pashallëkut të Janinës. Në këtë këndvështrim janë analizuar dimensionet e zhvillimeve sociale, urbane, ekonomike, kulturore, arkitekturore, infrastrukturore, që kanë si autor dhe frymëzues këtë protagonist të një prej periudhave më të spikatura në historinë e Shqipërisë, Greqisë, kur u krijuan vlera të pallogaritshme në të gjitha fushat e sipërpërmendura. Dhe, kjo analizë, ka hedhur poshtë, apo ka lënë mënjanë mjaft përcaktime e perifrazime në lidhje me aspekte të caktuara të profilit të këtij Pashallëku, të këtij personazhi të historisë. Filozofia e tij nuk u shfaq si një fenomen i papritur dhe i kultivuar në boshllëk. Ajo u mbryjt dhe u kultivua në një mjedis ku ndërthureshin trashëgimia dhe traditat, ku vlerësoheshin realitetet, ku, gjeografia dhe mentalitetet ishin fakte që prodhonin mendësi e këndvështrime.

Ali Pasha, me intuitën e tij, i bëri të vetat këto faktorë, duke i shndërruar në cilësi, në instrumente vetjakë, në udhërrëfyese të praktikës dhe filozofisë së tij të sundimit dhe konsolidimit, të ndërtimit dhe rindërtimit të vlerave materiale e shpirtërore. Gjatë sundimit të tij, në Pashallëkun e Janinës, lulëzuan mes të tjerash, arti e kultura, u ndërtuan apo rindërtuan fortifikata e objekte me funksione të ndryshme, urbane e sociale, vepra arti e të tjera me vlera ndërtimore e arkitekturore. Kështjellat e ndërtuara apo rindërtuara të Janinës, Pargës, Gjirokastrës, Tepelenës, Libohovës, Porto Palermos, janë disa prej tyre, që konsiderohen si modele të arkitekturës dhe standardeve të fortifikimit dhe që janë studiuar e vazhdojnë të jenë ende edhe sot objekt studimi, për ekspertët e fushës. Për pjesën më të madhe të tyre, ka botime të shumta,

për të tjerat më pak. Por, mes tyre përfshihen edhe nga ato ku mungojnë vëzhgimet e analizat, ku mungojnë studimet.

Mes tyre, spikat kështjella e Porto Palermos, me një histori, ose më saktë me një sfond historik që shkon deri në antikitet. Për këtë objekt, mungojnë studimet e mirëfillta, mungojnë informacionet e detajuara dhe të plota. Ajo ndodhet në një pikë dominuese të bregdetit të Jugut, si dëshmi e një periudhe shkëlqimi, si një provë e rëndësisë dhe vendit të veçantë që ka zënë në historinë shumëshekullore ky rajon, por edhe si një argument i vizionit dhe ambicieve të Ali Pashë Tepelenës, i dëshirës dhe synimit të tij për të zaptuar terriore, për t'u shtrirë me sundimin e vet edhe në atë hapësirë ku nuk kishte mundur të hynte dhe të ngulej përfundimisht Perandoria Osmane.

Në të gjithë periudhën e shkëlqimit të vet, prej 1788 deri në 1822, Ali Pashë Tepelena, u përvijua me të gjithë dimensionin e tij si një sundimtar i tipit oriental, me tipare të orientimit të tij drejt modeleve perëndimore dhe në funksion të përmbushjes së ambicieve të tij.

Ngjitja dhe ngritja e Ali Pashë Tepelenës në nivelet më të larta të sundimit provincial në periferinë gjeografike të Perandorisë Otomane, por jo vetëm, përkon me zhvillime të jashtëzakonshme të cilat mund të cilësohen si referenca të historisë evropiane dhe osmane të kësaj periudhe. Kjo rastësi, apo koincidencë, e përvijon historinë e Pashait të Janinës si një staturë gjithashtu historike, që përmbledh në vetvete dhe reflekton në të njëjtën kohë, fenomenet që dominuan kohën, tendencën në rritje të decentralizimit Osman, bazat e reformave të Tanzimatit, lindjen, ose më saktë rilindjen në një dimension tjetër të nacionalizmit, çka gërshetohet me pasojat dhe ndikimet që shfaqën prania dhe interesat e imperializmit konkurrues britanik, francez por edhe rus.

[75] (İLKER DEMİR. TEPEDELENLI ALI PASHA AND THE WEST: A HISTORY OF HIS RELATIONS WITH FRANCE AND GREAT BRITAIN 1798-1820 The Institute of Economics and Social Sciences of Bilkent University DEPARTMENT OF HISTORY BILKENT UNIVERSITY ANKARA, December 2007, Fq.47.

Në këtë kontekst dhe arsyetim, historia e Ali Pashës, mund të vlerësohet edhe si një lloj pasqyre në të cilën pasqyrohen rrjedhjat e këtyre zhvillimeve, të këtyre fenomeneve që shkonin në kahun nga periferia, por që në thelbin e tyre, nuk mbetën të tilla. Sepse edhe vetë rrafshi kryesor i rrugëtimit të tij politik, lidhet dhe është rrjedhë e interesit të dukshëm perëndimor ndaj tij, që pati atë finalizim që tashmë është i njohur.

Por, në një tërësi më komplekse, figura e tij, përfshin edhe aspekte të tjera të raportit të tij me Shqipërinë dhe shqiptarët... ” *të cilët i nxori në dritë dhe i bëri të njohur kudo, ky njeri, Ali Pasha, modeli dhe përfaqësuesi më perfekt që kanë patur shqiptarët. Ali Pasha është vërtetë simboli i shqiptarizmit, nacionalizmit shqiptar*”.[76] *Bronsted, Peter Olaf. ” Interview”; “Interview with Ali Pacha”. The Danish Institute in Athens 1999. fq.43-44. Irakli Koçollari, “Korrespondencë dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës”. Fq.25.*

Në një raport për Ministrin e Jashtëm të Britanisë së Madhe, Xhorxh Kaning, në 12 tetor të vitit 1809, William Martin Leak, shkruante mes të tjerash se, “..Nëse Ali Pasha do të jetë i suksesshëm në realizimin tërësor të operacioneve ushtarake që ai është duke ndërmarrë aktualisht, ai do të jetë zot i tërë brigjeve perëndimore të Greqisë, nga Kepi i Matapanit deri në afërsi të Durrësit, me një përjashtim të vetëm, Pragën, dhe në këto rrethana ka shumë mundësi që ai pa hezitim të mund të shpallë veten Zot-Mbret të këtij vendi, pikësynim që e ka pretenduar shumë herët. [77] *Irakli Koçollari. “Ali Pasha dhe Shqipëria në arkivat britanike”. Tiranë 2013. Irakli Koçollari “Korrespondencë dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës”. Tiranë 2016.fq 26.*

Ndërkohë, gjatë një bashkëbisedimi me kolonelin britanik Leak, Ali Pasha i është shprehur mes të tjerash se, “... të gjithë pashallarët shqiptarë (ai i Shkodrës, Beratit, etj.), në rrethanat kritike aktuale, janë të gjithë të bashkuar nën një vendosmëri të palëkundur dhe janë të gatshëm të shporrin çdo agresion të huaj. Bashkë me ne është edhe Ismail Beu i Serresit, që edhe ai kërkon një pavarësi të ngjashme me atë të pashallarëve të Shqipërisë...pra edhe ai ka mendime dhe ndjenja të njëjta me ne”.[78] *Irakli Koçollari. “Ali Pasha dhe Shqipëria në arkivat britanike”. Tiranë 2013.fq231.*

Irakli Koçollari, “Korrespondencë dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës”. Tiranë 2016.fq.27.

Për disa vite rresht, në juridiksionin e Pashallëkut të Ali Pashës u përfshi edhe Moreja (Peloponezi), gjë që bëri që, harta e zotërimeve të tij të zgjerohej maksimalisht. Popullsia në hartën e kufijve të këtij pashallëku shkonte nga 1.5 milionë në 2 milionë banorë, një shifër mjaft e lartë për kohën dhe krahasuar edhe me pashallëqe të tjera të perandorisë osmane. Mes tyre, ishin qytetet, Janinë me 60 mijë banorë, Gjirokastra me 12 mijë banorë, Arta me 10 mijë, Berati 12 mijë, Delvina 8 mijë, Larisa 20 mijë, Elbasani 6 mijë etj.

Në këtë mënyrë, përmes veprimeve të tij, përmes aleancave ushtarake dhe politike, me disa nga fuqitë e mëdha të kohës, të cilat shiheshin si aleate potenciale për synimin e tij për shkaputjen përfundimtare nga Porta e Lartë dhe krijimin e një shteti të pavarur e Sovran, Ali Pasha po ecte me kujdes dhe gradualitet duke mos i reshtur asnjëherë përpjekjet, herë në mënyrë të fshehtë dhe herë në forma të dukshme.

Në vitin 1798, ishte ndërmarrja e tij e parë konkrete, kur propozoi një marrëveshje me rusët, një marrëveshje ndërkombëtare dypalëshe ku parashikohej aleancë dhe mbështetje reciproke, e cila synonte shkaputjen dhe krijimin e një shteti të pavarur me në krye Ali Pashën si monark. Më vonë, erdhi një tjetër përpjekje e Ali Pashës me britanikët, me të cilët ai nënshkroi një marrëveshje me përmbajtje të njëjtë e cila, në fakt, gjeti zbatim në atë që mundi të realizonte Tepelena, në vitet 1814-1815, kur ai ishte bërë “de facto”, monark në krye të një shteti të pavarur dhe jashtë tutelës e autoritetit të perandorisë osmane.

Por, Ali Pasha, me vizionin e vet, nuk u mjaftua me kaq. Ai synonte që shteti që kishte nisur të formatonte, të kishte edhe kuadrin e nevojshëm ligjor, ose konstituimin ligjor, në të njëjtën mënyrë sikurse edhe mjaft shtete të tjera të Evropës perëndimore. Pra, një tërësi territoriale ku të themelohej statusi ligjor i këtij shteti dhe, bashkë me të edhe i tij në krye, në cilësinë e një monarku, do të shënonte fazën përfundimtare të realizimit të ëndrrës së tij, për të cilën kishte punuar dhe po punonte në të gjitha mënyrat, duke shfrytëzuar të gjitha rrethanat, faktorët dhe aktorët mbështetës

për finalizimin e kësaj ndërmarrjeje. Në këtë proces, vizioni i tij luhatej mes dilemave, nëse shteti që po ndërtonte do të kishte trajtat e një monarkie absolute, apo një monarkie me pushtet të kufizuar, një monarki konstitucionale, apo një shtet i udhëhequr nga një kushtetutë e tipit perandorak, për të cilën kishte si referencë perandorinë austro hungareze. Për këtë ai nuk rreshti aspak në përpjekjet e tij, duke kërkuar këshilla dhe asistencë nga perëndimi, çka është vënë në dukje dhe është evidentuar nga studiues, historianë e diplomatë evropianë të kohës, të cilët vizituan oborrin e Ali Pashës, u njohën dhe admiruan vizionin e tij, atë të një njeriu që kishte përshkuar një rrugë të gjatë për të arritur në majat e pushtetit, një rrugë e mbushur me përpjekje të vazhdueshme, me vështirësi dhe përballje, me kurthe e pabesi, me hakmarrje e ndëshkime, me interesa të qëndrueshme e të paqëndrueshme, me aleanca afatgjata e të shkurtra, pragmatiste e jo të tilla, me ndërtim aleancash e miqësish, me lëshime të herëpashershme, duke mos marrë parasysh asgjë që mund të cenonte, sado pak, rrugën e tij drejt plotësimit të projektit të vet për t'u bërë sundimtar, ose më saktë monark, në një vend të pavarur nga autoriteti i Portës së Lartë, në një vend ku ai të ndihej i gjithëfuqishëm.

Të gjithë ata që shkruan për Ali Pashën, për figurën e tij shpesh kontradiktore, për atë që sollti në realitetin e fundshekullit XVIII dhe dekadat e para të shekullit XIX, janë edhe burimet e informacionit që janë përdorur në vijimësi për të krijuar një perceptim në dinamikë të staturës së Ali Pashë Tepelenës. “Kronisti osman Ahmet Cevdet Pasha Tarih-i Cevdet dhe rrëfimet e nipit të Ali Pashës, Ahmet Müfid, mund të renditen si burimet e tjera të rëndësishme osmane të përdorura. Ndër burimet parësore perëndimore, llogaritë e F.C.H.L Pouqueville, S.T Hughes, William Martin Leake, John Cam Hobhouse dhe Guillaume Vaudoncourt, japin në mënyrë adekuate informacionin e nevojshëm për të portretizuar prejardhjen e tij, karrierën politike dhe marrëdhëniet me Perëndimin. Në fakt, shumica e literaturës perëndimore për të, bazohet në këto vepra kryesore. Por, përveç këtyre, një vend të rëndësishëm zë, danezi Peter Oluf Brondsted, me “Intervista me Ali Pashën”, “Lëvizja për Pavarësinë Greke”,

si edhe Richard Clogg, 1770-1821: “Një koleksion dokumentesh dhe korrespondenca e Napoleonit”.

Gjithsesi, “L’Albanie et Napoleon” e A. Boppe dhe “Ali Pasha dhe Britania e Madhe”, e John W. Baggally, mund të renditen si burimet dytësore më të dobishme dhe të organizuara mirë, bazuar në origjinalin britanik dhe frëngjisht, që kanë shërbyer si burimet të rëndësishme për të ngritur në nivelin e besueshmërisë përshkrimin për këtë personazh të pazakontë të historisë.

Sot, ne mund ta lexojmë figurën e Ali Pashës shumë më ndryshe se më parë, mund ta njohim atë në tërësinë e kompleksit të tij, falë këtyre burimeve të shumta. Përmes tyre, figura e Pashait të Janinës, ka dalë nga gjysmerrësira dhe keqinterpretimi shpesh i qëllimshëm, i realizuar nga këndvështrimi i interesave shtetërore strategjike, sikundër ka ndodhur me atë çka përcolli makina propagandistike franceze e shekullit XIX, me autorët e sipërpërmendur, mes të cilëve Fransua Pouqueville, Aleksandër Dyma etj.

Sot, ne kemi më të qarta segmentet e aktivitetit të tij shumëdimensional, të cilat kishin në bazë ekspansionin territorial, si mënyrën më të mirë dhe efektive për të kurorëzuar idenë e një shteti të pavarur nga Porta e Lartë. Për të arritur këtë, ai përdori të gjitha format dhe mjetet që kishte në dorë, legale e ilegale, formale e joformale.

Në këtë filozofi të tij, ne kemi tashmë më të lehtë të eksplorojmë edhe projektin e tij të fortifikimeve, veçanërisht ato në rajonin bregdetar, ku përfshihej edhe bregdeti i Epirit. Dhe, Porto Palermo, ishte një prej këtyre fortifikimeve, ku teknika është alternuar dhe është vënë në funksion të qëllimit. Ky objekt është në fakt, ringritje e një dimensionit shumëshekullor, i përshtatur me nivelin dhe synimet e kohës.

Panorama e lashtë, me portin e vet, por edhe me strukturat fortifikuese, në fillim të shekullit XIX, transformohet në një nga fortesat më të mira të kohës, realizuar përmes teknikave të avancuara të zbatuara nga mjeshtër vendas dhe të huaj.

KAPITULLI VI

Trashëgimia arkitekturore e Ali Pashë Tepelenës

Sundimi dhe qeverisja më shumë se 30-vjeçare e Ali Pashë Tepelenës, në një nga pashallëqet më të mëdha dhe më të spikatura për kohën në hapësirën e Perandorisë Otomane, duhet vlerësuar edhe në një këndvështrim të veçantë, që lidhet me trashëgiminë kulturore në përgjithësi dhe atë arkitekturore në veçanti. Kjo do të na ndihmojë për të vlerësuar dhe perceptuar më mirë dimensionin e projektit të tij të fortifikimit, veçanërisht të rajonit bregdetar të Epirit, ku përfshihet edhe gjiri i Porto Palermos dhe kështjella e ngritur në këtë vend. Një realitet i tillë, lidhet me një të vërtetë të madhe: dëshirën e Ali Pashës për të krijuar dhe lënë vlera të mëdha në këto fusha, të cilën ai e përdorte njëkohësisht për të reflektuar në praktikë shpirtin rebel, të lirë e të pavarur, si edhe kundërvënien ndaj filozofisë përkatëse të kohës, që pranonte diktatin e oborrit perandorak edhe në këtë drejtim. Arti dhe arkitektura osmane përfaqësoheshin nga linja zyrtare që dominonte të gjithë krijimtarinë dhe udhëhiqte me parimet përkatëse, gjithçka krijohet e rikrijohet në të gjitha skajet e perandorisë.

Përkundër kësaj fryme zyrtare, Ali Pasha, synoi dhe realizoi praktikisht një trashëgimi të re, që bazohej në rregulla të ndryshme krahasuar me ato që kishte kultivuar dhe përcillte shkolla osmane e kulturës në përgjithësi dhe arkitekturës, në veçanti. Lulëzimi i prodhimit kulturor dhe arkitekturor në kufirin perëndimor të perandorisë, nën Ali Pashë Tepelenën, i cili sundoi për më shumë se tridhjetë vjet (1788-1822) gjatë të ashtuquajturës «Epoka e

Revolucioneve», ishte dhe mbetet një realitet që dalloi qartësisht këtë pashallëk, krahasuar me provinca të tjera të ngjashme në territorin e Perandorisë Osmane.

Dhjetëra artistë, krijues, piktorë, muzikantë, njerëz të artitë kulturës, arkitektë, ndërtues, mjeshtra, shkrimtarë, u bënë pjesë e procesit shumëvjeçar të jetës kulturore e krijuese në oborrin dhe hapësirën e Pashallëkut të Janinës. Me praninë e tyre, me krijimtarinë dhe prodhimtarinë e tyre, ata lanë gjurmë konkrete duke krijuar vlera me një individualitet të spikatur dhe të ndryshëm nga linja zyrtare e kohës. Megjithëse, Ali Pasha mund të konsiderohet pjesë e një klase të re të pushtetarëve provincial, që filluan të shfaqen në të gjithë perandorinë në shekullin e tetëmbëdhjetë dhe vijuan të jenë protagonistë në skenën e zhvillimeve të Perandorisë, ai dallonte mjaft, me ato tipare që u bënë objekt shkrimesh dhe analizash dhe që vazhdojnë të ngjallin edhe sot vëmendjen dhe kuriozitetin e opinionit, qarqeve politike e diplomatike, kulturore e krijuese. “Duke gjurmuar aftësinë e guvernatorit (Ali Pashës-shën.im), për të porositur piktura portrete të stilit perëndimor, ose për të ndërtuar komplekse arkitekturore urbane duke përfshirë pallate, xhami dhe madje edhe manastire të krishtera, kjo tezë tregon se ky ndryshim në rendin politik u përkthye në strategji të reja, të lokalizuara për shfaqje dhe përfaqësim dhe në të dyja këto drejtime ai iu përgjigj dhe sfidoi konventat e dominimit arkitektonik të vendosura në Stamboll. Kjo vërtetohet përmes një game të larmishme dëshmish, ku përfshihen monumente arkitekturore, mbishkrime epigrafike, burime diplomatike evropiane dhe dokumente arkivore që bazohen në turqishten osmane ashtu edhe në greqisht, të cilat zbulojnë rolin domethënës që kishte Ali Pasha në ndërtimin e teatrove jashtë ndikimit të rregullave që përçonte sistemi i pallatit perandorak sulltanor”. (79) **THE ARCHITECTURAL TRANSFORMATION OF THE OTTOMAN PROVINCES UNDER TEPEDELENLI ALI PASHA, 1788-1822 M. Emily Neumeier A DISSERTATION in History of Art Presented to the Faculties of the University of Pennsylvania in Partial Fulfillment of the Requirements for the Degree of Doctor of Philosophy 2016**

Ndërtimet e realizuara në periudhën e Ali Pashës, reflektojnë

individualitet, reflektojnë mënyrat dhe mjetet e përdorura nga ata që i konceptuan dhe i realizuan ato, në përshtatje me atë që synonte të arrinte monarku i Janinës, për të krijuar diçka ndryshe në oborrin e tij, që duhej të ngjasonte me atë të një kryeqyteti oriental e perëndimor. “Për sa i përket praktikave të tij të patronazhit, Ali Pasha u përqendrua në vënien në punë dhe përvetësimin e një larmie të gjerë strukturash, me rezultat transformimin e plotë të përbërjes fizike të rajonit. Ali Pasha dhe specialistët lokalë të ndërtimit që ai punësoi, zhvilluan tipologji të veçanta arkitekturore që shërbyen për të shpallur sundimin e guvernatorit, një strategji hapësinore për të sjellë në “epokën e Ali Pashës”. (80)(Po aty).

Krijimtaria dhe vlerat e krijuara në këtë drejtim, vetëm gjeografikisht ishin periferike, sepse në realitet ato ishin shumë më të ndryshme. Ai imitoi kryeqytetin dhe njëkohësisht “kundërshtoi atë”, duke arritur të përvijonte diçka të ndryshme. Ndër homologët e tij në skaje të ndryshme të Perandorisë Otomane, Ali Pasha duket se ishte një nga më ambiciozët për nga përmasat dhe numrin e rezidencave të tij, shoqëruar kjo edhe me nxitjen, krijimin dhe vendosjen e një standardi të lartë edhe për pjesën për pjesën tjetër të familjeve sunduese provinciale. Ky fakt, reflektonte vizion, reflektonte një tjetër koncept për jetën “e oborrit”, për të krijuar, për të ndërtuar dhe kultivuar një kulturë të re, një mendësi të ndryshme dhe për t’i dhënë Janinës dhe gjithë sundimit të vet, profilin e një kryeqendre që nuk kishte asgjë të përbashkët me provincën dhe provincializmin, me periferinë si koncept gjeografik dhe periferinë si mënyrë të menduari dhe të jetuari. Ai synonte të shkëputej nga tutela e autoritetit perandorak të Portës së Lartë dhe për këtë arsye, çdo detaj, çdo element i strukturës së tij të sundimit, duhej t’i shërbente kësaj ideje, këtij qëllimi. Këtë strategji nisi ta implementonte qysh në fillim të ngjijtjes së tij në majat e larta të pushtetit, qysh në vitin 1784, kur me ndihmën dhe mbështetjen e diplomacisë veneciane ai u emërua në postin e guvernatorit (mytesarifit) të Delvinës dhe më pas, kur pushteti i tij u formalizua me të njëjtat funksione, kronologjikisht në Trikalla (1786) dhe në Janinë (1788).(*)

Në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë dhe në vijim, Ali Pasha

u përpoq dhe arriti të shfaqte pasurinë dhe autoritetin e tij, me investime në objekte luksoze, si dhe në sarajet e pamasë pallatesh, të cilat, “... siç vuri në dukje një analist evropian në Janinë “formojnë një shenjë kaq dalluese midis barbarëve, madhështi dhe sqimë elegante”. (81) (Po aty)

Por, mes vlerave të krijuara në Pashallëkun e Janinës në periudhën e sundimit të Ali Pashës, ishte rrjeti i pasur i fortifikimeve, ku përfshihet edhe ai në pjesën bregdetare.

Qysh kur u vendos në postin e lartë të guvernatorit të Janinës në 1788 (më parë në postin e Delvinës në 1784 dhe guvernatorit të Trikallas në 1786), ai e përqendroi vëmendjen dhe energjinë e vet në ndërtimin e komplekseve të mëdha të pallateve urbane në brendësi të rajonit, ndërkohë që siç është e njohur, kishte akses, ose më saktë, dalje të kufizuar në det. Kjo për shkak se në atë periudhë, pjesa dërrmuese e porteve në bregdetin e Jonit ishin pjesë e sundimit venecian. Ky ishte një realitet që binte ndesh me ambiciet e tij, me vizionin për të hedhur vështrimin drejt dimensioneve të tjera territoriale.

Ishte koha kur Republika e Venedikut po shkonte drejt fundit të vet. Venecianët e Serenissimas, po përjetonin ditët e venitjes pas shkëlqimit më shumë se 1000-vjeçar. Asgjë nuk mund të parandalonte dhe të bllokonte atë çfarë po ndodhte. Përballë furisë Napoleoniane, askush nuk mund të qëndronte gjatë. Projekti i Napoleon Bonapartit dhe synimet e tij për ekspansion në territoret e Italisë, i përshpejtuan ngjarjet. Fundi i Republikës së Shën Markut, erdhi shumë shpejt. Ajo u shemb në vitin 1797, pas Traktatit të Kampio Formios, duke gjeneruar një sërë pasojash dhe duke shënuar njëkohësisht edhe fillimin e procesit të krijimit të ekuilibrave të rinj, në një nga rajonet ku interesi dhe synimet e fuqive të mëdha të kohës, ishin mjaft të mëdha. Dhe, bashkë me to edhe synimet dhe ambiciet e Ali Pashë Tepelenës, i cili prej më shumë se 10 vjetësh ishte ngjitur në majën e pushtetit dhe kishte nisur t’i shihte me syrin dhe mendjen e një sundimtari më shumë se provincial, këto zhvillime. Ai kishte pritur, por nuk mund të priste më gjatë. Koha për të kishte mbërritur. Çdo vonesë, do të ishte e dëmshme. Prandaj dhe u hodh në veprim.

Me nuhatjen dhe vizionin e vet, Ali Pasha e kuptoi se kishte

ardhur momenti i artë, për atë që synonte prej kohësh; krijimin e një hapësire territoriale të unifikuar dhe të pavarur nga autoriteti i Portës së Lartë, shumë më të gjerë se ajo që ai administronte deri në ato momente. Për të realizuar këtë, duhej të përfshinte në rrjetin e sundimit të vet, pika strategjike kontinentale e bregdetare.

Zotërimet e Republikës së Venedikut, ishin ato që do të mund t'i garantonin atij ekspansionin dhe shtrirjen e nevojshme gjeografike. T'i garantonin një frymëmarrje tjetër, shumë më të ndryshme në përmasa dhe garanci për më tej. Por, shumë shpejt u qartësua fakti se, pas shembjes së Republikës Veneciane, Ali Pasha nuk ishte i vetmi që kishte projekte në këto territore dhe hapësira detare, të cilat ishin shfrytëzuar prej shekujsh dhe ishin përdorur si baza të përshtatshme për bashkëpunim dhe komunikim me kontinentin italian, apo me Maltën, Dalmacinë dhe Peloponezin. **(82) William Miller, "The Ionian Islands under Venetian Rule," The English Historical Review 18/70 (Apr., 1903), 214-215. Also see S. Margaritis, Crete and Ionian Islands under the Venetians (Athens: Leontiadis, 1978)**

Prandaj dhe, në më shumë se 10-vjeçarim e fundit të shekullit XVIII, konkurrenca dhe përpjekjet për kontrollin mbi bregdetin në fjalë, u shndërruan në një përplasje të ashpër, mes disa prej fuqive më të mëdha të kohës.

Në këtë konflikt tërësor, u përfshinë Perandoritë Britanike, Ruse dhe Osmane dhe po aq fuqishëm edhe Franca, e cila synonte të bëhej mëkëmbëse dhe trashëgimtare e ish-zotërimeve të Venedikut edhe në këtë rajon, pasi më parë, në 1797, kishte pushtuar territoret në Itali, duke i dhënë fund Republikës Veneciane.

Në këtë realitet kundërshtish e interesash, ku përziheshin me synimet e tyre fuqitë e mëdha, në një atmosferë ku konfliktet do të zbankonin në të gjitha trajtat, në këtë arenë ku do të përdoreshin aleancat dhe përplasjet, përveçse disavantazheve të mëdha, Ali Pasha, kishte edhe një favor të madh; ai ishte ndërmjetësi, ose më saktë, përfaqësuesi i vetëm i pushtetit të Portës së Lartë në rajon. Me këtë avantazh, atij do t'i duhej të gjente modalitetet dhe të përcaktonte strategjinë më të përshtatshme për të luajtur dhe për të fituar në këtë situatë. Dhe, ai e kuptoi se, "... një pjesë thelbësore e sigurimit të kufirit të tij detar ishte kapja, mirëmbajtja

dhe rindërtimi i fortifikimeve lart e poshtë bregut perëndimor të Epirit. Programi i guvernatorit për dominimin arkitektonik përgjatë bregdetit do të përfshijë, të paktën, njëmbëdhjetë struktura individuale fortifikuese". **(83) THE ARCHITECTURAL TRANSFORMATION OF THE OTTOMAN PROVINCES UNDER TEPEDELENLI ALI PASHA, 1788-1822 M. Emily Neumeier A DISSERTATION in History of Art Presented to the Faculties of the University of Pennsylvania in Partial Fulfillment of the Requirements for the Degree of Doctor of Philosophy 2016**

Dhe, ai u orientua dhe nisi të punojë konkretisht për këtë element, duke bërë investime të mëdha, duke angazhuar arkitektë e specialistë, duke kërkuar ndihmë dhe këshilla, duke paguar ekspertë nga vende me traditë në këtë fushë, mes të cilave, nga Italia, Franca e Britania e Madhe, por edhe mjeshtër dhe specialistë vendas. Ishte një ndërmarrje e madhe, një aksion i shtrirë në kohë dhe në gjeografi, çka u konkretizua me atë realitet, me atë rrjet fortifikimesh të standardeve më të larta për kohën, që i dhanë atij mundësinë të zbatonte në tërësinë e vet të gjithë atë kuadër synimesh që e fuqizuan gradualisht pashallëkun e Janinës. "Ky rrjet ndërtimesh ushtarake qëndron si një vepër mbresëlënëse logjistike dhe burimesh, veçanërisht kur merret parasysh fakti se pjesa më e madhe e këtij aktiviteti ndërtimor u zhvillua në harkun kohor prej rreth pesëmbëdhjetë vjetësh 1800-1815" **(84) (Po aty)**

Tek kjo strategji mbrojtjeje, tek kjo zgjidhje fortifikimesh, përmes së cilës ju dha përparësi zonës bregdetare, qëndron edhe çelësi i suksesit të Ali Pashës në politikën e tij të zgjerimit të territoreve dhe fuqizimit të pashallëkut. Tek ky koncept dhe realizim njëkohësisht, qëndron edhe përgjigja e pyetjes mbi marrëdhëniet e tensionuara në vijimësi mes Portës së Lartë dhe Ali Pashës, mbi ndërtimin e arkitekturës ushtarake. Por, kjo përbën vetëm njërën anë të problemit. Kjo, sepse gjithë politika e investimeve të Pashait të Janinës për fortifikimet ushtarake në rajonin bregdetar, nxiste shqetësim dhe xhelozitë tek fqinjët në ishujt e Jonit. "Ka mjaft të dhëna arkivore ku citohen episode konkrete në të cilat Ali Pasha është atakuar nga përfaqësues të ishujve të Jonit, ashtu sikundër edhe nga Porta e Lartë, e cila përpiqej të minimizonte

pasoja diplomatike të kësaj politike fortifikuese, e cila shpesh është cilësuar si provokuese”. (85) **William Miller, “The Ionian Islands under Venetian Rule,” The English Historical Review 18/70 (Apr., 1903)**

Por, në këtë pikë, duhet vlerësuar apo rivlerësuar një detaj mjaft i rëndësishëm. Studiues të ndryshëm të figurës dhe aktivitetit të Ali Pashës, kanë pranuar konceptin e marrëdhënieve kontraktuale mes tij dhe Portës së Lartë, në orientimin dhe zbatimin e politikës së jashtme. Kjo, sepse perandoria i dha liri atij në punët e veta, për aq sa ai mbështeste Stambollin me furnizime dhe trupa. Dhe kjo marrëdhënie, ky raport gjejnë reflektim të drejtpërdrejtë pikërisht në projektin e ndërtimit të rrjetit të fortifikimeve bregdetare. Kjo sepse, fillimisht zonat bregdetare u morën fillimisht nën argumentin e mbrojtjes së zotërimeve të Perandorisë, ndërkohë që, në realitet rezultoi e kundërta; ky rrjet fortifikimesh përfaqësonte dhe shprehte drejtpërdrejt dhe katërçipërisht vizionin e vezirit për zgjerimin e territoreve dhe suksesin e vet ekonomik.

Mjafton të përmendim këtu marrëdhëniet konfliktuale të Ali Pashës me himarjotët dhe krahinën e Himarës në tërësi, për të vlerësuar e kuptuar thelbin e projektit të tij të rrjetit të fortifikimeve. Porto Palermo ishte skaji veriperëndimor i zotërimeve të vezirit përballë Himarës, në vijën bregdetare. Madje, linja e kufirit të tij përballë Himarës, ishte pikërisht projekcioni shkëmbor që ndante gjirin e Panormës së lashtë (Porto Palermo), në dy pjesë, ku prej Pashait u ndërtua (apo rindërtua) kështjella që mban të njëjtin emër me atë të këtij porti, pra, kështjella e Porto Palermos. Ky realitet përmendet edhe nga kapiten William Martin Leake, i dërguari i Britanisë së Madhe pranë oborrit të Janinës, i cili sjell detaje interesante për këtë pikë, që përbën edhe një nga kapitujt më të rëndësishëm të aktivitetit dhe sundimit të Ali Pashës, politikës së tij për zgjerimin e territoreve, që sigurisht hasi edhe kundërshtinë e faktorëve të ndryshëm, mes të cilëve edhe ata lokalë. Konkretisht, himarjotët përfshihen mes atyre faktorëve që u qëndruan përballë deri në fund synimeve të vezirit të Tepelenës për ekspansion.

“...Në jug të Palasës është një varg fshatrash në anën e malit, deri në hyrje të Kanalit të Korfuzit, të gjithë më parë i përkisnin ligës Khimarjote; por këto, nga Port Palérimo [Palermo] në jug, tani

janë në duart e Alý Pasha.....Palérimo, Panormusi i lashtë, të cilin Straboni e përshkruan si një port të madh në mes të maleve Cerauniane, dhe kështu dallon qartë nga Panormusi i Oricum, ndahet në dy gjire nga një gadishull shkëmbor.... Në skajin e portit verior, kodrat janë të kultivuara mirë, por këto janë pjesë e territorit të qytetit të Khimára, i cili zotëron të drejtën ekskluzive të peshkimit në atë ndarje të gjirit.... (86) **William Martin Leake, *Travels in Northern Greece*** (London 1835), volume 1, pp.1-105, 363-384

Por marrëdhënia e Ali Pashës me himarjotët në thelb asnjëherë nuk ishte e qetë, pavarësisht periudhave të caktuara, kur, dukej se ekzistonte një lloj mirëkuptimi i dyanshëm, që reflektohej në një lloj qetësie. Por, kjo ishte si një qetësi përpara furtunës, për shkak se, Ali Pasha, asnjëherë nuk do hiqte dorë dhe nuk do të reshte së synuari territoret e Himarës, ashtu sikundër himarjotët nuk do të përkuleshin asnjëherë dhe të nënshtroheshin ndaj tij.

Në këtë pjesë të bregdetit të Epirit, Ali Pasha kishte një pikë të fortë vëzhgimi dhe mbështetjeje të synimeve të tij, kalanë e Sopotit (Borshit), në një nga pikat dominuese të bregdetit. Ishte një fortifikim i ndërtuar dhe rindërtuar në periudhat paraardhëse nga osmanët, që e kishin përfshirë atë edhe në një program rindërtimi në vitin 1622. “Sopotó qëndron në një glen dhe ka një kështjellë të quajtur Bordji [Borsh], në majë të një shkëmbi të thepisur të komanduar nga Hadji Beddó Agá, një partizan i Vezirit. Këtu janë të vetmet familje turke në këtë bregdet...”. (87) **William Martin Leake, *Travels in Northern Greece*** (London 1835), volume 1, pp.1-105, 363-384

Por pavarësisht kësaj, konflikti dhe përplasjet mes Pashait dhe himarjotëve e shoqëruan të gjithë historinë e sundimit të Ali Pashë Tepelenës. Ato shndërroheshin në beteja të ashpra që kanë mbetur në histori. Njërin prej tyre e fikson dhe e sjell kapiteni William Martin Leak në shënimet e tij të udhëtimit në fund të vitit 1804 dhe fillim të vitit 1805, në këtë rajon. Sigurisht që i dërguari i Britanisë së Madhe në oborin e Pashait, nuk e ka përjetuar vetë këtë betejë, këtë konflikt të armatosur, sepse ai i referohet një periudhe që përkon me atë të viteve të fundit, përpara se ai të mbërrijë dhe të shkelë në këto troje. Por, vërtetësia e atyre që

kanë ndodhur këtu është e plotë edhe për faktin se ai u referohet tregimeve të personazheve të gjalla, me të cilat ka biseduar dhe ka marrë informacionin e nevojshëm. “Khimára, e vendosur në një lartësi shkëmbore të pjerrët, e mbrojtur nga të dyja anët nga lugina e një përroi dhe me të gjitha shtëpitë e saj të jashtme të përgatitura për mbrojtje, me fuqinë e saj deri më tani ka shërbyer si një pengesë për të gjithë pjesën veriore të rrethit kundër armëve të Alý Pashës. Tre apo katër vjet më parë, Khimariotët luftuan me trupat e tij në kodrën mbi Palérimo. Kohët e fundit, duke vizituar vendin e fundit, ai propozoi të blinte një copë tokë nga Khimariotët, me qëllim ndërtimin e një kështjelle, të cilën ata me mençuri e refuzuan...”. (88)William Martin Leake, *Travels in Northern Greece* (London 1835), volume 1, pp.1-105, 363-384

Ali Pasha, i njohur për dinakërinë e tij, nuk është mjaftuar vetëm me gjuhën dhe metodat e forcës për të përmbushur objektivat ndaj Himarës dhe himarjotëve. I bindur se nuk do të mund t'i thyente ata, është përpjekur të blejë guximin dhe vendosmërinë e tyre, të blejë trojet e tyre, si një argument i asaj që ai i ka thyer, pavarësisht mënyrës, me dhunë, me dinakëri, apo duke i blerë. Një sukses i tillë, do të mbetej gjithsesi një sukses dhe sigurisht do ta qetësonte sadopak krenarinë e cenuar të tij, nga sfidat e këtyre banorëve që nuk u pushtuan asnjëherë. Por, përmes kësaj, ai do të fitonte edhe një element tjetër, një bastion të fortifikuar dhe të avancuar, të ngulur në trojet që nuk i bëri asnjëherë të vetat. Kjo ishte, sigurisht, pjesë e strategjisë së tij, asaj strategjie përmes së cilës ai u përpoq të realizonte ëndrrën e ekspansionit territorial. Në momentin që po flasim, kishte nisur tashmë vënia në jetë e projektit të tij të ndërtimit të një rrjeti të fortifikuar dhe që, sipas studiuesve të figurës së tij, zgjati rreth 15 vjet, 1800-1815.

Është ky një nga dimensionet më të spikatura që krijoi Pashai shqiptar, gjatë sundimit të tij në krye të një prej pashallëqeve më të mëdha të kohës, në Perandorinë Osmane. Ndërkohë, ky rrjet, në një analizë paksa më të detajuar, dëshmon se inxhinierët dhe specialistët që angazhoi Ali Pasha për këtë qëllim, “...krijuan një tipologji dalluese të ndërtesës fortifikuese në kufirin perëndimor të Perandorisë Osmane”. (89)THE ARCHITECTURAL TRANSFORMATION OF THE OTTOMAN PROVINCES

UNDER TEPEDELENLI ALI PASHA, 1788-1822 M. Emily Neumeier A DISSERTATION in History of Art Presented to the Faculties of the University of Pennsylvania in Partial Fulfillment of the Requirements for the Degree of Doctor of Philosophy 2016-SHNDËRRIMI ARKITEKTUROR I PROVINCAVE OTOMANE NËN TEPEDELENLI ALI PASHA, 1788-1822.M.

Kjo, krahasuar jo vetëm me stilin arkitekturor që dominonte ndërtimet fortifikuese në territorin e perandorisë, por edhe ndërtimet e këtij lloji në provinca të tjera të hapësirës gjeografike otomane.

Kjo veçanti, kjo tipologji duhet vlerësuar edhe në një kontekst tjetër, që nxjerr faktorë të tjerë ndikues dhe që kanë në bazë trashëgiminë në këtë rrafsh. Ali Pasha trashëgoi një realitet të ndërlikuar gjeopolitik në bregun perëndimor të territoreve të pashallëkut të tij, ku qytetet bregdetare kontinentale kishin shkëmbyer vazhdimisht flamujt venecianë dhe osmanë. Kjo, deri në fund të shekullit XVIII dhe fillimit të shekullit XIX, kur shembja e Republikës së Venedikut, nën ekspansionin e Bonapartit, e shndërroi rajonin në një zonë konflikti.

Në një atmosferë të tillë, në vitin 1798, veziri u ngarkua nga Porta e Lartë për të dëbuar francezët nga katër ish-zotërimet veneciane kontinentale, mes të cilave, Butrinti, Parga, Preveza dhe Konica. Ky moment i njohur historik, që vijoi më pas me përfshirjen e këtyre qendrave të njohura bregdetare në Republikën e Shtatë Ishujve Jonianë, pas marrëveshjes ruso-turke dhe shkrirjen më pas të saj, pas vitit 1806, me rinisjen e konfliktit mes Turqisë dhe Rusisë, sjell edhe një herë në vëmendje rëndësinë që kishte ky rajon për fuqitë e mëdha dhe aftësinë e Ali Pashës për të depërtuar dhe përfituar në këtë lojë interesash. Ai arriti të bëhej sundimtar në disa prej këtyre qendrave, duke e shoqëruar këtë sukses me zbatimin në praktikë të strategjisë së tij, për të shtrirë përgjatë kufirit të zotërimeve të veta rrjetin mbrojtës të fortifikimeve.

Ishte një luftë dhe strategji me përfitime të rëndësishme ekonomike, sepse portet lokale konsideroheshin potenciale të jashtëzakonshme në këtë drejtim. Vetëm duke u nisur nga fakti se, përgjatë bregdetit të Epirit, nga Vlora (Avlona), në drejtim të

Porto Palermos, në këtë bregdet të frikshëm dhe të rrezikshëm për anijet, nuk kishte mundësi ankorimi për mjetet lundruese, për të vlerësuar peshën e përfitimeve ekonomike që mund të sillte një port si ai i Porto Palermos.

“Në epokën para moderne, anijet lundronin në gjatësinë e këtij bregu duke u hedhur midis disa gjireve që shponin vijën bregdetare, e cila ishte e pjerrët dhe shkëmbore në veri dhe e përmbytur me kënetë në jug. Nga Avlonya në Porto Palermo, për shembull, praktikisht nuk ka vend ku të shtrihet porti, duke formuar një breg të frikshëm të rrezikshëm për anijet, veçanërisht në mot të keq. Brenda këtij peizazhi, portet që ofronin strehim u bënë një burim shumë i vlefshëm dhe shumë i kontestuar”. (90) **(Po aty)**

Në kohën e sundimit të Ali Pashës dhe në vijim, Porto Palermo nuk kishte asnjë lloj vendbanimi të përhershëm. Nuk ishte një qendër urbane e plotë dhe me funksione të tilla, për të plotësuar kuadrin e një hapësire me funksion të shumëfishtë, social, urban, ushtarak etj. Përkundrazi, ai shërbeu si një post për monitorimin e portit, si dhe të fshatit rebel të Himarës në veri.



Foto 15- Plan i Kështjellës së Porto Palermos, ndërtuar nga Ali Pasha

Mjafton ky fakt, për të perceptuar drejtësinë e strategjisë së Ali Pashë Tepelenës, për ndërtimin dhe vënien në funksion të një rrjeti të gjerë fortifikimesh në bregdet, më përfitim të shumëfishtë, ekonomik, politik e ushtarak.

Porto Palermo ishte një prej tyre dhe ndërtimi (ose rindërtimi) i kësaj kështjelle, duhet vlerësuar brenda këtij koncepti, brenda kësaj strategjie. Ky objekt fortifikues, nuk duhet parë e vlerësuar i shkëputur nga profili dhe aktiviteti i Ali Pashës, si sundimtar me ambicie dhe vizion, si një njeri që vlerat dhe objektivat, i shihte në çdo aspekt dhe hallkë të dinamikës dhe strukturës së funksionimit të një njësie administrative, qoftë kjo një provincë, pashallëk, apo një shtet i shkëputur nga autoritarizmi perandorak, i një fuqie të madhe, siç ishte Perandoria Osmane.

Për Ali Pashë Tepelenën, ëndrra e tij për të ndërtuar një hapësirë të unifikuar dhe të shkëputur nga sundimi, tutela, apo varësia e Portës së Lartë, do të thoshte që ai ta strukturonte këtë ide dhe këtë realitet në të gjithë zinxhirin e mekanizmit të funksionimit të shtetit që synoi të ndërtonte. Pra, të nxiste e të krijonte një kulturë me një fizionomi të ndryshme nga tërësia e rregullave që nxiste dhe impononte qendra perandorake, të krijonte e të nxiste konkretizimin e një arkitekture përjashtuese nga parimet që impononte Porta e Lartë. Sepse, një shtet i pavarur, pavarësisht nga mënyra e organizimit dhe forma e qeverisjes dhe e drejtimit, do të thoshte që ai të kishte fytyrën dhe profilin e vet, në të gjitha aspektet.

Prandaj dhe rritja në vazhdimësi e shkallës së autonomisë së Ali Pashës, për sa i përket çështjeve të qeverisjes, ishte e lidhur thelbësisht me një ndryshim të thellë ndaj dominimit arkitektonik. Në këtë proces shndërrimesh të thella, duhen evidentuar disa elemente që kanë qenë objekt studimi nga studiues dhe njerëz të letrave, që vizituan oborrin e Ali Pashës, veçanërisht në periudhën e ndryshimeve të mëdha. Ai u frymëzua nga idetë dhe mendimi i përparuar evropian, nga filozofia e revolucioneve e përfaqësuar nga emra të shquar të asaj kohe. Nën frymën e këtyre ndryshimeve që po përjetonte Evropa e fundshekullit XVIII dhe fillim shekullit XIX, ai u imponua dhe u përpoq të fuste koncepte të reja në atmosferën e jetës në pashallëkun e vet. Kështu, duke

nxitur alternimin dhe gërshetimin e teknologjisë së importuar në ndërtim me traditat arkitekturore lokale, sipas Emily Neumeier, të Universitetit të Pensilvanisë, veziri u mundua të ...”.. konsolidonte një popullsi të larmishme të komuniteteve të ndryshme fetare dhe etnike, me elitat e krishtera në oborrit e tij, gjithnjë e më kozmopolite në lidhjet e tyre, me një zonë më të gjerë të tregtisë dhe kulturës intelektuale”.

Sikurse e nënvizova më lart, është e njohur tendenca e Ali Pashës në projektet e tij arkitekturore për të shpërfillur protokollet e vendosura për të treguar respekt ndaj fronit, duke e trajtuar popullsinë nën zotërimin e tij, më shumë si nënshtetas të vet se sa të sulltanit. Kjo tendencë, iu shtua arsyeve të tjera, që, po aq fuqishëm, nxitën zemërimin e Portës së Lartë dhe qëndrimin e saj ndaj sundimitarit të Pashallëkut të Janinës.

Ky rishikim i ndërhyrjeve urbane të Ali Pashës u pasua edhe nga një rishikim dhe hetim prej tij, i zhvillimit të fortifikimeve bregdetare përgjatë detit Jon. Me ose pa dijeninë e Stambollit, Ali Pasha ndërtoi një sërë fortesash përgjatë vijës së tij bregdetare për t’iu kundërvënë komuniteteve të popullsisë që i kishin rezistuar ambicieve të tij për të zgjeruar zonën e tij të pushtetit. Dhe kështu ndodhi me Himarën, me popullsinë e saj, që asnjëherë nuk ju nënshtrua Ali Pashës, që i qëndroi presionit të tij dhe i rezistoi deri në fund, pavarësisht mënyrave të përdorura, pavarësisht ushtrimit të forcës së armëve apo përdorimit të dinakërisë.

“Për të ngritur këtë rrjet fortifikimesh, ai afroi inxhinierë dhe specialistë ndërtimi të huaj dhe vendas, të cilët krijuan një arkitekturë ushtarake që ishte mbresëlënëse për t’u parë”, thotë Emily Neumeier, i Universitetit të Pensilvanisë. Përmes kësaj, ai synonte t’i mbijetonte një sulmi ushtarak, që mund t’i vinte nga drejtime dhe faktorë të ndryshëm, duke përfshirë kështu Portën e Lartë, apo faktorët dhe komunitetet lokale. Dhe ajo çka ndodhi më pas, vërtetoi parashikimet e tij. Mjafton të përmendim faktin se rindërtimi i mureve të Janinës, e shndërroi atë fortesë në një barrierë mbrojtëse efektive ndaj trupave të sulltanit, duke i sfiduar dhe përballuar në sulmin e tyre për më shumë se dy vjet.

Kështu ndodhi edhe me Porto Palermon, me kështjellën e saj, që u ndërtua (apo rindërtua) në frymën e parashikimeve të tij

për ta shfrytëzuar si mjet në realizimin e idesë së ekspansionit territorial. Dhe, këtu, me siguri që në këtë projekt ka ndikuar edhe funksioni historik i Porto Palermos, vendosur në një pozicion strategjik. “Për shkak të pozicionit të vlefshëm strategjik, brigjet e Porto Palermos janë përdorur prej kohësh për qëllime mbrojtëse, nga garnizoni i lashtë i Panormusit. (92). (Gilkes, Albania: An Archaeological Guide, 241. R.J.A. Wilson, R. Talbert, Sean Gillies, Valeria Vitale, Jonathan Prag, Jeffrey Becker, and Tom Elliott, “Pan(h)ormus: a Pleiades place resource,” Pleiades: A Gazetteer of Past Places (2015), <http://pleiades.stoa.org/places/462410>, accessed September 11, 2016.)



Porto Palermo, një gji detar i mrekullueshëm, i kufizuar nga veriu dhe jugu nga kepe natyrore, garanton brenda hapësirës detare, një lundrim të qetë dhe të sigurt. Projektioni i vogël shkëmbor, që e ndan pothuajse në mënyrë simetrike këtë gji detar, u shfrytëzua prej Ali Pashë Tepelenës për të ngritur këtë fortesë kështjellë, në formën që është edhe sot, një strukturë ushtarake trekëndore me tre bastione poligonale.

E aksesuar nga bregu përmes një shtegu të ngushtë, ose një istmi, sikundër e kanë emërtuar udhëtarët e hershëm, mes të cilëve Pouqueville dhe William Martin Leak, kalaja dukej paksa e veçuar. Dikur, në një hapësirë mbi hyrjen kryesore të këtij objekti,

në pjesën lindore të tij, ishte fiksuar një mbishkrim, por sot nuk ekziston. Ky fakt, që do të trajtohet më poshtë, ka bërë që edhe interpretimet për datimin e kështjellës të jenë të ndryshme. Nëse u referohemi burimeve britanike, që kanë në bazë në një masë të konsiderueshme, raportimet dhe përshkrimet e të dërguarit të Britanisë së Madhe në Janinë, Kapitenit William Martin Leake, kjo kështjellë mendohet të jetë ndërtuar në fillim të viteve 1800, ndoshta në periudhën 1804-1805.

Dëshmitë arkivore nga Arkivi Kombëtar në Londër sugjerojnë pikërisht këtë. **(93) In a report dated August 1805, William Martin Leake writes that “Ali Pasha has lately built a castle on the point of the peninsula” of Porto Palermo: National Archives, London, FO 78/57, Papers of Captain Leake (1803-1807)) Në një raport të gushtit 1805, William Martin Leake shkruan se: “Ali Pasha ka ndërtuar kohët e fundit një kështjellë në pika e gadishullit” të Porto Palermos: Arkivi Kombëtar, Londër, FO 78/57, Gazetat e kapitenit Leake (1803-1807))**

Leake notes in his travel account the presence of a house, most likely for the fortress commander as well as the church at Porto Palermo: Idem. The church can be currently found due east of the fortress, where the rocky outcrop into the bay meets the modern road. It has an inscription on the exterior that I read as the date [1]818, but this plaque is badly damaged. If the date is correct, then it is possible that Leake, who traveled to Porto Palermo in 1805, saw an earlier iteration of the structure on the same spot or nearby

“E afruar nga një shteg i ngushtë nga bregu, kalaja qëndron e izoluar dhe kishte vetëm pajisjet elementare për t’i shërbyer nevojave imediate të garnizonit të vendosur aty. Një nga këto pajisje ishte një kishë, e cila mund të shihet edhe sot, një veçori që na kujton se ushtarët nën komandën e Ali Pashës ishin të besimit mysliman dhe të krishterë”. **(94) (Po aty)**

Vlerësuar në një kontekst të tillë arsyetimi, është e vështirë të përcaktohet me saktësi momenti, apo periudha kur është ndërtuar apo rindërtuar kështjella e Porto Palermos. Por, nga ana tjetër, kjo hedh poshtë një pjesë të përcaktimeve të mëparshme që e lidhin

ndërtimin e këtij objekti fortifikues me dëshirën e Ali Pashës për t’i bërë një dhuratë bashkëshortes së tij, Vasiliqisë, ku ajo të shkonte herë-herë për të pushuar në këtë gji të bukur detar. Mjafton vetëm fakti i mospërputhshmërisë së momentit kur është ndërtuar (apo rindërtuar) kështjella në formën që është edhe sot, me martesën e vezirit shqiptar me Vasiliqinë, për të kuptuar se sa i pasaktë është përcaktimi i mësipërm. Vasiliqia dhe Ali Pashë Tepelena vunë kurorë në kishën pranë kështjellës, në vitin 1816, pra më shumë se 12 vjet pas periudhës që përkon me ndërtimin e saj, sipas burimeve britanike.

Gjithsesi, Kështjella e Porto Palermos, është një objekt që dëshmon dhe përcjell informacione dhe mesazhe. Përmes “leximit” të saj, të historikut të ndërtimit, të vlerave arkitekturore, etj., mësohen mjaft detaje nga aktiviteti dhe figura e Ali Pashë Tepelenës, që sundoi në Pashallëkun e Janinës për një periudhë më shumë se 30-vjeçare.

Janë këto detaje, që përcillen në këtë studim dhe që, moment pas momentin, ndërtojnë mozaikun e profilit të kësaj kështjelle, që sot qëndron e heshtur në një nga gjiret më tërheqëse detare në bregdetin e Jugut, duke patur në sfond atë histori të pasur mijëravjeçare që nis prej antikitetit.

Përveç përqendrimit në qendrat urbane, guvernatori investoi edhe në rrjetet infrastrukturore të rrugëve, stacioneve automobilistike dhe instalimeve ushtarake si brenda territorit të tij, ashtu edhe përgjatë kufijve të tij.

Qeveria në Stamboll në fillim pranoi në heshtje dhe, madje, inkurajoi përpjekjet e Ali Pashës për të bashkuar një sërë mikrorajonesh nën një rend politik unifikues, të përcaktuar nga politikat e tij agresive të zgjerimit. Ky lëshim ishte pjesë e një politike më të gjerë që ia delegoi administrimin e perandorisë një numri “partnerësh” që ishin të aftë për zakonet e politikës lokale. Ngritja e ndërtesave publike që dikur kishin qenë pothuajse prerogativë ekskluzive e familjes mbretërore dhe oborrtarëve të saj, veçanërisht xhamitë e së premtës, fortifikimet dhe pallatet e guvernatorëve, tani bie në përgjegjësinë e pushtetarëve provincialë. **William Miller, “The Ionian Islands under Venetian Rule,” The English Historical Review 18/70 (Apr., 1903), 214-**

215. Also see S. Margaritis, *Crete and Ionian Islands under the Venetians (Athens: Leontiadis, 1978)*

(*) Më 1784, ai e bindi Portën, me mbështetjen e diplomatëve venecianë, që ta promovonin në mir-i miran (pasha me dy bishta, një dallim ushtarak) dhe guvernator (mutasarrıf) të rrethit të Delvines, duke ndjekur gjurmët e të parëve të tij.

Me pak fjalë, Ali Pasha vazhdoi të zgjeronte zonën e tij të ndikimit duke marrë titujt në një sërë rrethesh të tjera administrative ngjitur, duke përfshirë guvernatorin e Trikalës (Ott. Tırhala, 1786) dhe të Janinës (Ott. Yanya, 1788) si dhe pozicioni i derbendler başbuğu (Komandanti i Kalimeve Malore) në 1787. **24. Kemal Beydilli, “Tepedelenli Ali Pasa,” *İslam Ansiklopedisi* 40 (2011), 477; BOA, *Istanbul, C.AS. 29/1345 (29 Cemaziyelahir 1205 AH/ 5 March 1791 CE)*. A feë years later, Ali Pasha arranged for his son Veli Pasha to be appointed in this position, in 1792-94: BOA, *Istanbul, C.AS. 853/36500 (29 Şaban 1213 AH/ 5 February, 1799)*. It appears, however, at some point that the position reverted back to his father, as Ali Pasha is referred to as the “derbendler nezareti” in 1812: BOA, *Istanbul, C.DH. 22/1060 (10 Şevval 1227 AH/ 17 October 1812 CE)*. Ali Pasha was actually first appointed Yanya mutasarrıf in 1784, but was then removed from the position when the people of Ioannina revolted: Skiotis, “The Lion and the Phoenix,” 48.**

Ky titull i fundit kishte një rëndësi të veçantë, pasi i mundësoi Ali Pashës të vendoste njerëzit e tij për të monitoruar të gjitha qafat kryesore malore në të gjithë krahinën më të gjerë (eyalet) të Rumelisë, d.m.th. në pjesën më të madhe të Ballkanit jugor. Kështu, siç supozoi udhëtari Henri Holland, “dominimi i Ali Pashës ka ardhur, jo nga ndonjë përpjekje kalimtare revolucionari, por nga një sistem i ngadalshëm dhe këmbëngulës zgjerimi, dhe një politikë e përbërë nga kujdesi dhe veprimi, çka e ka bërë të besueshëm pretendimin për uzurpim dhe pushtim afatgjatë. **Henry Holland, *Travels in the Ionian Isles, Albania, Thessaly, Macedonia, &c. During the Years 1812-1813 (London: Longman, Hurst, Rees, Orme, and Brown, 1815), 98 Leake, *Travels in Northern Greece, IV, 151-52.****

KAPITULLI VII

Porto Palermo, arkitektura dhe Venediku

Për të analizuar kështjellën e Porto Palermos në shumëdimensionalitetin e vet, duhet të ndalemi në kronologjinë dhe analizën e të gjithë procesit të ndërtimeve fortifikuese ushtarake mbrojtëse, por jo vetëm, në territorin e vendit tonë dhe më gjerë.

Kështjella e Porto Palermos nuk mund të shkëputet dhe të trajtohet si një element apo objekt i veçuar nga konteksti historik i ndërtimeve të realizuara në shekuj, nga ai zinxhir fenomenesh dhe ndikimesh që kanë ardhur brez pas brezi, duke krijuar një traditë e cila ka lënë gjurmët e veta në planin arkitekturor, në atë të teknikës dhe stilit të ndërtimit, në objekte të ngjashme. Sepse nuk është thjesht viti apo periudha kalendarike e ndërtimit për të përcaktuar hershmërinë apo datimin e një objekti të caktuar, por janë elementët e sipërcituar që përcaktojnë karakteristikat përkatëse të këtij ndërtimi. Sepse analiza e stilit ose e teknikës së ndërtimit në muret antike, merr një vlerë të veçantë, për arsyen domethënëse që, në mungesë të dhënash të tjera më të sigurt të karakterit arkeologjik, në bazë të teknikës së mureve dhe elementeve të tjera arkitektonike, mund të përcaktohet afërsisht koha e ndërtimit të një kalaje. **[95] *Gjerak Karaiskaj, “5000 vjet fortifikime në Shqipëri”, fq.78.***

Është kjo sentencë, që na ndihmon për të analizuar tërësinë e elementëve që do të na çojnë në zbardhjen e plotë të sfondit dhe periudhës historike, kur është realizuar një objekt i caktuar, me vlera të shumëfishta, arkitekturore e historike. Prandaj dhe, kur flasim për kështjellën e Porto Palermos, ne ndalemi në mënyrë

të detajuar tek ata elementë bazë që përbëjnë strukturën e këtij objekti fortifikues, i cili, qoftë në planin gjeografik, historik, arkitekturor, përfaqëson një varg dhe dinamikë zhvillimesh të fushës, ndikimesh dhe tradite.

Këto zhvillime nisin në thellësinë e historisë, në periudhën e neolitit të vonë, 2800-2700 p.e.s., kur mendohet se datojnë edhe fortifikimet më të hershme në vendin tonë, për të vijuar me periudhën e bronzit dhe të hekurit të hershëm në vitet 1500-500 p.e.s., kur fortifikimet përshkojnë një dinamikë me karakteristika të caktuara. Për të ardhur më vonë në periudhën e pushtimit romak, kur u ndërpre për një kohë zhvillimi normal i jetës ekonomike, politike dhe kulturore i Ilirisë dhe kur rrënohet një numër i madh qytetesh të fortifikuara dhe kështjellash, veçanërisht në Epir. Për rrjedhojë, fortifikimet u kufizuan në numër qytetesh kryesore të bregdetit, si Butrinti, Apolonia, Durrësi, Lezha etj. [96] **Gjerak Karaiskaj, “5000 vjet fortifikime në Shqipëri”, fq.6**

Dhe, pas kësaj pauze historike që zgjati disa shekuj, ndërtimi i fortifikimeve në vendin tonë rifilloi në shekullin VI, që përkon me periudhën e sundimit të Perandorit Justiniani I, për të vijuar normalisht në vijimësi në atë që përkuftizohet si periudha e Mesjetës së Hershme, me karakteristika të caktuara të arkitekturës ushtarake e ndarë në dy faza respektivisht për shekujt VII-XIII dhe XIV-XV.

Ky fenomen përfaqëson një veçanti pozitive për vendin tonë, edhe në raport me vende të tjera të perëndimit, pra të Evropës Perëndimore, kur tradita e fortifikimeve ushtarake përkuftizohet me karakteristika të tjera.

Kështu, në shekujt IX-XI, në vendin tonë kishte kështjella të fuqishme me mure guri dhe qytete të mëdha të fortifikuara si Durrësi, Berati, Kanina, Lezha, Himara, ndërkohë që në Evropën Perëndimore vijonin të përdroreshin fortesa prej druri. [97] **Gjerak Karaiskaj, “5000 vjet fortifikime në Shqipëri”, fq.7.**

Ky realitet sigurisht që kushtëzohet nga një sërë faktorësh, që nuk janë objekt i këtij studimi, por që kanë një të vërtetë të përbashkët dhe që lidhet me atë realitet të kësaj periudhe, të përshkuar dhe të argumentuar nga Karaiskaj, i cili duke përvijuar këtë tablo thekson

se, mjaft elementë të fortifikimeve që u përhapën nga kryqtarët në Evropë, gjatë shekujve XII-XIII, i hasim në fortifikimet tona në një periudhë më të hershme.

Dhe, sikundër edhe në mjaft fusha të tjera, siç kishte ndodhur edhe në periudhën e pushtimit romak në shekujt II-I, p.e.s., edhe pushtimi turk u shoqërua me ndërprerjen e zhvillimit të mëtejshëm të fortifikimeve në vend, ose më saktë, e ngadalësoi atë në periudha të ndryshme, por pa e bllokuar. Ishte nevojë historike zhvillimi i këtij sektori, i cili u kushtëzua nga faktorë të ndryshëm, në kohë të ndryshme.

Disa prej këtyre faktorëve lidhen me shturjen e regjimit feudal-ushtarak në Shqipëri, që përkon me fillimin e shekullit XVII dhe që shkaktoi dobësimin e pushtetit turk dhe shturjen e administratës shtetërore. Ky fenomen u shoqërua me fuqizimin e pashallarëve vendas që kundërshtonin sundimin e Portës së Lartë dhe që zëvendësuan ndarjen administrative të sanxhaqeve. Por edhe në luftë dhe rivalitet të ashpër me njeri-tjetrin, këta sundimtarë spikatën për ndërtimin dhe fuqizimin e kalave, në qendrat e sundimit të tyre, ose të pashallëqeve përkatëse. Kjo periudhë karakterizohet nga një sërë ndërtimesh dhe fortifikimesh dhe njihet si periudha e fortifikimeve e shekujve XVIII-XIX, ku spikat emri i Ali Pashë Tepelenës, i cili ndërtoi një shtet pothuajse të pavarur me kryeqendër Janinën dhe me një territor që shtrihej në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut, në një pjesë të territorit të Greqisë dhe Maqedonisë. Në fondin e fortifikimeve që ai ndërtoi, apo rindërtoi, përfshihen rreth 15 objekte, mes të cilave edhe kështjellat dhe kalatë e Gjirokastrës, Tepelenës e Porto Palermos.

Sigurisht që çdo periudhë spikat me karakteristikat përkatëse, që e dallojnë atë nga të tjerat. Duke filluar nga periudha qytetare ilire në shekujt V-II p.e.s., për të vijuar me atë mes shekujve II-I p.e.s., që përkon me shkatërrimin e Epirit nga romakët, pas disfatës së Gentit në vitin 168 p.e.s., fortifikimet në shekujt IV-VI e.s., e emërtuar si periudha e vonë antike, që përkon me ndërtimet më të mëdha fortifikuese të kryera në periudhën e sundimit të Perandorit Justinian I (v.526-565), çka pasohet me fortifikimet e realizuara në vitet 600-1400, e emërtuar si Mesjeta e Hershme. Në këtë periudhë spikasin ndërtimet fortifikuese në Durrës me

Akropolin, ose kështjella e sipërme dhe me murin rrethues verior në afërsi të saj, ashtu sikundër kështjella në lartësinë “59”, e cila prej vitit 1243 njihet edhe nga burimet historike me emrin, “kështjella e poshtme”. Është ky objekt që do të jetë në fokusin e një analize më të detajuar, për shkak të ngjashmërive arkitekturore me kështjellën e Porto Palermos.

Në fakt, “Kështjella e poshtme” e Durrësit, shënon edhe pikënisjen e analizës së ndikimit të stilit venecian në arkitekturën e fortifikimeve në Shqipëri. Duke vlerësuar dhe analizuar në mënyrë më të detajuar këtë objekt, ne do të dimë të evidentojmë elemente të ngjashmërisë në rrjedhën e objekteve të fortifikimit të realizuara në vijimësi, në një numër të konsiderueshëm kalash dhe kështjellash në vendin tonë, të shpërndara në të gjithë territorin.

“Kështjella e poshtme” shënon nga ana tjetër ndikimin e parë të drejtpërdrejtë të stilit venecian në objektet e fortifikimit, që, së bashku me teknikën veneciane të ndërtimit “Kluazonash”, do të shfaqen të reflektuara në ndërtimet e realizuara në vijimësi në vendin tonë.

Përpara se të bëjmë një analizë më të detajuar të kësaj kështjelle, kujtojmë se prania dhe ndikimi venecian në vendin tonë, shënon një pikënisje zyrtare në vitin 1392, kur Republika e Shën Markut, mori në dorëzim Durrësin dhe, një vit më pas, Lezhën dhe mandej Shkodrën me territorin përreth, ku përfshihej kalaja e Drishtit, Danja, etj. dhe në vijim Vlorën, Kaninën, Himarën dhe Pirgun, ndonëse ndikimi në forma të tjera, duke përfshirë edhe arkitekturën, tejkalon këto limite zyrtare kohore.

Në këtë kontekst, duhet evidentuar fakti i rëndësishëm se ndërtimet mbrojtëse veneciane të shekullit XV, u përqendruan kryesisht në bregdet. Kjo, sigurisht që nuk ishte një rastësi, dhe aq më tepër një këndvështrim aksidental. Ky realitet, që ka shoqëruar të gjitha sjelljet në terren të Serenisimas, bazohen në filozofinë e kësaj Republike për të krijuar dhe ruajtur monopolin e tregtisë në rajon, veçanërisht në atë që njihet me emrin, Gjiri i Venedikut dhe më gjerë dhe po ashtu, bashkë me këtë, të siguronte mbrojtjen nga kundërshtimet dhe synimet e feudalëve vendas, të pasqyruara edhe në kryengritjet e shumta kundër sundimit venecian, të cilat u shfaqën me intensitet në fillim të shekullit XV, në Shkodër dhe

zonat përreth saj.

Prandaj dhe vetë ndërtimet veneciane reflektuan frymën e kësaj filozofie në teknikë dhe veçanërisht në stil. Ato dalloheshin në këto dy aspekte, sepse përshtateshin në të gjithë mjedisin dhe atmosferën vendase dhe reflektonin origjinalitet e qëndrueshmëri. Stili venecian erdhi si një risi, si një frymë në mjedisin shqiptar, por vazhdoi dhe u rikonceptua si një vlerë që u përvetësua nga tradita dhe praktika vendase. Ky ndikim, që i ka rrënjët në shekullin XIII-XIV, vazhdoi gjatë, i shtrirë në kohë dhe territor, për shekuj me radhë, në varësi dhe përshtatshmëri me periudhat, ndikimet dhe transformimet që pësoi fusha e fortifikimeve në vendin tonë.

Fundi i Republikës së Venedikut në vitin 1797, si pasojë e ekspansionit të Napoleon Bonapartit në Itali, nuk mund të thuhet se ishte edhe fundi i filozofisë së ndërtimeve veneciane në Shqipëri. Kjo filozofi, e trupëzuar në dhjetëra objekte fortifikimi, mbeti si vlerë dhe si realitet që përbën objekt shumë të rëndësishëm studimi dhe rivlerësimi, për shkak të rëndësisë dhe impaktit.

Duke vlerësuar dhe njohur karakteristikat themelore të stilit venecian, ne njohim dhe vlerësojmë më mirë të gjithë fashën dhe vëllimin e ndërtimeve në Shqipëri, kuptojmë dhe eksplorojmë më mirë shumëdimensionalitetin që ato përmbajnë, zbulojmë elementët që e bëjnë unik këtë stil dhe që i gjejmë të materializuara në dhjetëra e dhjetëra objekte fortifikuese të shpërndara në Shqipëri, kuptojmë më mirë historinë dhe rëndësinë e çdo objekti, studiojmë në mënyrë më të detajuar historinë e njerëzve dhe të komuniteteve, vlerësojmë e rivlerësojmë personazhe historikë, me synimin për t’u dhënë vendin që ata meritojnë, në kohën që ata jetuan dhe në morinë e ngjarjeve që udhëhoqën, apo ku ishin protagonistë e frymëzues. Në këtë gamë perceptimesh dhe analizash, ne do të mund të arrijmë të përcaktojmë më me saktësi data dhe periudha objektsh.

Prandaj dhe nuk ka sesi dhe nuk mund të vlerësojmë në tërësinë e saj, kështjellën e Porto Palermos, nëse nuk do të ndjekim dhe analizojmë të gjithë sfondin e ngjarjeve që i paraprinë asaj, në aspektin ndërtimor, arkitekturor, historik. Vetëm kështu do të jemi të saktë dhe të sigurt në atë që do të fiksojmë dhe do u përcjellim

njerëzve.

Kështjella e Porto Palermos, ka datën, apo më saktë periudhën e trupëzimit të saj, e cila nuk mund dhe nuk ka sesi të përmblihet në një ditë, apo në një shumatore ditësh, apo javësh. Ky objekt nuk lindi dhe nuk u krijua nga “asgjëja” dhe në një hapësirë apo terren bosh dhe të virgjër. Kjo kështjellë erdhi si një nevojë për të qenë e tillë, në formën që e shohim sot, kur u përputhën disa faktorë, që u materializuan në mendjen dhe vizionin e Pashait të Janinës. Por, në të vërtetë, ajo kishte ekzistuar si e tillë, në një sfond gjeografik dhe historik, shumë kohë më parë. Ishte historia e Himarës dhe popullit të këtij bregdeti, që e kishte mbrujtur këtë objekt me karakteristikat themelore të saj, ishte trashëgimia e ustallarëve të kësaj krahine, apo e mjeshtrave të tjerë vendas dhe më gjerë, që gatuan në këtë objekt, traditën dhe traditat, në frymën e kohës, ishte e gjithë ajo trashëgimi e krijuar në shekuj në Himarë dhe në të gjithë bregdetin e vendit tonë, ku stilet dhe teknikat, pasonin dhe zëvendësonin njëra-tjetrën, ku periudhat linin gjurmë dhe ndikime, ku fryma e ndërtimeve venedikase me tiparet dalluese e unike të saj, ishte bërë pjesë e kësaj trashëgimie dhe tradite. Porto Palermo është më shumë se historia e një zone, e një krahine. Ajo është vetë historia e fortifikimeve shqiptare, me një fashë mijëravjeçare, e pasuruar me elemente dhe veçanti, që ishin rrjedhoja të kohëve dhe e vizioneve njerëzore.

Tek kështjella e Porto Palermos, ne gjejmë një fashë të gjerë të objekteve të tjera të ngritura në Shqipëri në periudha paraardhëse. Gjejmë “Kështjellën e Poshtme” të Durrësit, gjejmë kalanë e Shkodrës, të Kaninës, Himarës, Kardhiqit e Peqinit, kështjellën e Vivarit dhe të Gjon Boçarit, gjejmë kështjellën e Sopotit (Borshit) dhe të Bashtovës. Mjafton të ndalemi në secilën prej tyre, me një vëzhgim të hollë e hulumtues, por edhe duke shfrytëzuar vepra e botime, për të perceptuar ngjashmëritë. Prandaj, Porto Palermo edhe sot, vazhdon të jetë objekt studimesh e eksplorimesh, ndonëse deri tani ka munguar një studim i plotë dhe i integruar për të.

Prandaj dhe për këtë objekt ka shumë pikëpyetje. Ato lidhen kryesisht me periudhën dhe qëllimin e ndërtimit të kështjellës, si dhe me rolin që luajti ajo, veçanërisht në fillim shekullin XIX.

Por, për të eksploruar në këtë atmosferë paqartësish, do të duhet të zhvendosemi në kohë, atje ku realisht i kanë rrënjët stili dhe teknika e ndërtimit të saj.

“Kështjella e Poshtme” e Durrësit, ose e njohur ndryshe me përcaktimin në lartësinë “59”, ka kaluar përmes dy periudhave kryesore të ndërtimit (siç shihet në figurën e mëposhtme) dhe ka formën gjeometrike të një katrori, me gjatësi të brinjëve prej 50 metra. Në periudhën e parë, që përkon me shek. XI-XIII, në të spikasin kullat, apo bastionet me bazë rrethore në qoshet dhe me bazë katërkëndëshe në mesin e kurtinave.

Pasi u rrënuar pothuajse krejtësisht, ajo u rindërtua në gjysmën e parë të shekullit XV, ndërkohë që Durrësi ishte nën sundimin venecian. Gjatë procesit të rindërtimit, kullat, ose bastionet me bazë rrethore, u zëvendësuan me ato me bazë tetë këndore, ndërsa kullat me bazë katër këndore, u rindërtuan sërish si të tilla. “Kjo kështjellë që ndryshon nga e sipërmja, ka patur siç duket, një karakter thjesht ushtarak, ku qëndronte pjesa kryesore e garnizonit të përhershëm të qytetit në kohë paqeje”. [98] Gjerak Karaiskaj: 5000 vjet fortifikime në Shqipëri. Fq.127




Fig. 16. Kullë poligonale në Kështjellën e Poshtme

Në ndërtimet fortifikuese në Durrës, në periudhën 600-1400, përfshihen Akropoli, ose Kështjella e Sipërme, bashkë me murin rrethues verior në afërsi të saj. Ndërsa nga zbulimet e fundit në

terren, edhe në kështjellën mbi lartësinë “59”, e cila qysh në vitin 1243 njihet nga burimet historike me emrin “Kështjella e Poshtme”. Kalaja e Durrësit ra në dorë të anzhuinëve në 1272. Më pas, Karli I, në vitin 1280, urdhëroi kryerjen e punimeve fortifikuese në Akropol....

Përveç Kështjellës së Sipërme, që ndodhej në vendin e akropolit të dikurshëm të kalasë antike, Durrësi kishte edhe një kështjellë tjetër që përmendet në dokumente me emrin “Kështjella e Poshtme”. Ajo ndodhet mbi majën e një kodre me lartësi më të ulët se e para, më pranë bregut të detit dhe mbështetet nga ana e brendshme e murit jugperëndimor të kalasë. [99] **(Gjerak Karaiskaj: 5000 vjet fortifikime në Shqipëri, fq.127**

Për të vlerësuar ngjashmëritë arkitekturore të kështjellës së Porto Palermos me ato të “Kështjellës së Poshtme” në Durrës, po bëjmë një përshkrim paksa më të detajuar të kësaj të fundit.

Në periudhën në të cilën u rindërtua, pra në gjysmën e parë të Shek. XV, kur Durrësi ishte vënë tashmë nën sundimin e Republikës së Shën Markut, “Kështjella e Poshtme”, kishte tri kulla poligonale në qoshe dhe dy të tjera ndërmjetëse katër këndore në mes tyre, ndërkohë që, në vijimësi, njëri nga këndet ku mungonte bastioni, u plotësua me një kullë gjysmë rrethore, e cila ndryshon nga të tjerat në karakteristikat bazë, pra në formë, elementet arkitektonike, si edhe në teknikën e ndërtimit. Kullat, më të larta se muret, ndaheshin në tri kate me dysheme druri, prej të cilave, ato të poshtmet shërbenin si depo, ndërkohë që, katet e dyta, që komunikonin me porta me shtegun e rojeve, konsideroheshin si mjediset kryesore, të pajisura respektivisht me tri frëngji për topa. Frëngjitë kishin planimetri në formën e një trapezi me bazën e vogël të drejtuar jashtë, të mbuluar me qemerë trungkonikë prej tullash. Në vijim, katet e treta, që shërbenin si mjedisë për rojet, ishin pajisur gjithashtu me frëngji shigjete. Për t’i bërë më rezistente kundrejt hapjes së tuneleve dhe minimit, muret e kullave mbështeteshin mbi një bazament poligonal që del jashtë tyre në formë xokoli dhe brinjët e të cilit korrespondojnë me meset e faqeve të kullës.

Ajo që duhet nënvizuar në këtë rast, lidhet me faktin se kullat me forma të rregullta poligonale, tipike të stilit venecian në ndërtimin

e kështjellave, që ishin karakteristika gjithashtu për fortifikimet e realizuara nga Ali Pashë Tepelena, fillojnë të përdoren në vendin tonë në shekullin XV, pra, në periudhën kur një pjesë e madhe e vendit tonë, veçanërisht qytetet përgjatë bregdetit, kaluan nën sundimin e Republikës së Venedikut.

Kjo qasje e njëjtë, haset në një numër objektsh fortifikuese në Shqipëri, të realizuara në kohë, periudha të ndryshme të pas shekullit XV dhe të shpërndara në një territor të gjerë. Këto ngjashmëri në elementet strukturorë arkitektonikë, janë realizuar në momentet e ndërtimit ose rindërtimit të këtyre objekteve, në kala, apo kështjella që u përkasin periudhave më të hershme, apo atyre të realizuara më vonë. Mjafton të përmendim këtu, kalatë e Rozafës, të Kaninës, Beratit e në vijim, për të vlerësuar ndikimin e stilit venecian në fortifikimet e ndërtuara në vendin tonë.

Kështu, kullat poligonale (në kalanë e Kaninës-shën.im), i përkasin një periudhe më të vonë; në to gjejmë edhe frëngji për topa. Nga forma gjeometrike dhe nga teknika e ndërtimit, këto kulla(bastione), ngjasojnë me ato të “Kështjella e poshtme”, në kalanë e Durrësit, të ndërtuara në Shek. XV... Tipare të ngjashme me Kaninën, kanë patur edhe qytete të tjera mesjetare, si Borshi (Sopoti), dhe Himara. Për më tepër, Himara përmendet si qendër e fortifikuar, prej shekullit XI, njëlloj si edhe Kanina. [71] Gjerak Karaiskaj. “5000 vjet fortifikime në Shqipëri”. Fq.141

Dhe, nëse do të vijojmë në këtë arsyetim, evidentojmë faktin tjetër, se, kullat e kalasë së Kaninës, konkretisht në atë me numër 7, spikat një kornizë dekorative, e realizuar me gurë të punuar, e njëjtë me kornizat e dy kullave veneciane në Durrës, të ndërtuara në gjysmën e dytë të shekullit XV. Nga ana tjetër, në këndvështrimin planimetrik dhe ekzistenca e ballkoneve prej druri, kullat me nr. 7 dhe 10, sipas Karaiskajt, ngjasojnë me kullat(bastionet) e “kështjellës së poshtme” të Durrësit, të ndërtuara gjatë sundimit venecian në gjysmën e parë të shekullit XV.

Ndërkohë, në kalanë e Shkodrës, elementet e arkitekturës veneciane i hasim tek “donzhon”-i (kullë e lartë, ose kryekulla-shën.im) i saj, ku ngjashmëritë nuk evidentohen dhe as nuk bazohen vetëm tek format gjeometrike, pavarësisht se ato janë thelbësore në planin që po analizojmë. I gjithë sistemi i mbrojtjes

së hyrjes (në këtë kala), komandohej nga një “donzhon” i lartë poligonal, për ndërtimin e të cilit nga venecianët, në 1468, bën fjalë edhe Barleti. [100] *Gjerak Karaiskaj. “5000 vjet fortifikime në Shqipëri”. 1981. Fq.154*

Por, veç kësaj, punimet veneciane në kalanë e Shkodrës hasen edhe tek veshja me gurë të punuar katër këndore e disa kullave të tjera dhe pjesërisht e kurtinave, për efekt përforcimi. Nga disa studiues, ngjashmëritë e kështjellës së Porto Palermos, me atë të Vivarit në Butrint, veçanërisht në aspektin e planimetrisë trekëndore, veçohen si argumente për të mbrojtur idenë e ndërtimit të njëkohshëm të tyre, në periudhën veneciane.

Prandaj dhe kjo kështjellë garnizoni (sikundër edhe Porto Palermo), është analizuar në këndvështrimin e elementëve të sipërcituar, për të evidentuar ngjashmëritë. Kështjella e Vivarit (një kështjellë garnizoni), sipas Karaiskajt, është ndërtuar në dy faza, së pari në fundin e Shek. XIII, me mure me trashësi 2.3 m, ku spikasin dy breza frëngjish; brezi i poshtëm përshkon të gjithë trashësinë e murit, ndërsa ai i sipërm, vetëm murin e parapetit. Në fazën II të ndërtimit të kësaj kështjelle, që përkon me shekullin XV, u ndërtua një kullë e stilit venecian në qoshen jugperëndimore të saj dhe për herë të parë u vunë në përdorim frëngji topash në kullë, ndërkohë që dy kullat e tjera i përkasin periudhës III të ndërtimit.



Foto 17 – Foto, Kështjella e Vivarit

Sikundër edhe shihet në fotot shoqëruese, Kështjella e Vivarit ka një planimetri në formë trekëndore, me gjatësi brinjësh 50 metra dhe me tre bastione rrethore në secilin kënd, prej të cilave njëra ka mbërritur deri sot e plotë në lartësi.




Foto 18 – Planimetria e Kështjellës së Vivarit

Përveçse dy hyrjeve të saj, në pjesët jugore dhe veriore, në kështjellë spikasin muret e ruajtura në lartësi të plotë që kurorëzohen me një parapet me lartësi 15 metra, disa kthina njëkatëshe të mbuluara me qemerë cilindrikë, ndërkohë që në mes të oborrit ndodhet një ndërtim me planimetri rrethore që ka shërbyer në periudhën turke si depo baruti, i mbuluar nga një kupolë sferike, pa dritare dhe me një portë të vogël.




Foto 19 - Kështjella trekëndore e Vivarit

Bastionet poligonale, si elementë tipikë të arkitekturës veneciane të fortifikimeve ushtarake, evidentohen në një numër të konsiderueshëm të këtyre objekteve në vendin tonë, të ndërtuara në periudha të ndryshme, pas shekullit XV, kur prania e tyre shfaqet për herë të parë në “kështjellën e poshtme”, në Durrës. Kështu, në kështjellën e Kardhiqit, një fortesë tipike garnizoni (sikundër edhe kështjella e Porto Palermos) me planimetri 5 këndore, numërohen 5 bastione, prej të cilave tre kulla janë katër këndorë dhe dy të tjera janë poligonale.



Foto 20 - Kalaja e Kardhiqit

Duhet nënvizuar se, një nga kullat poligonale, që ruhet pothuajse e plotë, ngjason dukshmërisht me kullat e kalave të Gjirokastrës dhe Tepelenës, të cilat u ndërtuan nga Ali Pasha. Në këtë kullë spikasin frëngjitë e mëdha të topave, një karakteristikë e ndërtimeve fortifikuese që përkojnë me shekujt XVIII-XIX, ndërkohë që, Apollon Baçe e cilëson këtë kështjellë të njëkohshme, duke e datuar atë në një periudhë të gjerë kohore, mes gjysmës së dytë të shekullit XII dhe gjysmës së parë të shek. XIV. [101] Apollon Baçe. “Kështjellat e Kardhiqit dhe Delvinës”, “Monumentet”, 13.1977

Por, nga ana e tij, Karaiskaj ka një mendim tjetër. Ai thotë se kështjella e Kardhiqit përmendet për herë të parë në regjistrin turk në 1431-1432 dhe periudha më e mundshme e ndërtimit të saj është gjysma e dytë e shekullit XIV, ose fillimi i shekullit XV. [102] Gjerak Karaiskaj, “5000 vjet fortifikime në Shqipëri”, fq.177

Pra, ky përcaktim përkon me periudhën kur Republika e Venedikut nisi “invazionin” në vendin tonë, duke marrë sundimin e disa qyteteve të mëdha kryesisht përgjatë bregdetit, mes të cilave, Durrësi, Lezha, Shkodra, Vlora etj. Në fakt, prania, ose më saktë, ndikimi venecian në vendin tonë, ka nisur shumë më herët, por ajo ka qenë kryesisht në fushën ekonomike.

Kujtojmë se, në vitin 1392, Venediku mori Durrësin, në vitin 1393, mori në zotërim Lezhën dhe më pas Shkodrën, me territorin përreth, me kalatë e Drishtit e Danjës dhe në vijim, Vlorën Himarën, Kaninën etj. Kullat e rregullta poligonale janë karakteristike për shekullin XV, kur ato nisën të ndërtohen, por ka edhe përjashtime në këtë drejtim. Kështu, bastionet poligonale, në kalanë e Peqinit, janë shndërruar si të tilla, gjatë rindërtimit të saj në një periudhë më të vonshme se shekulli XVI, ndoshta në shek. XVIII.




Foto 21. Kështjella e Peqinit

Në këtë rast, nuk përjashtohet mundësia që ky transformim të jetë rrjedhojë e ndikimit të mjeshtrave vendas.




Foto 22. Kullë e Shek. XVIII në kështjellën e Peqinit

Jashtë vëmendjes në analizën e ngjashmërive, sipas karakteristikave të arkitekturës veneciane dhe ndikimit të saj në ndërtimet fortifikuese në vendin tonë, nuk mund të lihet edhe kështjella e Gjon Boçarit, në afërsi të fshatit Tragjas, e cila rezultoi të jetë ndërtuar në fillim të shekullit XV, çka përkon me nisjen e periudhës së ndikimit të stilit venecian në arkitekturën e objekteve të këtij lloji në vendin tonë.




Foto 23 – Planimetria e një bastioni poligonal tipik venecian, Kështjella e Gjon Bocarit

Kjo kështjellë ka formën e një katërkëndëshi me kënde të drejta me përmasa 30 metra dhe 18 metra, me hyrjen në mesin e njërës prej brinjëve më të vogla dhe ajo që përbën edhe interesin tonë të drejtpërdrejtë, lidhet me praninë e dy bastioneve poligonale në këndet veriore dhe lindore. Hershmeria e kësaj kalaje prej shekullit XV, dëshmohej përveçse nga arkeologu Damjan Komata, të cilit i referohet edhe Gjerak Karaiskaj, për shkak të hulumtimeve të tij në këtë objekt, por edhe nga burime apo ngjarje të tjera. Kështu, kalaja e Gjon Boçarit, ose më saktë, fshati Gjonboçar përmendet nga himarjotët në letrën që ata i dërguan në vitin 1759, Careshës së Ruisë, Elisabeta Petrovna, por edhe në një ngjarje që përshkruhet nga Eqerem Vlora, në monografinë e tij, “Kalaja e Kaninës”, botuar në Romë në vitin 1961, ku ai rrëfen momentet e largimit të Rugjinës nga Kanina në vitin 1417 dhe rrugëtimin e saj drejt Korfuzit. Ajo qëndron në këtë kështjellë, përpara se të nisjet për në destinacionin që kishte zgjedhur.

Madje, në këtë monografi kemi edhe një përshkrim shumë interesant për Kaninën dhe momentet kur Komnena, e trembur nga rreziku turk, kërkon të vihet nën mburojën e mbrojtjes së Republikës së Shën Markut, duke i ofruar asaj pronat e veta, Kaninën, Himarën etj.

Ja si e përshkruan Eqerem Vlora këtë moment të historisë.

“Fitoret e Sulltan Bajezidit I (1389-1403) në suazën ballkanike, nuk lejonin më asnjë dyshim që ndonjë ditë, edhe Kalas Kaninës, do i vinte radha t’i çelte duerët pushtuesit ngadhñues Tyrk. Tue paraparë këtë fatkeqësinë që mund t’i ngjante, Komnena ngarkoj Ipeshin e Vlorës “quidam episcopus Albaniae” të shkonte në Venedik dhe t’i parashtronte Republikës së Shën Markut proponimin e shitjes së vendeve që ajo zotonte në Shqipëri. Komnena theksonte në letrën që i dërgoj Senatit, që vendet e saja “loca que sunt quator, silicet Avalona, Canina, Cimera (Himara) et turret Pirgi” i jepnin një të ardhur vjetore prej 9000 dukata ari. Këto ajo ish gati t’ia lëshonte Venedikut, po qe se i sigurohej një e ardhur prej 7000 dukata ari në Itali”.

Këto elemente na e qartësojnë më shumë atmosferën e ndikimit venecian në Shqipëri dhe veçanërisht në jugun e vendit, në Kaninë (Vlorë), Himarë etj. Ishte periudha ku Republika e

Venedikut, kishte shtrirë sundimin e vet në pjesën më të madhe të bregdetit shqiptar, bazuar në filozofinë e vet për të ruajtur monopolin e tregtisë në këtë zonë. Por ky sundim, sigurisht që shoqërohej edhe me elementët e tjerë të invazionit, sikundër ishte arkitektura, veçanërisht ajo e fortifikimeve ushtarake, që përbënte edhe një nga vlerat më të spikatura që venecianët e eksportuan edhe në vendin tonë. Këtu përfshihet edhe kështjella e veçantë e Bashtovës, e vetmja në vendin tone e ndërtuar në fushë.



Foto 24 – Kështjella Bashtovë

Kështjellën e Bashtovës e hasim për herë të parë si objekt i fortifikuar, në një hartë të vitit 1521, nga Piri Reiz, si pjesë e një manuali që u shërbente detarëve për nevoja praktike dhe orientimi. Kështjella emërtohej fillimisht, Pastova, sipas transkriptimit të bërë nga turqishtja në gjermanisht prej H. Mzikut.

Sipas GJ. Karaiskaj, kështjella e Bashtovës ka një karakter të theksuar fortese garnizoni, që presupozon një fuqi të madhe ushtarake të poseduesit. Aty pasqyrohen të rejat më të fundit në pikëpamje ushtarake, të influencuara nga fortifikimet e Evropës Perëndimore që kishin arritur në këtë periudhë një shkallë të lartë.

Origjina e ndërtimit të këtij objekti lidhet me dy opsione. Bashtova mund të jetë ndërtuar nga anzhuinët nga fundi i shek. XIII, kur ata bënë edhe ndërtime të tjera ushtarake në Shqipëri, ose nga venecianët, çka mund të jetë edhe opsioni më i saktë.

Periudha e ndërtimit përfshihet në hapësirën kohore mes vitit 1467, deri në pushtimin e Shkodrës më 1478 ose të Durrësit, nga sanxhakbeu i Elbasanit, në vitin 1501.

Për këtë dëshmojnë edhe disa karakteristika teknike ndërtimore. Kjo, sepse, ndërsa kulla të tilla me kurriz të hapur si të Bashtovës e kanë origjinën në Itali ku lindën vetëm në shek. XIV, dhe në Ballkan nga mesi i shek. XV, frëngjitë e topave filluan të duken në bazat e kullave dhe të mureve, diku nga çereku i fundit i shekullit në fjalë.

Ky realitet përforcohet edhe nga pohimet e udhëtarit turk, Çelebiut, i cili thotë se kështjella u ndërtua prej venecianëve.

Por, ndryshe nga fortifikimet e tjera veneciane, të ndërtuara gjatë fundit të shek. XIV dhe fillimit të shek. XV, siç janë për shembull, kullat e rrumbullakëta në Durrës, kështjella e Butrintit dhe fortifikimet në Shkodër, në Bashtovë nuk është respektuar kriteri estetik, por gjithçka është realizuar në funksion të rritjes së efektivitetit të mbrojtjes.

Kemi sjellë deri tani mjaft shembuj fortifikimesh, ku hasen dukshmërisht elementë të arkitekturës veneciane. Mund të vazhdojmë edhe më tej, qoftë edhe thjesht për të zgjeruar gjeografinë e këtij ndikimi, që shtrihet gjerësisht në kohë e hapësirë, duke shtuar fjala vjen, kështjellën e Libohovës, ku evidentojmë praninë e elementëve të kësaj arkitekture, skundër janë kullat, apo bastionet poligonale. Në këtë kështjellë të ndërtuar nga Ali Pasha, ndodhen 3 kulla poligonale.




Foto 24 – Pamja nga lart e Kështjellës së Libohovës

Po ashtu, këto elemente i hasim edhe në kalanë e Gjirokastrës, ku numërohen 7 kulla poligonale dhe trapezoide, apo në kalanë e ngjashme më të, të Tepelenës, ku spikasin 3 kulla poligonale. Duke patur parasysh se këto dy objekte fortifikuese mjaft të njohura, janë rindërtuar nga Ali Pashë Tepelena, gjatë sundimit të tij dhe në funksion të synimeve që kishte për krijimin e një shteti të pavarur nga Porta e Lartë, të cilin pothuajse e realizoi.

Prandaj dhe, duke u nisur nga ky realitet, është bërë një përgjithësim i karakteristikave të fortifikimeve të periudhës së shekujve XVIII-XIX, ku vendin më të rëndësishëm e zënë ato të iniciuara dhe të realizuara nga Ali Pashë Tepelena në pashallëkun e sunduar prej tij, atë të Janinës.

Në ndërtimet fortifikuese të kësaj periudhe, spikasin format

e rregullta të planimetrive, lartësia e barabartë e kullave dhe e kurtinave dhe rënia e tyre me pjerrësi në anën e jashtme, duke nisur nga pjesa e sipërme, format poligonale të bastioneve. Po ashtu në këto ndërtimeve, konstatohet heqja dorë përfundimisht nga përdorimi i bedenave dhe krijimi i parapetit për frëngji. Këto zëvendësohen me frëngji për topa të kalibrave të mëdhenj. Në këto karakteristika, përfshihen gjithashtu edhe krijimi i shumë kthinave të mbuluara, që shfrytëzohen si depo municioni, ushqimesh etj.

Dhe këtu, në këto tipare, përfshihet sigurisht edhe kështjella e Porto Palermos, si një nga objektet më të mirë realizuara (nëse do të pranojmë pa asnjë dyshim, faktin se ajo është ndërtuar në fillim të shekullit XIX), nga Ali Pashë Tepelena.



Foto 25 – Fragment nga Kështjella e Porto Palermos

Por, këto karakteristika, na nxisin në idenë për t'u kthyer mbrapa në kohë, në një nga objektet fortifikuese më të shkëlqyera të ndërtuara në Shqipëri, gjatë periudhës së sundimit turk. Bëhet fjalë për Kalanë e Vlorës, një nga arritjet më të mira të arkitekturës otomane. Një analizë, qoftë edhe vertikale e këtij objekti, na çon në përfundime shumë të rëndësishme, në një lloj paralelizmi me objektin e studimit tonë.

Kjo kala, që njihet ndryshe me emërtimin “Kalaja e Skelës” (për

shkak të zonës ku ishte ndërtuar, në Skelë të Vlorës), përbën nga ana tjetër një përjashtim nga objekte të tjera fortifikuese të ndërtuara nga turqit, për shkak të veçantive dhe standardeve të larta arkitekturore. Në këtë arsyetim, dy janë faktorët që vlerësohen se kanë ndikuar në këtë arritje; fakti që ajo është projektuar nga një arkitekt me origjinë shqiptare (arkitekt Sinani) dhe në procesin e ndërtimit të saj, janë përfshirë masivisht mjeshtrit vendas. **[103] Gjerak Karaiskaj. “5000 vjet fortifikime në Shqipëri”. Fq.219**

Por, nuk është standardi i këtij objekti (i rrënuar në vitin 1905, me një vendim të parisë së kohës, për t’i përdorur gurët e kalasë për ndërtimin e rrugës Vlorë-Skelë!!!), që përbën arsyen e analizës së veçantë. Është arkitektura që e bën atë të veçantë dhe që, në kundërshti me realitetin apo filozofinë e ndërtimeve në hapësirën territoriale të Perandorisë, na vjen me një profil tërësisht tjetër. Është ky profil që shërben edhe si një lloj argumenti për atë që po studiojmë, pra kështjellën e Porto Palermos. Për këtë, na vjen në ndihmë përshkrimi i kalasë së Vlorës, e cila kishte një planimetri të rregullt 8 këndore, me kulla poligonale nëpër qoshet e saj, me brinjë përkatëse me gjatësi 90 metra, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 3.5 ha, me trashësi dhe lartësi të mureve përkatësisht 5.6 dhe 15 metra.

Në këtë kala spikat “donzhoni” (kryekulla) me 7 kate, një kullë cilindrike masive që mbizotëronte mbi të gjitha ndërtimet e tjera me lartësinë e saj dhe që mbulohej nga një kupolë e veshur me plumb, e vendosur mbi një tambur të ulët poligonal. Edhe në këtë kullë, spikasnin frëngjitë për topat. Kryekulla, e ngjashme me Kullën e Bardhë në Selanik, atë të Rumeli-Hisarit, apo kullën qendrore të “Kastel de Mare”-Modon, përfaqëson një nga arritjet më të spikatura të arkitekturës osmane!! Por, këtu nis edhe paradoksi.

Tek kjo kala, një objekt me karakter ushtarak, një kështjellë garnizoni, e iniciuar nga Sulltan Sulejmani, i cili, gjatë vizitës në Vlorë në vitin 1531, urdhëroi ndërtimin e saj, nuk mund të konsiderohet se janë respektuar linjat, parimet, apo rregullat e arkitekturës osmane të kohës. Përkundrazi. Kjo duket qartë në përshkrimin e mësipërm të kësaj kalaje, ku veçojmë karakteristikat më të dukshme, elementët poligonale, ose më

saktë planimetrinë poligonale të 8 bastioneve të kalasë, si edhe të tamburit, gjithashtu poligonal, ku mbështetet kupola prej plumbi e kryekullës (“donzhonit”).

Nisur nga këto dhe detaje të tjera arkitektonikë, kjo kala ka zgjuar interesin e mjaft studiuesve, që, jo vetëm e cilësojnë atë një përjashtim në raport me objektet e tjera fortifikuese të kohës, pa vlera të veçanta, por shkojnë edhe më tej. Kështu, Gjerak Karaiskaj, në botimin e vet “5000 vjet fortifikime në Shqipëri”, na sjell dy përcaktime, të mjaftueshme këto për të krijuar një perceptim ndryshe për kalanë e Vlorës. Së pari, ai citon dietarin J.G. Hahn, që shprehet: “Kjo kala e tradhton arkitektin turk” dhe më tej sjell shembullin e një vizitori tjetër, pa e identifikuar atë, i cili, sipas Karaiskajt, “...e quan atë (kalanë e Vlorës-shën.im), “kala veneciane”. **[104] Gjerak Karaiskaj. “5000 vjet fortifikime në Shqipëri”. Fq.219.**

Këto karakteristika të kalasë së Vlorës, dhe veçanërisht perifrimit e mësipërme rreth saj, na e qartësojnë më tepër përcaktimin për kështjellën e Porto Palermos, nga George Scriven, ku, mes të tjerash, ai e cilëson atë veneciane. Scriven, një ish-ushtarak i lartë amerikan, njëkohësisht ish-atashe ushtarak i SHBA në Turqi, në 1897, vëzhgoi nga afër në terren konfliktin greko turk, çka i dha mundësinë atij të njihje mjaft aspekte të realitetit të asaj kohe. Scriven udhëtoi edhe në vendin tonë. Nga këto udhëtime ai publikoi mjaft materiale në revistat më të njohura të kohës. Përshtypjet dhe vëzhgimet e një udhëtimi në Rivierën Shqiptare, ai i përmbloodhi në një botim të realizuar në prill të vitit 1921, ku, mes faqeve përmendet edhe kështjella e Porto Palermos, si pjesë e sfondit natyror dhe historik, me atë karakteristikë që përbën edhe thelbin e studimit tonë, ndikimin e stilit venecian në arkitekturën e këtij objekti.

“Jo shumë përtej, vendkalimi i vogël i Porto Palermos me kujtimet e tij romake dhe kështjellën veneciane, madje tani duke ngritur armë moderne kundër sulmit, paraqet një përzierje të çuditshme të luftërave të të gjitha moshave”

SOME HIGHWAYS OF ALBANIA AND A FORGOTTEN RIVIERA

By GEORGE P. SCRIVEN
Brigadier General, U. S. A.

Of the minor events of the war whose effects have proved constructive rather than destructive one of the most striking is the opening up of certain difficult and little-known regions. In such regions as were the theater of operations there were established military bases and depots, seaports and centers of business, railroads and roads, many of which will remain as permanent aids to commerce and will open the way for more extensive intercourse in the future.

Of the more conspicuous works of this kind may be instanced the vitalization of southern Albania under Allied occupation. Valona from a forgotten hamlet grew into an important seaport and military base; and from it were pushed out the splendid razor roads north, east, and south that now unite erstwhile isolated back country and seacoast.

The first roads built by the Italians in Albania were intended, of course, for army purposes; but even those were constructed, in the Italian fashion, to last through the years, and they will remain long after the soldier has gone his way. Others, less obviously military, were designed to open the land to its own inhabitants—to make intercourse practicable and perhaps later to invite the outlander and his trade. Of these new highways there are two that deserve especially the notice of the stranger interested in this fascinating land. They pass through scenes of rare beauty and attraction, among an interesting people, and by places which, though vividly historic and filled with an Old World charm, have been lost for centuries among their unapproachable hills.



FIG. 1—Sketch map showing the highways of Southern Albania. Scale approximately 1:1,000,000.

[105] (Scriven, George P. (Prill 1921). *Some highways of Albania and a forgotten Riviera*. *Geographical Review. American Geographical Society*. 11 (2): 198–206. doi: 10.2307/207325. JSTOR 207325

Dhe, më tej. “Në Vuno, Luani i Shën Markut buzëqesh vrazhdë nga shkëmbinjtë; përtej gënjeshtrës zbuluan gurët e një rruge romake; dhe aty pranë është hyrja ku trimet e Cezarit u ankoruan për të ulur legjionet e tij në rrugën e tyre për të takuar Pompeun në fushën e Pharsalia. [106] (Scriven, George P. (Prill 1921). *Some highways of Albania and a forgotten Riviera*”, *Geographical Review. American Geographical Society*. 11 (2): 198–206. doi: 10.2307/207325. JSTOR 207325

Scriven, që e vizitoi Rivierën Shqiptare në fund të shekullit XIX, pra në vitin 1897, na përcjell një informacion mjaft të rëndësishëm qoftë edhe përmes këtyre dy paragrafëve, ndërkohë që shkrimi i mësipërm, i publikuar në një prej botimeve më të rëndësishme të kohës, evokon një vëllim edhe më të madh detajesh që na vijnë përmes përshkrimit, analizës dhe evokimit të fakteve e ngjarjeve të historisë së shkruar.

Scriven, një njohës i thellë i literaturës ushtarake, një nga ekspertët më të mirë të kohës, është vlerësuar si referencë për mjaft studiues, duke përfshirë edhe ata të historisë. Konkluzionet e tij i gjejmë të pasqyruara në studime të shumta, sikundër ka ndodhur edhe me përshkrimet e tij dhe analizat historike për bregdetin e Himarës, pavarësisht se, data e botimit të tij në prill të

vitit 1921, në një nga revistat më të zë të kohës, është vlerësuar gabimisht si një moment kur kështjella e Porto Palermos, është cilësuar si një objekt venecian.

Në fakt, konteksti në të cilin përfshihet konkluzioni i Scriven për këtë objekt fortifikimi, është i gjerë dhe lë shteg për interpretime, qoftë për teknikën dhe stilin arkitektonik të kështjellës, ashtu edhe për periudhën e ndërtimit të saj. Në një sfond ku ndikimi venecian është i prekshëm, Scriven na sjell edhe një detaj të rëndësishëm, që shkon në mbështetje të konkluzionit për objektin e studimit tonë, emblemën e Republikës së Shën Markut (Luanin e Shën Markut), e cila, siç e kemi përmendur në një nga kapitujt paraardhës, ruhet sot në një nga muzetë më të njohura të kryeqytetit, si dëshmi e një periudhe të mbushur me ngjarje, me interesa, ndikime dhe rivalitete.

Konkluzionet e mësipërme të studiuesit të shquar amerikan, krijojnë mundësinë që edhe interpretimet tona për kohëndërtimin dhe stilin arkitekturor e arkitektonik të kështjellës së Porto Palermo, të rrjedhin paralelisht në të dy kahet. Brenda një arsytimi të tillë, kohëndërtimi na shfaqet si një dimension që nuk ka kohë, ose më saktë që, simbolikisht i përket një fashe të gjerë kohore. Sepse edhe argumentet na vijnë në të dy linjat; në atë që e lidh ndërtimin e kështjellës me sundimin e Ali Pashë Tepelenës, ashtu si edhe me opsionin tjetër të ekzistencës së saj, në një periudhë të mëhershme. Dhe një përzierje mes këtyre dy alternativave, që do të thotë se Porto Palermo, është ndërtuar, apo rindërtuar mbi bazën e një strukture ekzistuese, është po aq e fortë, sa edhe dy të parat.

Varianti i parë dhe kryesor që ka dominuar dhe që e daton kështjellën e Porto Palermos, në fillim të shekullit XIX, bazohet tek historiografia zyrtare e deritanishme dhe, kryesisht tek shënimet e udhëtarëve dhe personazheve të njohur të diplomacisë evropiane, të atashuar pranë oborrit të Janinës. Konkretisht, shënimet e udhëtimit të François Pouqueville, konsull i Francës në Janinë dhe William Martin Leake, i dërguar i Britanisë së Madhe pranë Ali Pashës, përbëjnë dy nga burimet kryesore, që janë marrë si referencë, për të datuar këtë kështjellë në fillim të shekullit XIX, ose më saktësisht në vitin 1804.




Foto 26 – Botimi i F.H.C.L. Pouqueville, “Voyage de la Grece”

Në fakt, ky vit përcaktohet si rrjedhojë e konkluzioneve nga shënimet e F.H.C.L. Pouqueville dhe William Martin Leake, në botimet e tyre, respektive, “Voyage de la Grece” and William Martin Leake Travels in Northern Greece (London 1835), volume 1, pp. 1-105, 363-384.

Madje, për të qenë më të saktë, përkrahimi që bëri Leake (*) në veprën e vet të sipërcituar, ka shërbyer si një nga burimet për të vlerësuar vitin 1804, si moment ndërtimi.

***Shkrimtari, topografi dhe diplomati britanik William Martin Leake (1777-1860) mori trajnimin e tij në Akademinë Ushtarake Mbretërore në Woolwich (Londër). Më 1799, ai u dërgua në Kostandinopojë dhe shërbeu me ushtrinë osmane në Egjipt. Në shtator 1804, Leake u kthye në Perandorinë Osmane, këtë herë për të ndihmuar provincat e Turqisë Evropiane për t’u mbrojtur kundër sulmeve franceze nga Italia. Në lidhje me këtë, atij iu dhanë udhëzime që të vëzhgonte bregdetin e Shqipërisë dhe Morenë (Peloponez) dhe t’i kushtonte vëmendje të veçantë gjeografisë së përgjithshme të Greqisë. Me interes të madh për**

studimet shqiptare është vepra e tij me katër vëllime “Udhëtime në Greqinë e Veriut”, Londër 1835, ribotuar në Amsterdam më 1967, e cila regjistron udhëtimet e tij të gjera jo vetëm në Greqinë e vërtetë, por edhe në Shqipërinë e Jugut. Udhëtimi i parë i Leake në rajon ishte në dhjetor 1804 kur ai udhëtoi nëpër Shqipërinë e Jugut, duke përshkruar Vlorën, Kaninën, Sarandën, Delvinën, Gjirokastrën, Tepelenën, Kardhiqin, Finiqin, Himarën dhe Ksamilin. Udhëtimi i dytë i madh i Shqipërisë, në qershor 1805, e çoi nga Maqedonia në Devoll, Korçë, Voskopojë, Berat, Apolloni, Këlcyrë dhe Përmet. Ai vazhdoi turneun në Shqipëri dhe Greqi deri në shkurt 1807.

Por, në një mënyrë më të drejtpërdrejtë për këtë qëllim, vlerësohet një tjetër dokument që ka si protagonist sërish William Martin Leake. Në një raport të muajit gusht të vitit 1805, William Martin Leake shkruan se: “Ali Pasha ka ndërtuar kohët e fundit një kështjellë në pikën e gadishullit të Porto Palermos”. [107] Në një raport të datës 1805, William Martin Leake shkruan se “Ali Pasha ka ndërtuar kohët e fundit një kështjellë në pikën e gadishullit” të Porto Palermos: Arkivi Kombëtar, Londër, FO 78/57, Gazetat e Kapiten Leake (1803-1807). *In a report dated August 1805, William Martin Leake writes that “Ali Pasha has lately built a castle on the point of the peninsula” of Porto Palermo: National Archives, London, FO 78/57, Papers of Captain Leake (1803-1807)*

[108] THE ARCHITECTURAL TRANSFORMATION OF THE OTTOMAN PROVINCES UNDER TEPEDELENLI ALI PASHA, 1788-1822 M. Emily Neumeier A DISSERTATION in History of Art Presented to the Faculties of the University of Pennsylvania in Partial Fulfillment of the Requirements for the Degree of Doctor of Philosophy 2016

Porto Palermo, një port dhe pikë strategjike në këtë pjesë të bregdetit, është vlerësuar prej Ali Pashë Tepelenës si një argument i rëndësishëm në marrëdhëniet e tij me britanikët, apo faktorë të tjerë ndërkombëtarë. Porto Palermo përshkruhet nga Leake, François Pouqueville apo të tjerë udhëtarë që e kanë vizituar, me detajet përkatëse. Veç kështjellës garnizon, janë fiksuar edhe struktura të tjera ndërtimi, mes të cilave Kisha e Shën Kollit,

ndërtesa e doganës, një banesë etj. “Leake vëren në rrëfimin e tij të udhëtimit praninë e një shtëpie, me shumë mundësi për komandantin e fortesës si dhe kishën në Porto Palermo: Kisha mund të gjendet aktualisht në lindje të kalasë, ku dalja shkëmbore në gji takohet me rrugën moderne”, shkruan Emily Neumeier (14), duke ju referuar përshkrimin të William Martin Leake, në veprën e tij, *Travels in Northern Greece* (London 1835), volume 1, pp.1-105, 363-384. **[109] William Martin Leake Travels in Northern Greece (London 1835), volume 1, pp.1-105, 363-384.** Nga ana tjetër, pothuajse e njëjtë është edhe tabloja që sjell Pouquevillë në rrëfimin e vet në botim. Një mjedis ku spikat edhe më shumë karakteri ushtarak i këtij objekti, si një kështjellë garnizoni. Një garnizon, me një numër të kufizuar efektivësh, që e kanë shndërruar mjedisin përreth në një mundësi për të siguruar jetesën e përditshme.

“E afruar nga një shteg i ngushtë nga bregu, kalaja qëndron e izoluar dhe kishte vetëm pajisjet bazë për t’i shërbyer nevojave imediate të garnizonit të vendosur aty. Një nga këto pajisje ishte një kishë, e cila mund të shihet edhe sot, një veçori që na kujton se ushtarët nën komandën e Ali Pashës ishin të besimit mysliman dhe të krishterë” **[110] THE ARCHITECTURAL TRANSFORMATION OF THE OTTOMAN PROVINCES UNDER TEPEDELENLI ALI PASHA, 1788-1822 M. Emily Neumeier A DISSERTATION in History of Art Presented to the Faculties of the University of Pennsylvania in Partial Fulfillment of the Requirements for the Degree of Doctor of Philosophy 2016**

Dhe në një mjedis të tillë, Neumeier, përforcon edhe më tej atë që përbën edhe versionin zyrtar të datimit të kështjellës, duke u shprehur... “Pikërisht këtu, në këtë dalje Ali Pasha ndërtoi kështjellën e tij, një strukturë trekëndore me tre bastione poligonale”.

Duke cituar Leake në disa raste për këtë objekt të rrejtë të fortifikimeve ushtarake bregdetare, ai pranon edhe faktin e sipërcituar se, kjo kështjellë u ndërtua nga Ali Pasha në vitin 1804. Diplomati britanik që mbërriti dhjetor të këtij viti në jug të vendit, në atë që përbën udhëtimin e tij të pasqyruar në botimin “Travels

in Northern Greece”, e gjen këtë kështjellë të ndërtuar, ashtu siç e gjen dhe e përshkruan edhe kolegu i tij diplomat francez, François Pouqueville, që mbërriti këtu dy vjet më pas.

Por vëllimi dokumentar për këtë periudhë, na sjell një detaj që vlerësohet në një këndvështrim tjetër. Bëhet fjalë për vitin 1803, momenti që shënon edhe pikënisjen e vendosjes së komunikimeve mes Pashait të Janinës dhe Britanisë së Madhe dhe që, jo pak herë, përcaktohet si momenti kur ai i ofroi Kurorës, Porto Palermon. Në këtë vit, përmes një letre ai ju drejtua ambasadorit britanik në Stamboll, William Hamilton, duke i propozuar një bashkëpunim të ngushtë kundër Francës dhe duke i paraqitur edhe një listë ofertash, shoqëruar kjo me kërkesën për ngritjen e një konsullate të përhershme britanike në Janinë.

*Kontakti i parë i Ali Pashës me britanikët daton në vitin 1803, kur ai iu drejtua ambasadorit britanik në Stamboll, William Hamilton, me një letër që propozonte bashkëpunim të ngushtë kundër Francës duke paraqitur një listë ofertash, si dhe ngritjen e një konsullate të përhershme britanike në Janinë. . Në letrën e vet, Ali Pasha deklaronte se ishte i gatshëm t’i jepte të gjithë mbështetjen Britanisë në lidhje me furnizime nga Shqipëria si lëndë drusore, ujë, ushqim, bagëti, kuaj dhe ofrimin e porteve të tij në Adriatik për përdorim ushtarak ose tregtar. Ai gjithashtu u ofroi britanikëve të drejtën për të zbarkuar dhe stacionuar trupat e tyre përgjatë bregdetit për të garnizuar çdo kështjellë, ose për të ndërtuar fortifikime. Përveç kësaj ai shprehu synimin e tij për të nxitur tregtinë midis Shqipërisë dhe Britanisë së Madhe. Ai u ofroi privilegje të veçanta tregtarëve britanikë, duke përfshirë lejen e prerjes së lëndës drusore në territoret e tij, në çfarëdo sasive që ata kërkonin. [111] (Demir. I (December 2007). **Tepedenli Ali Pasha and the west: A history of his relations with France and Great Britain 1798-1820. Master Thesis. Department of History, Bilkent University, Ankara. Faqe 77)***

Në këtë letër me një fashë të gjerë ofertash, spikat ajo që lidhet me dislokimin e trupave britanike përgjatë bregdetit dhe shfrytëzimin për këtë qëllim të kështjellave që ndodheshin në të. A përfshihej Porto Palermo në këtë ofertë të Ali Pashës? Sigurisht që po. Por, në këtë rast, pikëpyetja lidhet me faktin nëse në vitin 1803

ekzistonte kështjella në fjalë, apo një strukturë tjetër e ngjashme, apo e përafërt me të? Nëse përgjigja do të ishte “po”, atëherë kjo do të rrëzonte versionin e ndërtimit të kështjellës së Porto Palermos në vitin 1804. Por, duke mos përjashtuar edhe faktin se, në momentin kur u dërgua letra, ky objekt ishte në proces ndërtimi.

Por, këtu na vjen në ndihmë edhe një detaj, që e sjell Pouqueville në një nga përshkrimet e tij kur ai flet për konfliktin dhe përplasjet e vazhdueshme të Ali Pashë Tepelenës me Himarën, me himarjotët. Një nga betejat e tij të para me banorët luftarakë të kësaj krahine është zhvilluar në Porto Palermo, ku ai zbarkoi me 3 mijë asqerë, por, ku la në fushën e betejës qindra të vrarë. Konsulli i Francës në Janinë ka fiksuar masakrën e jashtëzakonshme të Ali Pashës mbi popullsinë e dy prej fshatrave të njohura të bregdetit, Nivicë Bubar dhe Shën Vasilit. Ekspedita dhe masakra e Ali Pashës në Nivicë Bubar dhe Shën Vasil në 23 prill 1798, që u shoqërua me masakrimin e 6000 banorëve, ishte edhe arsyeja e nënshtrimit të një pjese të bregdetit dhe që e përshkruan edhe Pouquevillë në shënimet e tij. “Terrori që shkaktoi kasaphana, solli më pas nënshtrimin e të gjithë fshatrave të Bregdetit deri në Portin Panorm, të cilin satrapi e fortifikoi”, shkruan Pouqueville. [112] *Minella Gjoni, “Bregdeti dhe Ali Pashë Tepelena”, Punimet e Konferencës III Panhimariote. Fq.233.*

Në këtë përshkrim, Pouqueville përmend termin fortifikim të Porto Palermos. Dhe, duke u rikthyer në komunikimin me Ambasadorin britanik, padyshim që, Ali Pashë Tepelena, nuk mund të bënte një ofertë dislokimi trupash ushtarake në këtë port, nëse nuk do të ekzistonin struktura përkatëse, qofshin këto edhe fortifikime të një natyre tjetër nga ajo e një kështjelle.

Kjo përforcohet edhe më tepër, duke u njohur me fakte e detaje historike që na vijnë nga e shkuara e largët, veçanërisht ajo e periudhës në fjalë kur, ky rajon u shndërrua në një sheshbeteje të vërtetë mes fuqive më të mëdha të kohës, Britani e Madhe, Francë, Rusi, Perandoria Otomane. Dhe, kur, Ali Pasha, në funksion të idesë dhe projektit të vet, për një shtet të pavarur nga Porta e Lartë, u mundua të përfitonte nga kjo situatë dhe nga ky kuadër interesash. Fillimisht ai mbështeti Francën, por më pas, zhvilloi

përpjekje për një aleancë efektive dhe me interesa të ndërsjella me Britaninë e Madhe, e cila nga ana e vet, në një dinamikë zhvillimesh u përpoq të përfitonte por, pa çuar deri në fund një skemë konkrete mbështetjeje përkundrejt ofertës së Pashait të Janinës. Paqja e Tilsit, në 1807, ndryshoi mjaft gjëra dhe futi marrëdhëniet e Britanisë me Ali Pashën, në një rrjedhë disi të rikonceptuar dhe më të qartë, ku britanikët u shfaqën të interesuar për vazhdimësinë e Perandorisë Otomane dhe jo shpërbërjen e saj, ndërkohë që u ridimensionua edhe orientimi ndaj Revolucionit Grek dhe potencialisht përpjekjeve të tij për pavarësi.

Në përputhje me këtë lloj politike, britanikët i prezantuan projektet e ashtuquajtura të tyre rreth Shqipërisë, Seid Ahmetit (Seyid Ahmet Efendiut, agjentit të Akredituar në Londër të Ali Pashë Tepelenës-shën.im), duke i përmendur mundësinë e kësaj mbretërie(një skemë mbretërie e pavarur Greko-Shqiptare, ofruar si mundësi nga britanikët në bisedimet me Ali Pashën-shën.im), nën sundimin e Ali Pashës, ku të gjithë ishujt Jonianë do t'i dhuroheshin të paktën me një kusht, duke i siguruar Britanisë disa privilegje tregtare dhe përdorimin e portit të Panormos (Porto Palermos-shën.im). [113] *(Beggally John (1937), “Ali Pasha and Great Britain. Oxford University Press”. fq.68.*

Në këtë paragraf nënkuptohet rëndësia që kishte për britanikët një port si ai i Porto Palermos dhe përdorimi i tij për nevoja tregtare, apo edhe ushtarake. Një analizë e zakonshme të bën të kuptosh se një port i tillë, nuk kishte sesi të ishte thjesht natyror, pa një strukturë të caktuar portuale, ku minimalisht të mund të realizoheshin operacionet më të nevojshme të përpunimit të mallrave.

Në një kontekst të tillë, duket se, versioni i ekzistencës edhe të një strukture paraardhëse të kësaj kështjelle, fiton edhe më shumë terren. Kjo na bën t'i rikthehemi me një këndvështrim të tillë, sërish të shkuarës së hershme dhe të qëmtojmë përmes dokumenteve që na vijnë prej studiuesve të ndryshëm, për të qartësuar atë, për të hedhur më shumë dritë në atë se çfarë përfaqësonte Porto Palermo. Në këtë kontekst, veçojmë një përcaktim mjaft të rëndësishëm të historianit dhe studiuesit të njohur, Ilir Parangoni, i cili duke ju

referuar një projekti të turqve në shekullin XVII, përmend edhe Porto Palermon.

Në dhjetor 1662, në burimet e shkruara del se turqit po planifikonin të rindërtonin kështjellën e shkatërruar në Butrint, së bashku me fortesat e Porto Palermos, Lëkurësit sipër Santi Quaranta. [114] *Richard Hodges. Eternal Butrint. A World Heritage Site in Albania. (London: Periplus Publishing, 2006), Ilir Parangoni. Periudha Veneto-Osmane. Gjiri i Sarandës gjatë periudhës Veneto-osmane (shek. XV-XVIII) / Saranda Bay during the Ottoman-Venetian period (15th-18th centuries) [article. Iliria. Vol 40/ 2016/. 293*

Një pohim i tillë i jep Porto Palermon vlerën dhe dimensionin e vazhdimësisë, krijon në perceptimin e sotëm, idenë e asaj që është përmendur nga jo pak studiues, të rindërtimit të kështjellës në formën që është sot, mbi bazën e një strukture ekzistuese të ngjashme, ose të përafërt.

“Ndoshta ekzistonte tashmë një fortifikim venecian”, thotë Scriven në botimin e vet,”. (Scriven, George P. (Prill 1921). Some highways of Albania and a forgotten Riviera, *Geographical Review American Geographical Society*. 11 (2): 198–206. doi: 10.2307/207325. JSTOR 207325, duke iu referuar ngjashmërisë së kështjellës së Porto Palermos me atë trekëndore të Vivarit, të ndërtuar nga venecianët në vitet 1500.

“Thuhet se në vitin 1662 turqit modernizuan një kështjellë ekzistuese në Porto Palermo”, nënvizon **Richard Hodges, në “Eternal Butrint. A World Heritage Site in Albania. (London: Periplus Publishing, 2006”**, ose “...ndërtuan një kështjellë të re në Porto Palermo”, shton më tej ai, duke argumentuar se, objekti kryesisht shërbente për të kontrolluar popullsinë vendase në zonën e madhe të Himarës, e cila ishte revoltuar vazhdimisht kundër turqve.

(Në fakt, një nga kryengritjet apo revoltat më të njohura të himarjotëve kundër sundimit dhe synimeve të Ali Pashë Tepelenës, ishte ajo e vitit 1800, e cila është pasqyruar apo përmendur nga William Martin Leake, Pouqueville etj.). Dhe në këtë linjë, vjen edhe Pëllumb Xhufi në veprën e vet, “Arbërit e Jonit”, ku i kushton një hapësirë të konsiderueshme Porto Palermon.

Një nga konkluzionet e tij më të rëndësishme për këtë kështjellë, është ajo e vazhdimësisë. Pra, Xhufi nuk përjashton mundësinë që kësaj kështjelle t’i ketë paraprirë një strukturë e mëparshme, e cila shërbente për të njëjtin qëllim, si një objekt i fortifikuar.

“Por, mund të hamendësohet se kësaj kështjelle i ka para ekzistuar, qoftë edhe në një formë embrionale, ndonjë konstruksion i ngjashëm. Siç dihet, kështjella fqinje e Sopotit, u rindërtua nga turqit aty nga mesi i shekullit XVI. Mund të mendohet se edhe porti i Porto Palermos u fortifikua në një moment kulmor pushteti të turqve mbi Himarën, siç ishte periudha pas Luftës së Kandias (1669). [115] *Pëllumb Xhufi. Arbërit e Jonit.Tiranë 2017. Onufri. Fq.155-156. ASV Senato Mar, r.34(1558-1559), fol.13’: 15 prill 1558*

Ky përcaktim, që pason citimet e mëparshme, përforcon përfundimin e rëndësishëm të vazhdimësisë së këtij porti të rëndësishëm në bregdetin e Jugut. Ai ka qenë i tillë, prej periudhave të hershme, duke shërbyer si një nyje e rëndësishme në rrugët detare në rajon, por edhe si një pikë me rëndësi strategjike për zonën.

Prandaj dhe porti, gjiri detar dhe vetë kështjella, vlerësohen si elemente të shtrira në kohë, ku çdo periudhë ka lënë dhe fiksuar gjurmët përkatëse, mes të cilave përfshihen edhe fortifikimet, apo struktura të tjera të ngjashme, të cilat janë finalizuar me këtë kështjellë, ku shohim periudha, ndikime, arkitektura, të cilat spikasin me elementët përkatës. Dhe, mes tyre, sigurisht dhe qoftë edhe për arsyt që kemi përmendur në vijimësi, përfshihet dhe spikat ndikimi i arkitekturës veneciane, e cila na vjen përmes traditës së ushtruar nga mjeshtrit vendas, të cilët përveçse përvojës së kultivuar në një mjedis dhe sfond të ndikimit venecian, nuk përjashtohet të kenë respektuar edhe veçori arkitekturore të një strukture ekzistuese veneciane.

Në këtë hapësirë historike, nuk mund të flasim për boshllëk arkitekturor. Në përputhje dhe përshtatje me periudha të caktuara, këtu hasim struktura e realitete që dëshmojnë për ekzistencën e fazave të caktuara të jetës e të zhvillimit, të aktivitetit portual dhe të raporteve me faktorë rajonalë e më gjerë. Ka patur struktura fortifikuese dhe portuale, sipas standardeve të kohëve kur janë

ndërtuar dhe kanë qenë në funksion. Panormus, apo Porto Palermo, si një liman i madh, ndoshta më i rëndësishmi në vijën bregdetare nga Vlora në Sarandë, nuk mund të kishte një profil të tillë vetëm si një port natyror. Natyra i ka dhuruar avantazhet, njeriu i ka dhënë madhështinë. **“Gjiri kontrollohej nga fortifikime që nga parahistoria”**, përcakton arkeologu Jano Koçi, në **“Kaonia dhe Himara në antikitet”, në Konferenca III Panhimariote, 2011.** Për t’i dhënë vazhdimësi kohore këtij përfundimi, ai sjell edhe ekzistencën e fortifikimeve të Kukumit dhe Almeridhës, si pjesë e sfondit të fortifikuar të këtij gjiri dhe limani. “Në Bronzin e hershëm dhe të mesëm fortifikimet ishin vendosur mbi kodra të ulëta 100 m, përreth gjireve, sipër rreth Panormës, fortifikimet Kukum dhe Almeridha, e cila referohet si kala greke e ndërtuar dhe shkatërruar në vitin 1281”.

“Në fortifikimin e Kukumit, ku ndodhet në majën e kodrës midis gjireve Panorma (Porto Palermo), dhe Skaloma, muri me gjatësi 160 metra qarkon majën e sheshtë të kodrës dhe përfshin një sipërfaqe rrethore me diametër 50 metra. Muri ka trashësi 2.5 metra dhe në anën e jashtme ruhet deri në lartësinë prej rreth 1 metër”, saktëson arkeologu, Jano Koçi. **[116] Jano Koçi-Parahistoria e Himarës –Konferenca III Panhimariote. 2011. Fq. 48-68**

Përfundimet e mësipërme, marrin vlera edhe më të rëndësishme me rëndësinë që ka Porto Palermo. Prandaj dhe për t’u dhënë një sfond edhe më të plotë këtyre përcaktimeve, ai shtyhet në kohë dhe evidenton rëndësinë dhe rolin që ka patur Panormus (Porto Palermo), qysh në lashtësi. *“Gjiri i lashtë Panormus (Porto Palermo), port i rëndësishëm i Jonit, përfshinte limanet e Armeridhës, në përfundim, Porto Palermon, si dhe Shën Kollin. Na bankinën e limanit të Armeridhës, mund të ankorohen anije të tonazheve të mëdha. Gjatë punimeve për ndërtimin e portit gjatë shekullit XX, në fundin e detit u gjetën amfora dhe enë qeramike, të cilat dëshmojnë përdorimin e tij që nga lashtësia deri në mesjetë”*.

Madje, më tej, duke cituar Strabonin, ai e vlerëson Porto Palermon, si limanin më të rëndësishëm në bregdetin e jugut. “Straboni, (shek. I), e radhit Onhezmin pas limanit të madh Panormus”,

saktëson arkeologu, Jano Koçi. **[117] Jano Koçi. Kaonia dhe Himara në antikitet. Konferenca III Panhimariote, 2011.**

Sfondi i mësipërm historik, shërben si një provë, si një argument për atë përfundim të rëndësishëm se, kështjella e Porto Palermos, përpara se të jetë vepër e një momenti historik, është produkt i një trashëgimie historike disadimensionale. Argumentet e sjella në këtë studim, e bëjnë të prekshëm këtë fakt, i japin formë.

Kështjella e Ali Pashës ka vetëm emrin të tillë. Ajo vjen si pjesë e një historie mijëravjeçare, e cila ka lënë gjurmë në çdo detaj të saj. Është historia e popullsisë së Himarës, e Bregdetit të Jugut, që, në sinergji me realitete fqinje, rajonale e më gjerë, ka përcjellë dhe marrë kulturë, ka eksportuar dhe importuar jetë e mentalitete, duke krijuar dhe kultivuar vlera që tejkalojnë kufijtë gjeografikë. Pjesë e këtyre vlerave është edhe trashëgimia që ka në thelb ndikimin venecian, si produkt i natyrshëm i një bashkëjetese të gjatë më shumë se katër shekulle.

Prandaj dhe kur bëjmë analizën e kështjellës së Porto Palermos, eksplorojmë në ato detaje që na çojnë në përfundime. Rreth gjysma e kështjellave bregdetare për të cilat Ali Pasha mund të merrte përgjegjësinë e drejtpërdrejtë ishin në fakt riparime të rëndësishme të kështjellave të mëparshme, thotë M. Emily Neumeier i Universitetit të Pensilvanisë. **[118] THE ARCHITECTURAL TRANSFORMATION OF THE OTTOMAN PROVINCES UNDER TEPEDELENLI ALI PASHA, 1788-1822 M. Emily Neumeier A DISSERTATION in History of Art Presented to the Faculties of the University of Pennsylvania in Partial Fulfillment of the Requirements for the Degree of Doctor of Philosophy 2016**

Sipas tij, nga vetë natyra e saj, arkitektura ushtarake është shpesh një palimpsest kompleks, që grumbullohet shtresë pas shtrese riparimesh dhe ndërhyrjesh që funksionojnë për të mbajtur një strukturë të caktuar të qëndrueshme dhe në hap me përparimet më të fundit në teknologjinë e luftës.

Është e arsyeshme që, shumë vepra ushtarake, në rastin tonë fortifikime, do të vendoseshin në majë të vendeve të mëparshme nisur nga arsyeja e thjeshtë se, parametrat natyrorë si, topografia, aksesi, linjat dhe hapësira e shikimit, etj. luajnë një rol të madh në

përcaktimin e vendndodhjes më strategjike për një kështjellë, aq më shumë për një kështjellë garnizoni. Prandaj dhe në një zonë bregdetare si deti Jon, ku territoret shpesh ndërronin zotërim mes aktorëve të ndryshëm politikë, ose fuqive të ndryshme, është shpesh e pamundur për historianët e arkitekturës, ose arkeologët, të klasifikojnë vendet sipas një ontologjie të caktuar të shënuesve kohorë ose dinastikë.

Prandaj dhe, shumë fortifikime në këtë rajon mund të kuptohen njëjloj si “venedikase” dhe “osmane”. Kur diskutohet për arkitekturën ushtarake osmane në përgjithësi, dhe veçanërisht për atë që nga shekulli i tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë, studiuesit i kushtojnë vëmendje të veçantë fazave të strukturave, pasi shumica e fortifikimeve nga kjo periudhë dhe më vonë, janë përmirësime ose përtëritje të veprave të mëparshme ushtarake. Neumeier, që në disertacionin e tij ka hulumtuar dhe eksploruar në arkiva osmane, arrin në përfundimin se, “fatkeqësisht, arkivat osmane mund të jenë jashtëzakonisht të padobishëm në këtë drejtim”. Kjo, sepse, sipas tij, shpesh është e vështirë të dallosh natyrën dhe shtrirjen e punimeve të riparimit ose ndërtimit në bazë të dokumenteve. Kështu, fjalët që lidhen me aktivitetet e ndërtimit si “inşa” dhe “bina”, që të dyja përkthehen si “ndërtim”, mund të jenë mjaft të paqarta. Po kështu, kuptimi i termit “tamirat”, i përkthyer zakonisht si “riparim”, mund të ndryshojë diku nga pastrimi i ulluqeve të shiut deri te prishja dhe rindërtimi i plotë i një ndërtese.

Nisur nga këto, Neumeier arrin në përfundimin se, çdo studim analitik i shtrirjes së ndërhyrjeve ushtarake të Ali Pashës në bregdetin e Epirit, nuk mund të mbështetet vetëm në dëshmitë e informacionit arkivor dhe rrëfimeve të udhëtarëve, prandaj dhe, ndërsa ofrojnë një mori informacionesh, këto burime janë ndonjëherë të paqarta dhe të pasakta

Pavarësisht se janë të shtrira në një hapësirë të madhe gjeografike, si dhe në një periudhë prej rreth pesëmbëdhjetë vjet, kështjellat e ndërtuara gjatë sundimit të Ali Pashës kanë ngjashmëri në aspektin e shkallës dhe teknikave të muraturës. Ndërkohë, shumica e fortifikimeve të ndërtuara nën qeverisjen e Ali Pashës mund të karakterizohen kryesisht nga bastionet e tyre të spikatura

poligonale. Një detaj, që na vjen prej shembullit të përmendur më lart, në Kështjellën e Poshtme në Durrës, të ndërtuar gjatë periudhës së sundimit venecian.

Prandaj dhe në shënimet e Pouqueville, lidhur me masakrën e Ali Pashë Tepelenës në fshatrat Nivicë Bubar dhe Shën Vasil, në 1798, ku ai përdor termin “fortifikim”, për Porto Palermon, interpretimi mund të jetë më i gjerë. Krahas variantit të ndërtimit të kështjellës, mund të pranohej, ndonëse me një probabilitet më të vogël edhe varianti i përforcimit, apo rindërtimit të saj mbi bazën e strukturave ekzistuese, çka pranohet nga burimet e përmendura në vijim të këtij studimi.

“Në këtë gjë të bukur, mbi një kodër të vogël, të rrethuar nga të tri anët me ujë, ndodhet një kala mesjetare, ndërtuar në kohën e Ali Pashë Tepelenës. Në sipërfaqen e kodrës, tek-tuk, takohen fragmente qeramike të kohës antike. Sipas burimeve të autorëve antikë, vendi mbi të cilin ngrihet kalaja lokalizohet me limanin e lashtë Panormi. (Straboni VII, 58, Prolemeu III 13,2)”, thotë Dhimosten Budina. **[119] Dhimosten Budina Raport i vitit 1963 A.S.A. Harta arkeologjike e bregdetit Jon dhe e pellgut të Delvinës fq. 282, Iliria, 1971, 1, pp.275-342**

“Ndoshta ekzistonte tashmë një fortifikim venecian, i cili u ndërtua në të njëjtën kohë me atë në Butrint përpara shfaqjes së sistemit bastionar në ndërtimin e kalasë”, nënvizon George P. Scriven. **[120] George P. Scriven. Some Highways of Albania and a forgotten Riviera. American Geographical Society (Hrsg); Geographical Review.Nr.2, 1921, 198-206**

“Thuhet se në vitin 1662 turqit modernizuan një kështjellë ekzistuese, ose ndërtuan një kështjellë të re në Porto Palermo”, shprehet Richard Hodges. **[121] Richard Hodges. Eternal Butrint. A UNESCO World heritage site in Albania. General Penne UK Ltd, London 2006. 191.** Një përcaktim në fakt, që është i njëjtë me atë të Ilir Parangonit, të cituar në paragrafët e mësipërm, në vijim të këtij studimi.

Dhe, në këtë vazhdë përcaktimesh, nënvizimesh, pohimesh dhe analizash, vjen edhe një herë përcaktimi për kështjellën e Skelës, e ndërtuar në shekullin XVI, gjatë pushtimit turk, e cila përvijohet si një objekt ku janë tejkaluar rregullat e arkitekturës osmane dhe

ku ndihet dukshëm ndikimi venecian. E shprehur në një mënyrë më të drejtpërdrejtë, ajo ngjason shumë me një kështjellë të tipit venecian.

Në finalizim të kësaj analize, dilema duket se hyn në një rrugë zgjidhjeje. Kështjella e Porto Palermos, që na vjen në formën që e shohim sot, pothuajse e padëmtuar, si pjesë e fortifikimeve ushtarake të ndërtuara nga Ali Pasha, mbart në vetvete histori dhe struktura të mëparshme, rregulla dhe trashëgimi ndërtimore, stile arkitekturore, ku dominon ndikimi venecian.

Kjo kështjellë nuk “lindi” në një shesh të zbrazur dhe nga asgjëja, nuk u ngrit në një vakum. Argumentet e sjella më sipër, në çdo rresht dhe paragraf të këtij studimi, janë të mjaftueshme për të pretenduar të kundërtën.

KAPITULLI VIII

Porto Palermo pas vitit 1822 dhe në vijim

Por, çfarë ndodhi më pas me Porto Palermon? A e ruajti ajo shkëlqimin e periudhave paraardhëse, veçanërisht atë të sundimit të Ali Pashë Tepelenës? Në fakt, mungon një material dokumentar i mirëfilltë për të përshkruar atmosferën e dekadave që pasuan vitin 1822, pas ekzekutimit të Ali Pashë Tepelenës dhe shembjes së Pashallëkut të Janinës.

Pavarësisht kësaj, ajo që dihet me saktësi, është fakti që, Porto Palermo, e humbi shkëlqimin e dikurshëm. Aktiviteti portual në këtë liman, dikur mjaft i rëndësishëm, ra, për shumë arsye e faktorë, njeri prej të cilëve lidhet me ridimensionimin e rëndësisë së rajonit, si epiqendër e interesave të fuqive të mëdha të kohës; Britanisë së Madhe, Francës, Ruisë dhe Perandorisë Otomane. Po ashtu, humbi edhe roli i Porto Palermos si pikë e eksportit të produkteve dhe mallrave në drejtim të Korfuzit, dikur nën sundimin venecian deri në vitin 1797. Dhe, veç këtyre, shembja e Pashallëkut të Janinës, ndryshoi edhe raportin e Portës së Lartë me krahinën e Himarës, dikur objekt i drejtpërdrejtë i interesave për sundim nga Ali Pashë Tepelena.

Marrëdhëniet e Perandorisë Otomane me Himarën dhe himarjotët, e humbën intensitetin konfliktual që i dominonte, veçanërisht në periudhën kur Ali Pasha synoi dhe u përpoq ta nënshtronte popullsinë e saj me forcën e armëve dhe masakrat e pashembullta.

Por, gjithsesi, kështjella mbeti një pikë strategjike, për shkak të pozicionit të saj dhe e tillë qëndroi deri vonë. Qoftë nën sundimin turk, por edhe më pas, gjatë Luftës së Parë Botërore, ajo u

vlerësua si një objekt me vlera në aspektin ushtarak. Dhe, kjo, ndoshta ndikoi që kjo strukturë fortifikuese, të vijë pothuajse e padëmtuar deri në ditët e sotme. Mungesa e një dokumentacioni të mirëfilltë, na detyron t'i drejtohem interpretimit të elementëve dokumentarë që hasen herë-herë në arkiva të ndryshme.

Mes tyre, George P. Scriven, mbetet njeri prej tyre. Scriven, që e vizitoi Rivierën Shqiptare në fund të shekullit XIX, pra në vitin 1897, ndërkohë që ndoqi nga afër konfliktin greko-turk si atashe ushtarak në Ambasadën e SHBA në Turqi, na përcjell një informacion mjaft të rëndësishëm qoftë edhe përmes një paragrafi, ndërkohë që shkrimi i tij i publikuar në një prej botimeve më të rëndësishme të kohës, evokon një vëllim edhe më të madh detajesh që na vijnë përmes përshkrimit, analizës dhe evokimit të fakteve e ngjarjeve të historisë së shkruar.

Scriven, një njohës i thellë i literaturës ushtarake, një nga ekspertët më të mirë të kohës, është vlerësuar si referencë për mjaft studiues, duke përfshirë edhe ata të historisë. Konkluzionet e tij i gjejmë të pasqyruara në studime të shumta, sikundër ka ndodhur edhe me përshkrimet e tij dhe analizat historike për bregdetin e Himarës.

*“Jo shumë përtej, vendkalimi i vogël i Porto Palermos me kujtimet e tij romake dhe kështjellën veneciane, madje tani duke ngritur armë moderne kundër sulmit, paraqet një përzierje të çuditshme të luftërave të të gjitha moshave....”.[122] Scriven, George P. (Prill 1921). *Some highways of Albania and a forgotten Riviera*. *Geographical Review. American Geographical Society. 11 (2): 198–206. doi: 10.2307/207325. JSTOR 207325**

Këtu, në këtë paragraf, shfaqet dhe ajo që ka ndodhur me këtë objekt të fortifikuar. Vëzhgimi i ushtarakut, evidenton një fakt të rëndësishëm, praninë e armëve moderne kundër sulmit në këtë kështjellë, çka do të thotë se, ajo nuk e kishte humbur shkëlqimin në aspektin strategjik. Përkundër tablosë së dikurshme të përshkruar nga Pouqueville dhe William Martin Leak, kur në këtë kështjellë ishin vendosur një numër i paktë topash, tashmë situata dukej ndryshe. Kështjella dhe garnizoni, ishin pajisur me armë të kohës, “moderne”, sikundër i cilëson një ushtarak i kalibrit të Scriven. Kjo do të thotë se, turqit e vlerësonin atë si një aset ushtarak strategjik në përballimin e çdo sulmi të mundshëm që mund të kërcënonte

territorin e Perandorisë. Dhe, të mos harrojmë se bëhet fjalë për një moment shumë të veçantë, prag shekullin XX, kur Perandoria Turke po përballej me faktorë kundërshtues brenda hapësirës së saj dhe me një realitet ndërkombëtar që kërcënonte ekzistencën. Dhe, të mos harrojmë, tashmë, përballë ishte përvijuar një realitet i ri gjeopolitik, shteti i pavarur i Greqisë, me ambicie dhe synime territoriale.

Ishte momenti kur konflikti greko-turk ishte futur në një rrjedhë të ashpër, gjë që përputhet edhe me kohën kur këtë zonë e vizitoi Scriven, që na sjell tablonë e mësipërme në përshkrimin e vet, që mbetet ndër burimet e pakta, për të na përvijuar, qoftë edhe indirekt, një pamje të asaj çfarë ndodhte në atë kohë me Porto Palermon kështjellë, por jo me Porto Palermon liman. Porto Palermo, një pikë ushtarake, një kështjellë që mbante brenda mureve të saj një garnizon ushtarak, të pajisur me armatime të kohës, për të përballuar çdo kërcënim të mundshëm nga faktorë të afërt, apo më të largët. Por, nuk shohim një Porto Palermo, me një strukturë doganore, si ajo që përshkruajnë Pouqueville dhe Leak, pothuajse një shekull para këtij momenti, në një liman me aktivitetet portual.

Dhe më tej, kemi sërish një boshllëk dokumentar për këtë kështjellë, por që nuk do të zgjasë shumë. Ishte Lufta e Parë Botërore, që riafirmoi rëndësinë strategjike ushtarake të kësaj pike dhe njëkohësisht struktura të fortifikuar ushtarake.



Foto 27 – Pamje e Kështjellës së Porto Palermos referuar periudhës së zhvillimeve ushtarake

Ishte viti 1916, kur Porto Palermo hyri në hartën e zhvillimeve ushtarake në terren. “Në 10 gusht 1916, forcat ushtarake italiane zbarkojnë në gjirin historik të Panormit, d.m.th. në Porto Palermo. Ambasadori Italian në Athinë, Bosdari, në takim me Kryeministrin e Greqisë, Aleksandër Zaimi, në 13 gusht zbarkimin në fjalë e justifikoi gjoja që, “brigjet e Himarës dhe gjiri i Panormit, të mos bëhen strehë të nëndetëseve gjermane dhe austriake”. [123] **Dr. Artan Gjika, Prof.dr. Priamo Bollano.** *“Himara gjatë luftërave ballkanike dhe në vitet e Luftës së Parë Botërore”.*

Mjafton ky pasazh për të perceptuar rëndësinë që kishte Porto Palermo, në pikëpamje të strategjisë ushtarake. Trupat pushtuese italiane, u dislokuan në këtë gji, duke shfrytëzuar edhe kështjellën e Porto Palermos edhe si një mundësi për të parandaluar një sulm nga trupat e marinës gjermane dhe austriake, sikundër del nga dokumenti i mësipërm. Ato e mbajtën këtë mjedis të pushtuar deri në verën e vitit 1920, kur u larguan së bashku me trupat e tjera të pushtimit, si pasojë e kryengritjes popullore në atë që u emërtua Lufta e Vlorës.

Në fakt, ky është momenti që shënon edhe ndryshimin e destinacionit të kësaj kështjelle, e cila do të përdorej më pas si vend internimi e burgosjeje për kundërshtarët politikë të regjimeve që do të pasonin. Ky realitet, evidentohet nga jeta dhe aktiviteti publik i një personaliteti të njohur të letrave shqipe, njëkohësisht protagonist i zhvillimeve revolucionare në Shqipërinë e shekullit XX, shkrimtarit dhe disidentit, Petro Marko. Në muajin shkurt të vitit 1937, gjatë sundimit të Mbretit Zog, ai internohet në Porto Palermo, pas një gjyqi politik të zhvilluar në Tiranë, çka pohohet prej tij, në veprën e vet “Intervistë me vetveten”.

“Në Porto Palermo nuk më mbajtën shumë kohë, vetëm dy javë. Më hoqën që andej dhe më shpunë në Llogara. Këtë e bënë se mos arratisesha nga Porto Palermoja, pasi njihja shumë fshatarë dhe detarë. Në Llogara, më dhanë një barakë dërrasash”. [124] **Petro Marko: Intervistë me vetveten. Fq.155**

Pas vitit 1939, në Porto Palermo u dislokuan trupa ushtarake italiane.



Foto 28 – Pamja jugperëndimore e kështjellës së Porto Palermos

Por, paralelisht me këtë, Porto Palermo u përdor edhe si një kamp përqendrimi për luftëtarët e rezistencës antifashiste. Në këto vite të pushtimit, Porto Palermo përmendet për disa ngjarje. Mes tyre, veçohet ajo që lidhet me një operacion të gjerë të forcave të Divizionit italian “Peruxhia”, e dislokuar në Grehot të Gjirokastrës. Operacioni në fjalë, që nisi në 16 prill të vitit 1943, u shtri në zonën e Kuçit, ku ndodhej edhe Komanda e Zonës së Parë Operative Vlorë-Gjirokastër, si dhe Komanda e Qarkut. Në përpjekje të asgjësimit të bazave të Luftës Antifashiste Na-Çl, krahas ekzekutimit të 3 banorëve, fashistët arrestuan edhe 20 burra të tjerë nga ky fshat, të cilët u internuan në kampin e Porto Palermos.

Në të njëjtin vit, veçse në vjeshtë, Porto Palermo përmendet edhe për një tjetër ngjarje të rëndë. Pas kapitullimit të Italisë fashiste në 8 shtator të vitit 1943 dhe pushtimit të Korfuzit në 24 shtator, trupat gjermane hynë në Sarandë, duke u shtrirë në jug të vendit. Një nga objektivat e para të trupave gjermane të pushtimit, ishte kapja dhe asgjësimi i trupave italiane të Divizionit “Peruxhia”,

një pjesë prej të cilave ishin bashkuar me forcat partizane dhe një pjesë tjetër gjeti strehim tek familjet në disa fshatra.

Divizioni u vendos në Sarandë, në përpjekje të imbarkimit në anijet që do të mundësonin riatdhesimin në Itali. Operacioni i imbarkimit u realizua pjesërisht për shkak të pranisë së trupave gjermane dhe për këtë arsye, pjesa e mbetur tentoi të mbërrinte në Porto Palermo, në pritje të ankorimit të mjeteve të tjera lundruese që priteshin nga Italia. Por, në Porto Palermo, u regjistrua një nga masakrat më të rënda të gjermanëve, ndaj ish-aleatëve të tyre. Dhjetëra ushtarë oficerë u ekzekutuan, ashtu sikundër ishte bërë më parë edhe me vende të tjera.

Edhe pas përfundimit të Luftës, pra, pas vitit 1944, Porto Palermo u shfrytëzua si një vend internimi e burgosjeje për kundërshtarët e regjimit.




Foto 29 – Portali kujto.al i dedikuar historisë së persekutimit dhe të internuarve në regjimin diktatorial komunist

Në vitet 1940, në të u internuan, apo u burgosën në katakombet e kështjellës, rreth 200 persona nga të gjitha moshat, burra, gra e fëmijë, një pjesë prej të cilëve, kishin familjarë apo të afërm në arrati. Ky kamp u mbyll në vitin 1950, pas një incidenti me një anije italiane, që rrezikonte të mbytej në këtë zonë. Autoritetet e vlerësuan këtë ngjarje si një rrezik, duke transferuar të internuarit

dhe të burgosurit në mjedise, kampe e vende të tjera. Pas këtij momenti, Porto Palermo, shërbeu për nevoja të ushtrisë.

Me fillimin e punimeve për ndërtimin e Bazës Ushtarake Detare, Porto Palermo u rivlerësua për pozicionin dhe rëndësinë strategjike, çka shënon një rikthim në vlerat e spikatura të këtij gjiri dhe të kësaj kështjellë, për të cilat përmendet në shekuj.

Prej fundit të viteve '60-të të shekullit të kaluar, u devijua edhe rruga kombëtare Vlorë-Sarandë, duke e izoluar tërësisht këtë vend me vlera të jashtëzakonshme historike e natyrore. Ajo u vu plotësisht në funksion të nevojave ushtarake.

KAPITULLI VIII

Kështjella e Porto Palermos, është studiuar shumë pak. Mungojnë botime të mirëfillta, apo të plota për këtë objekt me një histori mjaft interesante, apo për vetë gjirin detar ku ndodhet ishulli i dikurshëm në të cilin, u ndërtua, ose u rindërtua kështjella. Për të nuk ka një analizë të gjerë të profilit arkitekturor, sikundër ka për objekte të njohura të fortifikimit.

Profili i saj i selektuar na vjen vetëm përmes studiuesve të huaj, diplomatë e udhëtarë, por edhe historianë e arkitektë, për të cilët, Ali Pasha dhe filozofia e trashëgimia e tij disadimensionale, kanë shfaqur dhe shfaqin në vijimësi interes. Emra të shquar si Pouqueville, William Martin Leake, mbeten pikë reference dhe burim informacioni për këtë objekt, për historinë e tij.

Por, pavarësisht këtyre dëshmimeve me vlerë, informacioni për kështjellën e Porto Palermos, nuk arrin të hedhë dritë plotësisht në origjinën e saj, tek fakti nëse ajo ishte thjesht një ndërtim i ri, apo ishte rindërtim i një fortese, apo strukturave të ngjashme pararendëse, apo ekzistuese.

Ajo vlerësohet gjithashtu, si një argument në zinxhirin e synimeve të Ali Pashës, për të zgjeruar dhe konsoliduar zotërimet e tij, në raport me rivalët dhe pashallëqet e tjera në planin lokal, por, po aq edhe në raport me Portën e Lartë dhe më gjerë, synimet e fuqive të mëdha të kohës, Francës e Britanisë, interesat e të cilave në rajon u ridimensionuan pas shembjes së Republikës së Venedikut në vitin 1797.

Historia e Porto Palermos, nuk mund të veçohet nga ajo e Himarës,

e gjithë vijës bregdetare nga Vlora në Sarandë, e Shqipërisë dhe nga tabloja e zhvillimeve në një shtrirje shumë më të gjerë gjeografike. Nuk mund të vlerësohet e shkëputur nga ndikime të periudhave dhe interesave më shumë se rajonale, të cilat kanë patur si objekt dhe destinacion vendin tone dhe këtë pjesë të bregdetit, që vlerësohet me rëndësi strategjike, ekonomike e ushtarake.

Ptolemeu e kualifikon Panormën e titujve të qytetit dhe portit. Straboni e cilëson atë “një port i madh, që ndodhet në mes të maleve Ceraunies”. Ceraunia është vendi që supozohet për t’u treguar nga Circe në udhëzimet e saj drejtuar Ulksit, ku ai duhej të gjente Aornosin atje, për të thirrur hijen e Tiresias, për t’u konsultuar me të në lidhje me procedurat e tij përfundimtare.

Zbulimet arkeologjike, në Armeridhë, ku u gjet qeramikë e periudhës së bronzit, përforcojnë më tej tezën se, Porto Palermo, ose Panorma e lashtë, ridimensionohet në shtrirjen kohore, duke u shtyrë në prehistori, dikur një port dhe si një hapësirë më e gjerë e plotësuar me elementë të tjerë, sikundër është një qendër e fortifikuar për të mbrojtur këtë port të madh dhe të rëndësishëm natyror.

Straboni, (shek. I), e radhit Onhezmin pas limanit të madh Panormus, ndërkohë që, kërkimet arkeologjike nënujore, ndonëse selektive, përcaktojnë se, Porto Palermo, ka funksionuar si një nga portet më të rëndësishme në rajon, prej lashtësisë dhe aktiviteti portual është i pranishëm në të gjitha periudhat, nga prehistoria, deri në ato moderne, në fillim të shekullit XIX, kur ajo vlerësohet si një pikë e avancuar e Pashallëkut të Janinës, nën sundimin e Ali Pashës, si pjesë e strategjisë së tij për ekspansion terriore dhe zgjerim.

Gjiri i lashtë Panormus (Porto Palermo), përcaktohet gjithashtu si port i rëndësishëm i Jonit, ku, sipas gojëdhënës popullore, gjeti strehim Odiseja i Homerit, si edhe gjiri i Spilesë me shpellën ku Odiseja me shokët përjetuan peripecitë me ciklopin Polifem.

Në Bronzin e hershëm dhe të mesëm, fortifikimet ishin vendosur mbi kodra të ulëta 100 m, përreth gjireve, sipër rreth Panormës, fortifikimet Kukum dhe Almeridha.

Porto Palermo, ka qenë aty, një gji natyror dhe një port i rëndësishëm, pjesë e rrugëve detare të lundrimit për një periudhë mijëra vjeçare.

Prandaj dhe Porto Palermo, Panorma e antikitetit dhe e prehistorisë, ka përcjellë deri vonë dimensionet e një qendre, që i tejkalon ato të një porti, aq më shumë natyror.

Në vijimësinë e vet, ajo është pjesë e historisë së Himarës, e cila në lashtësi ishte vendi i Kaonëve, fis i rëndësishëm i Epirit, nga më të rëndësishmit krahas mollosëve dhe thesprotëve. Sipas gjeografëve Pseudo-Skylaksi shek. VI p.e.s., (Gjeographica, libri VII, 7), kaonët banonin nëpër katunde në bregdetin e Akrokeraunëve, ku lundrimi mbante gjysmë dite dhe ndodhej limani i madh-Panormus. Gjiri i lashtë Panormus ("Panormus", që do të thotë port me ujëra të thella, -gjithmonë të qeta, port i rëndësishëm i Jonit), përfshinte limanet e Armeridhës, në perëndim, Porto Palermon, si dhe Shën Kollin.

Pushtimi Osman është një histori kryengritjesh të himarjotëve, të cilët e kanë parë Perëndimin, si faktorin dhe rrugën mbështetëse për të realizuar aspiratën e lirisë. Mes tyre, spikat Republika e Venedikut. Historia e Himarës, në një pjesë të konsiderueshme të saj, është e lidhur me atë të Republikës së Venedikut. Këto dy realitete historike, kanë qenë bashkudhëtare për rreth 4 shekuj, në një rrugë plot sfida e të papritura, të ngërthyer nga faktorë të ndryshëm, rajonalë e më gjerë. ***Pikënisja e kësaj "bashkëjetese" historike, nis prej vitit 1386, kur, venecianët u bënë faktikisht zotër të Korfuzit, ku qëndruan deri në 1797, kur, kjo republikë shënoi fundin e ekzistencës, pas ekspansionit të Napoleon Bonapartit në Itali dhe Traktatit të Kampio Formios.*** Ka qenë një bashkëjetesë, apo një bashkëudhëtim i vështirë me parashikime dhe të papritura, me përfitime të dyanshme, ose edhe me kundërshti, rrjedhojë e interesave reciproke dhe e ndërthurjes së tyre me ato të faktorëve të tjerë.

Dhe këtë raport shumëshekullor, që shtyhet edhe më tej se fundshekulli XIV, pra viti 1386, duhet të shohim në dy dimensione, në dy segmente; atë të marrëdhënieve mes këtyre dy realiteteve dhe të impaktit që ka lënë ky raport, në aspekte të

ndryshme jetës, të përditshmërisë dhe më gjerë, në mentalitetin dhe stilin arkitekturor, në simbole dhe simbolika. Dhe, kur flasim për Venedikun, nuk duhet të limitohemi vetëm tek kjo republikë, sepse në raportin e ndërsjellët me të, duhet të përfshijmë edhe faktorë të tjerë, që, për arsye rivalitetesh, kanë qenë pjesë aktive e zhvillimeve në rajon dhe në bregdetin e Shqipërisë së Jugut, në Himarë. Këtu është fjala për Mbretërinë e Napolit, prania e të cilës në bregdetin shqiptar, ka qenë e spikatur.

Bashkëpunimi mes Republikës së Venedikut dhe Himarjotëve u ngjiti edhe në nivelin ushtarak, duke u sjellë si palë ndërluftuese dhe duke patur një kundërshtar të përbashkët; turqit osmanë. Prania dhe mbështetja e Venedikut në aspiratën perëndimore të himarjotëve, duhet parë edhe si motiv nxitës në disa prej kryengritjeve të shumta të kësaj krahine, kundër Perandorisë Otomane. Në këtë këndvështrim duhen vlerësuar kryengritjet në vitet 1537, 1554-1556, apo kryengritja tjetër e Himarë-Kurveleshit në 1565 ku **luftëtarët shqiptarë, veç flamujve me simbolet e tyre, mbanin edhe flamurin venecian me simbolin e Luanit të Shën Markut.**

George P. Scriven, në shënimet e veta, të botuara në vitin 1921, e cilëson kështjellën e Porto Palermos **si një objekt venecian.**

Ajo ndodhet në një pikë dominuese të bregdetit të Jugut, si dëshmi e një periudhe shkëlqimi, si një provë e rëndësisë dhe vendit të veçantë që ka zënë në historinë shumëshekullore ky rajon, por edhe si një argument i vizionit dhe ambicieve të Ali Pashë Tepelenës, i dëshirës dhe synimit të tij për të zaptuar territore, për t'u shtrirë me sundimin e vet edhe në atë hapësirë ku nuk kishte mundur të hynte dhe të ngulej përfundimisht Perandoria Osmane.

Ndërtimet e realizuara në periudhën e Ali Pashës, reflektojnë individualitet, reflektojnë mënyrat dhe mjetet e përdorura nga ata që i konceptuan dhe i realizuan ato, në përshtatje me atë që synonte të arrinte monarku i Janinës, për të krijuar diçka ndryshe në oborrin e tij, që duhej të ngjasonte me atë të një kryeqyteti oriental e perëndimor.

Gjithsesi, Kështjella e Porto Palermos, është një objekt që dëshmon dhe përcjell informacione dhe mesazhe. Përmes "leximit" të saj,

të historikut të ndërtimit, të vlerave arkitekture, etj., mësohen mjaft detaje nga aktiviteti dhe figura e Ali Pashë Tepelenës, që sundoi në Pashallëkun e Janinës, për një periudhë më shumë se 30-vjeçare.

Kështjella e Porto Palermos nuk mund të shpëtojë dhe të trajtohet si një element, apo objekt, i veçuar nga konteksti historik i ndërtimeve të realizuara në shekuj, nga ai zinxhir fenomenesh dhe ndikimesh që kanë ardhur brez pas brezi, duke krijuar një traditë e cila ka lënë gjurmët e veta në planin arkitekturor, në atë të teknikës dhe stilit të ndërtimit, në objekte të ngjashme

Zinxhiri i ngjashmërisë nis me atë që emërtohet kështjella në lartësinë “59”, në Durrës, e cila prej vitit 1243 njihet edhe nga burimet historike me emrin, “kështjella e poshtme”. Është ky objekt që, ishte në fokusin e analizës së këtij studimi, për shkak të ngjashmërive arkitekture me kështjellën e Porto Palermos. Gjithashtu, “Kështjella e poshtme” e Durrësit, shënon edhe pikënisjen e analizës së ndikimit të stilit venecian në arkitekturën e fortifikimeve në Shqipëri.

“Kështjella e poshtme” shënon nga ana tjetër ndikimin e parë të drejtpërdrejtë të stilit venecian në objektet e fortifikimit, që, së bashku me teknikën veneciane të ndërtimit “Kluazonash”, shfaqen të reflektuara në ndërtimet e realizuara në vijimësi në vendin tone.

Fundi i Republikës së Venedikut në vitin 1797, si pasojë e ekspansionit të Napoleon Bonapartit në Itali, nuk mund të thuhet se ishte edhe fundi i filozofisë së ndërtimeve veneciane në Shqipëri. Kjo filozofi, e trupëzuar në dhjetëra objekte fortifikimi, mbeti si vlerë dhe si realitet, që përbën objekt shumë të rëndësishëm studimi dhe rivlerësimi, për shkak të rëndësisë dhe impaktit.

Duke vlerësuar dhe njohur karakteristikat themelore të stilit venecian, ne njohim dhe vlerësojmë më mirë të gjithë fashën dhe vëllimin e ndërtimeve në Shqipëri, kuptojmë dhe eksplorojmë më mirë shumëdimensionalitetin që ato përmbajnë, zbulojmë elementët që e bëjnë unik këtë stil dhe që i gjejmë të materializuara në dhjetëra e dhjetëra objekte fortifikuese të shpërndara në Shqipëri, kuptojmë më mirë historinë dhe rëndësinë e çdo objekti,

studiojmë në mënyrë më të detajuar historinë e njerëzve dhe të komuniteteve, vlerësojmë e rivlerësojmë personazhe historikë, me synimin për t'u dhënë vendin që ata meritojnë, në kohën që ata jetuan dhe në morinë e ngjarjeve që udhëhoqën, apo ku ishin protagonistë e frymëzues. Në këtë gamë perceptimesh dhe analizash, ne do të mund të arrijmë të përcaktojmë më me saktësi data dhe periudha objektsh.

Prandaj dhe nuk ka dhe nuk mundet që të vlerësojmë në tërësinë e saj, kështjellën e Porto Palermos, nëse nuk do të ndjekim dhe analizojmë të gjithë sfondin e ngjarjeve që i paraprinë asaj, në aspektin ndërtimor, arkitekturor, historik. Vetëm kështu do të jemi të saktë dhe të sigurt në atë që do të fiksojmë dhe do u përcjellim njerëzve.

Kështjella e Porto Palermos, ka datën, apo më saktë periudhën e trupëzimit të saj, e cila nuk mund dhe nuk ka sesi të përmbledhet në një ditë, apo në një shumatore ditësh, apo javësh. Ky objekt, nuk lindi dhe nuk u krijua nga “asgjëja” dhe në një hapësirë, apo terren bosh dhe të virgjër. Kjo kështjellë erdhi si një nevojë për të qenë e tillë, në formën që e shohim sot, kur u përputhën disa faktorë, që u materializuan në mendjen dhe vizionin e Pashait të Janinës. Por, në të vërtetë, ajo kishte ekzistuar si e tillë, në një sfond gjeografik dhe historik, shumë kohë më parë. Ishte historia e Himarës dhe popullit të këtij bregdeti, që e kishte mburjtur këtë objekt me karakteristikat themelore të saj, ishte trashëgimia e ustallarëve të kësaj krahine, apo e mjeshtrave të tjerë vendas dhe më gjerë, që gatuan në këtë objekt, traditën dhe traditat, në frymën e kohës, ishte e gjithë ajo trashëgimi e krijuar në shekuj në Himarë dhe në të gjithë bregdetin e vendit tonë, ku stilet dhe teknikat, pasonin dhe zëvendësonin njëra-tjetrën, ku periudhat linin gjurmë dhe ndikime, ku fryma e ndërtimeve venedikase me tiparet dalluese e unike të saj, ishte bërë pjesë e kësaj trashëgimie dhe tradite. Porto Palermo është më shumë se historia e një zone, e një krahine. Ajo është vetë historia e fortifikimeve shqiptare, me një fashë mijërvjeçare, e pasuruar me elemente dhe veçanti, që ishin rrjedhoja të kohëve dhe e vizioneve njerëzore.

Tek kështjella e Porto Palermos, ne gjejmë një fashë të gjerë të objekteve të tjera të ngritura në Shqipëri në periudha paraardhëse.

Gjejmë “Kështjellën e Poshtme” të Durrësit, gjejmë kalanë e Shkodrës, të Kaninës, Himarës, Kardhiqit e Peqinit, kështjellën e Vivarit dhe të Gjon Boçarit, gjejmë kështjellën e Sopotit (Borshit) dhe atë të Bashtovës. Mjafton të ndalemi në secilën prej tyre, me një vëzhgim të hollë e hulumtues, por edhe duke shfrytëzuar vepra e botime, për të perceptuar ngjashmëritë. Prandaj Porto Palermo edhe sot, vazhdon të jetë objekt studimesh e eksplorimesh, ndonëse deri tani ka munguar një studim i plotë dhe i integruar për të.

Kohëndërtimi na shfaqet si një dimension që nuk ka kohë, ose më saktë që, simbolikisht i përket një fashe të gjerë kohore. Sepse edhe argumentet na vijnë në të dy linjat; në atë që e lidh ndërtimin e kështjellës me sundimin e Ali Pashë Tepelenës, ashtu si edhe me opsionin tjetër të ekzistencës së saj, në një periudhë të mëhershme. Dhe një përzjerje mes këtyre dy alternativave, që do të thotë se Porto Palermo, është ndërtuar, apo rindërtuar mbi bazën e një strukture ekzistuese, është po aq e fortë, sa edhe dy të parat.

“Thuhet se në vitin 1662 turqit modernizuan një kështjellë ekzistuese në Porto Palermo”, nënvizon **Richard Hodges**, ose “...ndërtuan një kështjellë të re në Porto Palermo”, shton më tej ai, Një nga konkluzionet e tij më të rëndësishme për këtë kështjellë, është ajo e vazhdimësisë.

Nga ana tjetër, historian Pëllumb Xhufi, nuk përjashton mundësinë që kësaj kështjelle t’i ketë paraprirë një strukturë e mëparshme, e cila shërbente për të njëjtin qëllim, si një objekt i fortifikuar.

“Por, mund të hamendësohet se kësaj kështjelle i ka para ekzistuar, qoftë edhe në një formë embrionale, ndonjë konstruksion i ngjashëm”, nënvizon ai.

Mund të mendohet se porti i Porto Palermos u fortifikua në një moment kulmor pushteti të turqve mbi Himarën, siç ishte periudha pas Luftës së Kandias (1669).

Prandaj dhe porti, gjiri detar dhe vetë kështjella, vlerësohen si elemente të shtrira në kohë, ku çdo periudhë ka lënë dhe fiksuar gjurmët përkatëse, mes të cilave përfshihen edhe fortifikimet, apo struktura të tjera të ngjashme, të cilat janë finalizuar me këtë

kështjellë, ku shohim periudha, ndikime, arkitektura, të cilat spikasin me elementët respektivë.

Dhe, mes tyre, sigurisht dhe qoftë edhe për arsyet që kemi përmendur në vijimësi, përfshihet dhe spikat ndikimi i arkitekturës veneciane, e cila na vjen përmes traditës së ushtruar nga mjeshtrit vendas, të cilët përveçse përvojës së kultivuar në një mjedis dhe sfond të ndikimit venecian, nuk përjashtohet të kenë respektuar edhe veçori arkitekturore të një strukture ekzistuese veneciane.

“Gjiri kontrollohej nga fortifikime që nga parahistoria”, përcakton arkeologu Jano Koçi.

Sfondi historik, që kemi sjellë në këtë studim krahas të tjerash, shërben si një provë, si një argument për atë përfundim të rëndësishëm se, kështjella e Porto Palermos, përpara se të jetë vepër e një momenti historik, është produkt i një trashëgimie historike disadimensionale. Argumentet e sjella në këtë studim, e bëjnë të prekshëm këtë fakt, i japin formë.

Kështjella e Ali Pashës, ka vetëm emrin të tillë. Ajo vjen si pjesë e një historie mijëravjeçare, e cila ka lënë gjurmë në çdo detaj të saj. Është historia e popullsisë së Himarës, e Bregdetit të Jugut, që, në sinergji me realitete fqinje, rajonale e më gjerë, ka përcjellë dhe marrë kulturë, ka eksportuar dhe importuar jetë e mentalitete, duke krijuar dhe kultivuar vlera që tejkalojnë kufijtë gjeografikë. Pjesë e këtyre vlerave është edhe trashëgimia që ka në thelb ndikimin venecian, si produkt i natyrshëm i një bashkëjetese të gjatë më shumë se katër shekujore.

Kjo kështjellë nuk “lindi” në një shesh të zbrazur dhe nga asgjëja, nuk u ngrit në një boshllëk. Argumentet e sjella më sipër, në çdo rresht dhe paragraf të këtij studimi, janë të mjaftueshme për të pretenduar të kundërtën.

Në një përcaktim esencial mund të thoshim; **Porto Palermo, në sfondin e ndikimit venecian.**

KAPITULLI VIII

-(Straboni VII, 58, Prolemeu III 13,2)", *Dhimosten Budina Raport i vitit 1963 A.S.A. Harta arkeologjike e bregdetit Jon dhe e pellgut të Delvinës* fq. 282, Iliria, 1971, 1, pp.275-342.

-François Pouqueville. *Voyage de La GRECE*).

-William Martin Leake, *Travels in Northern Greece (London 1835), volume 1, pp. 1-105, 363-384*

-Ilir Gjipali, *Vendbanime të reja në Pellgun e Delvinës dhe në Bregdetin Jon, Iliria 34.2009. pp. 201-221 Iliria nr. XXXIV & J. Koçi, "Fortifikimet parahistorike në bregdetin kaon", Iliria 1991, 1-2 fq. 39-61*

-Straboni VII, 58, Prolemeu III 13,2)".

-Progetto Liburna Archeologia subacquea in Albania Campagne 2007/2008 L'ARCHEOLOGO SUBACQUEO XIV, 2-3. Maggio-Dicembre 2008.

-Saimir Shpuza. *Importimi dhe prodhimi i verës dhe vajit në Ilirinë e Jugut (shekujt III-I p. e. s.) / Import and Local Production of Wine and Oil in the South Illyria (III-I Centuries B. C.) Iliria Année 2007, 33. pp. 219-232*

-Giuliano Volpe, Giacomo Disantarosa, Danilo Leone, Maria Turchiano, *Progetto Liburna Archeologia subacquea in Albania Campagne 2007/2008 L'ARCHEOLOGO SUBACQUEO XIV, 2-3. Maggio-Dicembre 2008*

-Dh. Budina. *Raport i vitit 1962. "Harta arkeologjike e Bregdetit Jon dhe e pellgut të Delvinës". Iliria 1971 1 pp. 275-342)*

-S.Rusha. *Himara në stuhitë e shekujve. Tiranë, 2002.*

-Homeri." *Odiseja". Kënga XI.15*

-Marin Barleti. *Histori e Skënderbeut. Fq.93*

-Moikom Zeqo. "Të vërteta të panjohura e të pathëna për Himarën". *Tiranë 5.05.2003*).

-Pëllumb Xhufi. "Arbërit e Jonit". 2017

-Aleksandër Meksi. "Disa kapela bizantine të vendit tonë", në *Monumentet. 10. 1975*

-I. Zamputi, *Dokumente të shekullit XVI-XVII për Historinë e Shqipërisë, vëll.I. Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë: 1989*

-Nino Borgia. *Murgjit bazilianë të Italisë në Shqipëri.*

-Moikom Zeqo. "Të vërteta të panjohura e të pathëna për Himarën". *Tiranë 5.05.2003*).

-Scriven, George P. (Prill 1921). *Some highways of Albania and a forgotten Riviera. Geographical Review. American Geographical Society. 11 (2): 198–206. doi: 10.2307/207325. JSTOR 207325.*

- "Quella scalla della Cimera fu da me Bailo introdotta et aperta l'anno passato, ne prima veduta da altri" (ASV, Dispaçi, Corfu, b.14(1625-1626: raport i Bajliut Piero Marcello, Korfuz, 14 shkurt 1625.

- "Riviera d'Albanesi ditta Paracalamo che e da Palormo fin al Fanaro, la qual rivierae de longezza de miglia ottanta in circa", Gerasimos D. Pagkrates, *Oi ektheseis ton veneton Ereunon bailon kai pronoiton tes Kerkyras (16 aionas), Ethniko, Idryma Ereunon, Institutou Byzantinon Ereunon, Athinë. 2008. Fq.93.*

-ASV, *Consiglio de Dieci: Lettere Rettori, b.291, c.3: raport i Kapitenit të Detit, 14 shkurt, 1501.*

-Luigi M. Ugolini, "Butrinti, miti i Eneas"

-Irakli Koçollari, "Korrespondenca dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës", Tiranë 2016

-Boppe, A: L'Albanie et Napoleon 1797-1814, Paris 1914.

-Historia e Popullit Shqiptar. Toena, Tiranë 2002,

-Ars. Grigori "Ta pasaliqia tis Alvanias qe...", Athina 2007, Akademia Slavikon, Erevnon

-Ibrahim Manzur Efendi "Kujtime për Ali Pashë Tepelenën. Tiranë 2003.

-Pouqueville, F.C.H.L, "Travells in Epirus, Albania, Macedonian and Thesaly", Paris 1820.

-Beaucham Alphonse de "The life of Ali Pacha, of Joannina: late vizier of Epirus, surnamed Aslan, or...", Cornhill London 1823

-Davenport, R.A. "Life of Ali Pasha of Tepeleni-Vizier of Epirus'. Tomas Tegg, London 1816.

-Bronsted, Peter Olaf."Interview"; "Interview with Ali Pacha". The Danish Institute in Athens 1999

-İLKER DEMİR. TEPEDELENLI ALI PASHA AND THE WEST: A HISTORY OF HIS RELATIONS WITH FRANCE AND GREAT BRITAIN 1798-1820 The Institute of Economics and Social Sciences of Bilkent University DEPARTMENT OF HISTORY BILKENT UNIVERSITY ANKARA, December 2007

-Irakli Koçollari. "Ali Pasha dhe Shqipëria në arkivat britanike". Tiranë 2013

-THE ARCHITECTURAL TRANSFORMATION OF THE OTTOMAN PROVINCES UNDER TEPEDELENLI ALI PASHA, 1788-1822 M. Emily Neumeier A DISSERTATION in History of Art Presented to the Faculties of the University of Pennsylvania in Partial Fulfillment of the Requirements for the Degree of Doctor of Philosophy 2016

-William Miller, "The Ionian Islands under Venetian Rule,"

The English Historical Review 18/70 (Apr., 1903), 214-215. Also see S. Margaritis, Crete and Ionian Islands under the Venetians (Athens: Leontiadis, 1978)

-William Martin Leake, Travels in Northern Greece (London 1835), volume 1, pp. 1-105, 363-384

-Gilkes, Albania: An Archaeological Guide, 241. R.J.A. Wilson, R. Talbert, Sean Gillies, Valeria Vitale, Jonathan Prag, Jeffrey Becker, and Tom Elliott, "Pan(h)ormus: a Pleiades place resource," Pleiades: A Gazetteer of Past Places (2015), <http://pleiades.stoa.org/places/462410>, accessed September 11, 2016.

-Gjerak Karaiskaj, "5000 vjet fortifikime në Shqipëri"

-Apollon Baçe. "Kështjellat e Kardhiqit dhe Delvinës", "Monumentet", 13.1977

-Scriven, George P. (Prill 1921). Some highways of Albania and a forgotten Riviera". Geographical Review. American Geographical Society. 11 (2): 198–206. doi: 10.2307/207325. JSTOR 207325

-Demir. I (December 2007). Tepedenli Ali Pasha and the west: A history of his relations with France and Great Britain 1798-1820. Master Thesis. Department of History, Bilkent University, Ankara.

-Minella Gjoni, "Bregdeti dhe Ali Pashë Tepelena", Konferenca III Panhimariote. 2011

-Beggally John (1937)," Ali Pasha and Great Britain. Oxford University Press"

-Richard Hodges. Eternal Butrint. A World Heritage Site in Albania. (London: Periplus Publishing, 2006)

-Ilir Parangoni. Periudha Veneto-Osmane. Gjiri i Sarandës gjatë periudhës Veneto-osmane (shek. XV-XVIII) / Saranda Bay during the Ottoman-Venetian period (15th-18th centuries) [article. Iliria.Vol 40/ 2016/. 293

-Jano Koçi, "Kaonia dhe Himara në antikitet", Konferenca III Panhimariote, 2011.

-Jano Koçi, Parahistoria e Himarës, Konferenca III Panhimariote. 2011.

-Dhimosten Budina Raport i vitit 1963 A.S.A. Harta arkeologjike e bregdetit Jon dhe e pellgut të Delvinës fq 282, Iliria, 1971, 1

-Dr. Artan Gjika, Prof.dr. Priamo Bollano. "Himara gjatë luftërave ballkanike dhe në vitet e Luftës së Parë Botërore

-Petro Marko: Intervistë me vetveten. Fq.155

-Portali kujto.al

KAPITULLI VIII

Fig. 1 – Pamje e Porto Palermos në vitin 1963

Fig. 2 - Harta e vendbanimeve të reja të zbuluara në Pellgun e Delvinës dhe Bregdetin Jon

Fig. 3 – Harta që pasqyron rrugët detare nga brigjet e Italisë drejt Himarës (Panormës) dhe Korfuzit

Fig. 4 – Harta e zonave të marra në studim në kuadrin e projektit Progetto Liburna Archeologia subacquea in Albania Campagne 2007/2008 L'ARCHEOLOGICO SUBACQUEO XIV, 2-3. Maggio-Dicembre 2008.

Fig. 6 – Foto e një spirance të zbuluar gjatë kërkimeve arkeologjike nënujore Projekti L'ARCHEOLOGICO SUBACQUEO XIV

Foto 7, Amforë e gjetur gjatë kërkimeve arkeologjike nënujore Projekti L'ARCHEOLOGICO SUBACQUEO XIV

Foto 8, Amfora Chiota (zona 8), Amfora Lamboglia (zona 3), Amfora Cretese TRC1 (zona 8)

Fig. 9, Amfora Zemër 57 (zona 9), Amfora Dressel 24 (zona 1), Amfora Afrikana II D1 (zona 8)

Foto 10, Amfora LR2 (zona 3), Amfora Otranto (zona 1), Amfora Gusein (zona 3)

Foto 11, Shkrimi origjinal Straboni

Foto 12, Fragment e murit rrethues të Kështjellës së Himarës

Foto, botimi, François Pouqueville. Voyage de La GRECE.

Foto 13, Harta topografike e Kalasë së Himarës

Foto 14 – Foto e botimit original “Some highways of Albania and a forgotten Riviera” Geographical Review. American Geographical Society (Scriven, George P. (Prill 1921).

Foto: Në Butrint, shekulli XV

Foto 15- Plan i Kështjellës së Porto Palermos, ndërtuar nga Ali Pasha

Fig. 16. Kullë poligonale në Kështjellën e Poshtme, Durrës

Foto 17, Kështjella e Vivarit

Foto 18, Planimetria e Kështjellës së Vivarit

Foto 19, Kështjella trekëndore e Vivarit

Foto 20, Kalaja e Kardhiqit

Foto 21. Kështjella e Peqinit

Foto 22. Kullë e Shek. XVIII në kështjellën e Peqinit

Foto 23, Planimetria e një bastioni poligonal tipik venecian, Kështjella e Gjon Bocarit

Foto 24, Pamja nga lart e Kështjellës së Libohovës

Foto 25, Fragment nga Kështjella e Porto Palermos

Foto 26, Botimi i F.H.C.L. Pouqueville, “Voyage de la Grece”

Foto 27, Pamje e Kështjellës së Porto Palermos referuar periudhës së zhvillimeve ushtarake

Foto 28, Pamja jugperëndimore e kështjellës së Porto Palermos

Foto 29, Portali kujto.al i dedikuar historisë së persekutimit dhe të internuarve në regjimin diktatorial komunist

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Koci, Harilla

Studim historiko - arkitekturor për kështjellën e Porto Palermos, Himarë / Harilla Koci. - Vlorë : CeLIM

Shqipëri, 2023

163 f. : me il. ; 15x21cm.

ISBN 978-9928-4760-0-5

1.Historia 2.Monumente të kulturës 3.Porto Palermo
4.Shqipëri

904(496.5) :728.81



AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO



CELIM
Impact to Change



cesvi



VOLONTARIATO INTERNAZIONALE
PER LO SVILUPPO

VIS



AULEDA
LOCAL ECONOMIC DEVELOPMENT AGENCY
VERONESE

ISBN: 9789928476005



9 789928 476005